

Personaliteti shembullor i pashoq  
**HAZRETI MUHAMMED MUSTAFAJA**  
(sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem)

Osman Nuri Topbash  
E përktheu nga turqishtja:  
Nasir Rexhepi

Titulli origjinal: Emsalsis Örnek Şahsiyet

Hazreti Muhammed Mustafa

- Salallahu aleyhi ve selem-

Erkam Yayınları

İstanbul

Lektoroi.

Mr. Elez İsmaili

Ja si e përshkruan All-llahu i Lartë, Zotëriun tonë Profetin Fisnik Muhammedin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem):

“Ty të dërguam vetëm si mëshirë për të gjithë krijesat” (el-Enbija, 107).

“O Ti Profet, Ne të dërguam ty dëshmues lajmëtar, pagëzues e qortues. Dhe me urdhërin e All-llahut, thirrës për në rrugën e Tij, dhe pishtar ndriçues.” (el-Ahzab, 45-46)

“(O Muhammed) pa dyshim ty do të keshë shpërblim të pandërprerë! Vërtet ti je në shkallën më të lartë të moralit” (el-Kalem, 3-4)

“Ju e kishit shembull më të lartë (Usvei hasene) në të Dërguarin e All-llahut, kuptohet ai që shpreson në shpërblimin e All-llahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shpesh All-llahun (el-Ahzab, 21)

“O ju besimtarë, respektonie All-llahun dhe të Dërguarin e tij dhe mos i çoni kot veprat tuaja.” (Muhammed, 33)

“Kushdo që i bindet All-llahut dhe të Dërguarit, të tillët do të jenë së bashku me ata që All-llahu i shpërbleu: Me profetët, besnikët e dalluar, dëshmorët dhe me të mirët. Sa shokë të mirë janë ata.” (en-Nisa, 69)

“All-llahu dhe engjëjt e Tij e madhërojnë Profetin shumë. O ju që keni besuar, madhëronie atë duke përshëndetur me selat.” (el-Ahzab, 56)

## PARATHËNIE

Falënderime dhe lavdërime të panumërta i qofshin All-llahut të Lartë që na ka dhënë fatë të kemi nderin të jemi pjestarë të ummetit të kurorës së gjithë profetëve, Hazreti Muhammed Mustafasë (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) të njohur me epitetin Habibull-llah (i Dashuri i All-llahut)...

Lutje të panumërta për paqe dhe mëshirë, salat dhe selame, për Zotëriun tonë Profetin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), Diellin e Diejve, i cili me personalitetin e tij është dritë udhëzuese e pavenitur dhe e vërtetë në rrugën e lumturisë së përhershme të njerëzimit!...

All-llahu i Lartë e zgjodhi Atë për profet në kohën kur njerëzimi gjendej në një krizë të madhe, në një periudhë kur bota mbytej në errësirë dhe tirani, njerëzimit i dhuroj një perlë drite e cila përsëri do të shndërriste hënat, yjet dhe diejt e panumërt të errësuar të botës njerëzore. Dhuroi atë si një yll i cili lind nga horizonti në gjithësinë e errësuar të një shoqërie injorante e cila kalonte kafshët në egërsi, vrazhdësi dhe ashpërsi.

All-llahu i Madhëruar e dërgoi atë mëshirë të pafund për tërë krijesat e gjalla dhe jo të gjalla, dheun e gurin, lumin e detin, qiejt e tokën, kohën dhe hapësirën, e në veçanti për njeriun. E bëri atë pretekst të begatisë, udhëzimit, mëshirës, butësisë dhe shpëtimit.

Mëshirë kjo që çdo krijesë është e krijuar për nder të Tij, dhe ka fituar vlerë te Zoti në bazë të dashurisë që ka për Të.

Mëshirë, butësia dhe mirësia e të cilit ka përfshirë gjithë njerëzimin, madje gjithë krijesat.

Mëshirë, me vyrtytet e të cilit All-llahu i Vertetë u dhuroi të gjithë zemrave dhe mendjeve burim jete të pafund, dhe frymëzim begatish të panumërta.

Mëshirë, me të cilën ka ardhur udhëzuesi i pafund Kur'ani Fisnik.

Mëshirë, i dashur i All-llahut të Mëshirshëm dhe Bamirës, Profeti i cili u nderua me Miraxh.

Mëshirë, që sikur të mos ishte Ai gjithë botët do të shndërroheshin në shkretëtira.

Mëshirë, drita e të cilit ishte pretekst për fillimin e krijimit të ekzistencës.

Mëshirë, bukuritë kudo që ekzistojnë janë reflektime prej Tij, janë krijuar për hir të Tij. Nuk çel asnjë lule në botë në të cilën nuk ekziston drita e tij. Zatën, sikur të mos ishte Ai nuk do të krijoheshin asgjë. Ai është si një gonxhe hyjnore, e cila nuk vyshket, por çdo ditë e më tepër fiton freski dhe bukuri.

Mëshirë, vlerën e të cilit e përshkruan vetë All-llahu i Madhëruar, edhe atë duke e lartësuar atë me **salate dhe selame**, me lutje për paqe dhe mëshirë...

Ja kjo Mëshirë e pashoqë, nën kulmin e profetësisë, i dha mundësi gjithësisë të shijojë qetësinë e vërtetë. Njerëzimi i cili mbytej dhe jepte shpirt në tymin e revoltës në tunelin e injorancës, me dyert e diturisë, urtësisë dhe të vërtetës që i hapi Ai, duke i hapur krahët në qiejt e pafund filloi të marrë frymë të një jete plotë freski. Ndërgjegjjet të cilat ishin bërë gurë, do të zbuten si brumë në duart e Tij të ndershme. Zemrat e erëta nga dryshku dhe papastërtia do të purifikohen dhe pastrohen në

burimet e tij të kristalta. Ashtu të çiltërta u shndërruan në një vend të pastër dashurie të mbushur me dritë.

Për shembull, etiopiani Vahshi, i cili para se të gjejë rrugën e drejtë ishte një njeri i egër gjakpirës, shpirtlig, pasi iu nënshtrua edukimit të Tij të lartë, u bë një *sahabi*, shok sy lotë. Sa e sa të tjerë sikur ai, para se të gjenin rrugën e drejtë, ishin të vdekur shpirtërisht në kthetrat e cilësive inferiore. Por, më pas, edhe ata duke pirë nga burimi i njejtë i udhëzimit do të fitojnë gjallëri të përhershme, dhe që të gjithë do të arrijnë lartësinë që të përmenden dhe kujtohen me epitelin “*hazretî*”.

Të gjithë këta tregojnë se Zotëriu ynë Profeti (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) është mrekulli më e lartë e artit hyjnor e krijuar nga Zoti i Lartë. Ai ishte i tillë edhe nga pamja e jashtme edhe nga përbërja e brendshme. Ai është më i përsosuri, më i nderuari dhe më i dashuri. Ashtu që të mirët, të pastërtit shpirtërisht, miqtë e Zotit, *evlijatë*, të urtët dhe sunduesit e vërtetë të cilët janë prijtar drejt të vërtetës janë vetëm një reflektim nga Ai shembull. Një fragment nga Ai shembull. Një hënë që reflektohet nga Ai Diell. Ngaqë Ai është mëshirë, favor dhe dhuratë për tërë botët nga Krijuesi i Lartësuar, Poseduesit të së bukurës reale. Mu për këtë, rruga për t’u afruar dhe fituar miratimin e All-llahut kalon nëpër dashurinë dhe lidhjen që është me Atë. Ja si e përshkruan Zoti i Vërtetë këtë realitet:

قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ

“Thuaj (o profet!): “nëse e doni All-llahun, atëherë ejani pas meje që All-llahu të ju dojë, të ju falë mëkatet tuaja, se All-llahu është që fal shumë, mëshiron shumë.” (Ali İmran, 31)

Kjo është e vërteta ndaj të cilës asnjë person që ka besim në All-llâhun nuk mund të qëndrojë indiferent. Ashtu si që potencon edhe ajeti kur'anor.

Kriter i vetëm i dashurisë ndaj All-llahut, është ndjekja e Profetit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), lidhja shpirtërore me Atë dhe mbështellja rreth Tij. Në të kundërtën besimi nuk llogaritet besim. Për rrrjedhojë, asnjë person nuk ka mundësi ta bëjë veten të dashur te All-llahu në ndonjë rrugë tjetër. E ai i cili nuk e bën veten të dashur të All-llahut çdo gjë që bën i shkon huq, madje, edhe besimi i tij.

Atëherë në qendër të jetës dhe zemrës sonë çdo herë duhet të gjendet Hazreti Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), kurse personaliteti i Tij i pashoq duhet të jetë arkitekti i vetëm i karakterit tonë.

Mu për këtë themi se nevoja jonë më e madhe është që të njohim Atë sa më afër...Të kuptojmë Atë sa më mirë...madje të frymojmë frymën që ka frymuar Ai...derisa të bashkojmë rahjet e zemrës sonë me zemrën e Tij...ashtu sikur bënin As'habul-Kirami/shokët e tij të ndershëm...sikur të dashuruarit, ashikët e Profetit.

Edhe pse për ne të dobëtit është i pamundur një qëndrim i nivelit që meriton Ai, është nder, nëse jo më tepër , të jesh në rrugën e Tij. Ngaqë, nëse arrijmë që të përfitojmë, qoftë edhe një pjesë nga personaliteti i Tij i pa shoq, do të ishte mjaft për lumturi të përhershë.

Për këtë shkak, duke pasur për qëllim të njohim sa më afër këtë Personalitet të lartë, vendosëm të shkruajmë këtë vepër

modeste, me gjithë mangësitë dhe dobësitë që mund të t'i ketë. Edhe në veprat tona të më parshme kemi ofruar të dhëna që kanë të bëjnë me personalitetin e Profetit tonë (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem).

Ndoshta fjalët tona nuk janë të atij niveli që meriton Ai, por, që të gjithë ne jemi të obliguar të falënderojmë Atë dhuratë më të madhe hyjnore duke rrëfyer dhe shkruar për Atë, dhe duke jetuar sikur Ai. Detyra jonë parësore është që, në kuadër të mundësive tona, të bëhemi ura të cilat do të bartnin mëshirën dhe paqen e Tij që përfshin tërë botët, në fundin e botës/*ahir zaman*, e cila mbytet në krizë. E kemi për borxh që, në kuadër të aftësive tona, atë kryevepër që qëndron në kulmin më të lartë t'ua prezentojmë në formën sa më të bukur, gjithë njerëzimit. Në veçanti është nderë për ne që të përfaqësojmë Atë me sjelljen dhe gjendjen tonë në formën sa më të bukur...Sa bukur e përshkruan poeti këtë përfaqësim të ndershëm:

*Qenia Yte është si dita më e kristaltë, më e vërtetë,*

*Për këtë burimi i dorës sate është uji, uji më i ëmbël,*

*Më i çiltëriti, më modesti, më i pastërti i njerëzimit,*

*Zot, na bën neve të tillë që të gjithëve!...(Sejri)*

Zot i Madhëruar, na krijo dhe na stolis neve që të gjithëve me personalitetin e Tij shembullor të pashoq! Na shndërro zemrat tona saraje të dashurisë së Tij! Në sprovën e devocionit, *takvasë* tone, të lidhjes dhe nënshtrimit ndaj Tij, na ndihmo, që kështu të arrijmë dashurinë dhe miratimin hyjnor! *Amin!*<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Lus Zotin e Lartë që të jetë kjo vepër një *sadaka xharije*, sadaka rrjedhëse për të gjithë nxënësit e mi të cilët kontribuan në përgatitjen e saj.





# Pjesa e parë

- Personalitet Shembullor i Pashoq
- Usvei Hasene / Shembëlltyrë më e mirë

## Personalitet shembullor i pashoq

### HAZRETË MUHAMMED MUSTAFAJA

(sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem)

Historia dhe kalendari profetik ka filluar me dhuratën e ekzistencës së parë “**dritën muhammediane**” njeriut më të parë; kurse me shfaqjen e “**trupit muhammedian**” në gjithësi ka mbaruar. Kjo dritë e lartë ka arritur nga lloji më i pastër dhe më fisnor deri te Hazreti Abdull-llahu duke u trashëguar brez pas brezi, me shtatzëninë e Hazreti Amine nga balli i hazreti Abdull-llahut është bartur te kjo nënë fatlume, dhe më në fund i është dorëzuar pronarit të vërtetë, Zotëriut të gjithë botëve.

Kompleksi i gjithësisë është krijuar nga drita profetike e Muhammedit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Për këtë shkak themi se mijëra zbukurime dhe rrjedha të fuqisë hyjnore janë buzëqeshje dhe reflektime nga drita e Tij. Ngaqë iu shtua një pjesë nga dheu i Profetit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) në dheun e krijimit të Hazreti Ademit atij iu pranua pendimi, si që na rrëfen edhe ky hadith i ndershëm:

*“Ademi (alejhisselam), kur bëri gabimin<sup>2</sup> që edhe do të jetë pretekst që ai të nxirret nga Xhenneti, kuptoj se kishte gabuar dhe tha:*

*“O Zot! Të lutem të më falësh për hir të Muhammedit!...”*

All-llahu i Lartë e pyeti:

---

<sup>2</sup> Sipas qëndrimit islam, pejgamberët janë të mbrojtur nga gabimet , rrëshqitjet dhe gabimet e pavullnetshme të tyre quhen *zel’le*.

*“O Adem prej ku e njuh ti Muhammedin kur Unë atë ende s’e kam krijuar?...”*

Ademi (alejhisselam) iu përgjigj:

*“O Zot, kur Ti më krijove dhe më fryve shpirt nga shpirti Yt, ngrita kokën dhe pash të shkruar mbi shtyllat e qiellit hyjnor (arshit) fjalinë “La ilahe il-lall-llah, Muhammedur-Resulull-llah”, “Nuk ka zot tjetër përveç All-llahut, Muhammedi është i dërguari i All-llahut”, dhe e kuptova se Ti e vë përkrah emrit Tënd vetëm emrin e krijesës më të dashur për Ty”.*

Atëherë, Zoti i Madhëruar tha:

*“Drejt u përgjigje o Adem! Me të vërtetë, ai është krijesa më e dashur për Mua! Kur të më lutesh Mua, më lut për hir të tij. Unë të fala ty, nga që më lute Mua për hir të tij! Dije se, **sikur të mos ishte Muhammedi, s’do të të kisha krijuar!**”<sup>3</sup>*

Ja, Hazreti Ademi (alejhisselam) bën ndërmjetësues të Dërguarin e All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) në lutjen e tij dhe fitoi faljen hyjnore.

Ai, i Dërguar i Lartë, u bartë edhe në fisin e hazreti Ibrahimit (alejhisselam), të cilit zjarri iu bë i freskët dhe shpëtim. E kur ajo perlë e lartë do të hyjë në lëvozhgën e Hazreti Ibrahimit (alejhisselam), për hir të tij do të zbresë një dash nga qielli. Shihet se edhe profetët kanë shfrytëzuar mëshirën hyjnore për hir të Tij, gjersa ka nga profetët, sikur Hazreti Musai (alejhisselam), të cilët kanë shprehur dëshirë të jenë pjestarë të ummetit të Tij, me qëllimë që të shijojnë begatitë që janë të garantuara për këtë ummet.

---

<sup>3</sup> Hakim, *el-Mustedrek ale’s-Sahihajn*, Bejrut 1990, II, 672/4228

Transmeton sahabiu Katade bin Numan se hazreti Musai (alejhisselam) i është drejtuar All-llahut të Lartë duke i thënë:

*“O Zot!, shoh se në leuhat, pllakat që m’i ke dhuruar mua, flitet për një ummet i cili do të paraqitet ndër njerëz dhe do t’i urdhërojë ata për të mirë e do t’i ndalojë nga e keqja, e ky ummet do të jetë ummeti më i mirë nga të gjithë. Zoti im, bëne që ky ummet të jenë ata që do të më ndjekin mua”*

All-llahu i Madhëruar i tha:

*“Ai ummet do të jetë ummeti i Ahmedit”.*

Musai (alejhisselam) iu drejtua përsëri All-llahut të Lartë:

*“O Zot, në ato pllaka poashtu permendet një ummet i cili do të jetë ummet i fundit që do të vij, por i pari i cili do të hyjë në Xhennet. O Zot bëne që ky ummet të jetë ummeti im”.*

All-llahu i Madhëruar iu përgjigj:

*“Ai do të jetë ummeti i Ahmedit”.*

Përsëri Hazreti Musai (alejhisselam) iu drejtua All-llahut të Lartë:

*“Zoti im, në pllakat poashtu flitet për një ummet i cili do të mbaj në gjoks librat (ungjijt-inxhilet) dhe do t’i lexojë përmendësh ata, kurse të gjithë ummetet lexonin hapur librat e tyre, e kur i humbnin ata, nuk kujtonin asgjë prej tyre. Zoti im, mundëso që ky ummet të jenë ummeti im!”*

All-llahu i Lartë përsëri iu përgjigj:

*“ Ai ummet do të jetë ummeti i Ahmedit!”*

Musai (alejhisselam) përsëri iu drejtua Zotit të Lartë:

*“Zoti im, në ato tabela flitet edhe për një ummet i cili do të jetë ummeti i librit të fundit, do të luftojë kundër çdo devijimi dhe kundër dexhxhallit me një sy. Bëne ummetin tim që të jetë ai ummet!”*

All-llahu i Lartë i tha:

*“Ai ummet do të jetë ummeti i Ahmedit”*

Musai (alejhisselam) iu drejtua All-llahut të Lartë:

*“Zoti im, në ato tabela poashtu flitet edhe për një ummet, pjestarët e të cilit do të fitojnë nga një sevab, mirësi për çdo vepër të cilën kanë planifikuar të e bëjnë, edhe pse nuk kanë pasur mundësi ta bëjnë të njejtën, e sikur të realizojn atë që planifikojn atëherë do të shpërblehen për çdo vepër me nga 10 deri 700 gradë sevabe. Mundëso që ummeti im të jetë ky ummet!”*

All-llahu i Madhëruar iu përgjigj;

*“Ai ummet do të jetë ummeti i Ahmedit”*

Më në fund Hazreti Musai (alejhisselm) vendosi në tokë pllakat që bartte në duar dhe i çoi duart për t’iu lutur All-llahut, dhe i tha:

*“O Zoti im! Më bën mua pjestar të ummetit të Ahmedit!”<sup>4</sup>*

Çdo hallkë e vargut të profetëve ka qenë si një shkëndi udhëzimi e begatshme, si një lajmëtar sihariqprurës për ardhjen e Hazreti Muhammedit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) i cili është i dërguar mëshirë për të gjithë botët.

---

<sup>4</sup> Taberi, *Xhamiu’l-bejan an te’vili ajni’l-Kur’an*, Bejrut 1995, IX, 87-88; İbn-i Kethir, *Tefsiru’l-Kur’ani’l-Adhim*, I-IV, Bejrut 1988, II, 259, ( në komentin e sures el-A’raf, 154 ).

Në fund, drita që pritej, më 12 Rebiul-evvel të vitit 571 e.r., në mëngjes të ditës së hënë, do të zbresë në univers nga prehri i kurorës së Abdull-llahut dhe Amines, pak para lindjes së diellit, dhe do të nderojë të gjithë kohërat dhe hapësirat.

Me shfaqjen e Tij, mëshira e All-llahut të Lartë shpërtheu në këtë gjithësi. Mëngjeset dhe mbrëmjet ndëruan ngjyrën. Emocionet fituan thellësi. Fjalët, bisedat, shijet fituan gjërësi, çdo gjë fitoi kuptim dhe bukuri të re. Idhujt u rrënuan duke u dridhur, u shembën shtyllat dhe kullat e pallateve në Medajin, në vendin e udhëheqësve persianë. Liqeni Save u tha si baltovinë dhune. Kjo begati kaploi tërë gjithësinë, përfshiu gjithë kohërat dhe hapësirat.

Sikur të mos kish nderuar gjithësinë Hazreti Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), i cili përmlodh të gjithë vlerat në vete, njerëzimi deri në Kiamet do të ngelte në dhunë, tirani dhe errësirë, të dobëtit do të ngelnin skllëvër dhe rob të më të fuqishmëve, do të mbisundonte e keqja, gjithësia do t'u takonte dhunuesve, tiranëve dhe të fuqishmëve. Sa bukur përshkruan poeti këtë pasqyrë:

*O i Dërguari i All-llahut, në këtë botë të mos kishe ardhë,  
Trëndafilat s'do të çelnin, bilbilat s'do të këndonin,  
Ekzistenca s'do të kishte kuptim, do të mbytej në zi...*

Fillozofi dhe asketi i madh, poeti Mevlana Xhelaled-din er-Rumi na këshillon që të jemi mirënjohës ndaj Profetit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), i cili gjatë tërë jetës u ballafaqua me mundime të mëdha, vetëm e vetëm, për të larguar dhunën dhe për të thyer idhujt:

*“O ti që sot je musliman, sikur të mos ishte munda dhe guximi i Hazreti Ahmedit (alejhisselam) për të thyer idhujt, tash edhe ti, sikur etërit e tu, do të besoje në idhuj!”*

\*\*\*\*

Ky njeri, që nuk dinte shkrim e lexim do të paraqitet në një hapësirë larg qytetërimeve dhe në një popull injorant, me diturinë dhe urtësinë që solli tejkaloj dhe pati lërë të mahnitur jo vetëm njerëzit e kohës së tij, por solli një detë mrekullish të paarritura deri në Kiamet. Kjo është vërtetuar edhe me faktin që Kur’ani Fisnik edhe pse prek shumë ngjarje historike, lajmëron për shumë situata që do të paraqiten në të ardhmen dhe jep të dhëna për shumë çështje teorike shkencore, asnjë zbulim qysh prej 1400 vjetësh nuk ka mundur të përgënjeshtrojë asgjë që përmban ai. Kurse edhe sot, madje edhe enciklopeditë botërore më me famë janë të detyruara të nxjerrin vëllime shtesë për të korrigjuar dhe përmirësuar vetëveten.

Ai Profet bonjak që nuk dinte shkrim e lexim, nuk ndoqi mësimet e ndonjë njeri; erdhi si shpëtues për gjithë njerëzimin, komentator i botës së fshehtë dhe si mësues nga shkolla hyjnore e të Vërtetit

Hazreti Musai pati sjellë disa ligje, Hazret Davudi që zgjedhur për t’i bërë lutje All-llahut, Hazreti Isai që dërguar për t’u mësuar njerëzve moralin bujar dhe asketizmin, *zuhdin*. Kurse Hazreti Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) i solli që të gjith këto. Solli sistem ligjor, iu mësoi njerëzve si duhet t’i luten All-llahut me zemër të kulluar pasi të kishin pastruar veten prej papastërtive egoiste dhe mëkateve. Ai tregoi se cili është morali më i bukur, dhe me mënyrën e Tij të jetesës u bë shembëlltyrë



për të tjerët. Ai këshilloi për të mos u mashtruar nga dukja dhe pamja e kësaj bote tërheqëse dhe e shkëlqyer por gënjeshtare. Shkurt, Ai tuboi në personalitetin dhe veprën e tij të gjithë kompetencat dhe detyrat e të gjithë profetëve paraprakë. Tek ai gjenden fisnikëria e prejardhjes dhe e edukatës, lumturia dhe përsosshmëri.

Ai jetoj dyzet vjet mes një shoqërie injorante. Shumica e gjërave të përsosura dhe magjepsje që do të shtronte sheshit më pas Ai, qenë ende të panjohura për popullin e kohës së Tij. Ai nuk njihej për burrë shteti, për predikues, për ligjërues e orator. Gjatë këtyre dyzet vjetëve atij së iu dha rasti të ishte jo vetëm një komandant i shquar, por, madje as edhe një ushtar i thjeshtë. Por mosha dyzet vjeçare u bë njëra ndër pikëkthesat e njerëzimit.

S'ishte dëgjuar më herët të ketë folur për historinë e popujve të kaluar dhe për profetët, për Xhennetin dhe Xhehnnemin. Vetëm se jetonte në një mënyrë të lartë të posaçme vetëm për Atë, dhe me një moral të lartë. Kur u kthye nga shpella Hira, me një detyrë hyjnore, kishte ndryshuar krejtësisht.

Kur filloi kumtimin dhe predikimin, e gjithë Arabia u frikësua dhe u turbullua. Kumtesa dhe oratoria e tij e mrekullueshme magjepsoi dhe përfitoi njerëzit. U pezulluan garat poetike, letrare, retorike dhe stilistike. Që prej atëherë asnjë poet nuk e vari më në muret e Qabes vjershën e tij fituese. Kështu, një traditë e cila kishte një të kaluar shumë shekullore u bë pjesë e historisë, derisa motra e poetit të famshëm Imru'l-Kajs, që kuptonte poezinë, kur dëgjoji versetin e 44 të kaptinës Hudë :

وَقِيلَ يَا أَرْضُ ابْلَعِي مَاءَ كِ وَيَا سَمَاءُ اقْلَعِي وَغِيضَ الْمَاءِ وَقُضِيَ الْأَمْرُ  
وَاسْتَوَتْ عَلَى الْجُودِيِّ وَقِيلَ بُعْدًا لِلْقَوْمِ الظَّالِمِينَ

“E ju patë thënë: “Oj tokë, përbij ujin tënd dhe o qiell, ndërpreje (shiun)”, uji u tërhoq, urdhëri u zbatua dhe ajo (anija) u ndal në (kodrën) Xhudij, e u tha: “i shkatërruar qoftë populli mizorë!”

E emocionuar u detyrua që të thotë: *“Tashmë nuk ka kush çka të thotë. Edhe poezia e vëllaut tim nuk meriton të qëndrojë në sheshin e mburjes”*... Dhe fillimisht e largoj poezinë e Imru’l-Kajsit e cila qëndronte në krye të poezive, në muret e Qabes, më pas largoji nga muret edhe poezitë (*mual-lakat*) tjera të cilat ishin më të dobëta se ajo.<sup>5</sup>

I Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) të gjithë njerëzimit ia tregoi në praktikë realitetin se ai ishte zëvendës i All-llahut të Vërtetë mbi tokë. Madje edhe shkenctarët më të spikatur mund ta kuptojnë pas kërkimeve të një jete të tërë, pas përvojave të gjata mbi njerëzit dhe gjërat urtësinë e vërtetë të rregullave më të përsosura që vëndoi Ai, si në organizimin shoqëror, kulturorë, ekonomik, administrativ, organizimin e marëdhënieve ndërkombëtare dhe të sferave tjera të jetës. Pa mëdyshje, sa më shumë të zhvillohet njerëzimi në njohuri teorike e përvojë praktike, aq më mirë e kupton të vërtetën muhammediane. Ky profet i lartë i cili kurrë më parë nuk pati marrë shpatë në dorë, e që nuk pati bërë stërvitje ushtarake, në përjashtim që njëherë kishte marrë pjesë si ndjekës në një luftë, u bë një ushtar trim, komandant i vendosur që nuk u largua as nga betejat më të ashpra kur u deshtë, me gjith mëshirën e tij të gjërë që përfshinte tërë njerëzimin, të luftonte për hir të besimit në një Zot e të paqes shoqërore.

---

<sup>5</sup> Ahmed Xhevdet Pasha, *Kisas-i Enbiya ve Tevarih-i Hulefa*, Stanboll 1976, I, 83.

Shëtiti derë më derë dhe u kumtoi fenë e All-llahut njerëzve, por ata të cilët nuk patën fat ia plasën derën Diellit të udhëzimit dhe zgjodhën qëndrimin në errësirë përgjithmonë. Madje, si pasojë e ashpërsisë që posedonin në zemër u sollën me arrogancë ndaj Tij. Kurse ai, nuk u prek nga sjelljet e ashpra që iu bënë Atij personalisht, por nga injoranca e tyre. Njerëzve të këtillë vazhdimisht u përsëriste ajetin Kur'anor **“Thuaj (o Muhammed): "Unë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim dhe nuk jam prej atyre që bëjnë trillime.”** (Sad, 86), me të cilin u bënte me dije atyre se Ai nuk pretendonte ndonjë dobi tjetër veç kënaqësisë së All-llahut të Lartë.

Brenda nëntë vjetëve, shpesh herë me fuqi ushtarake sa një e treta e armikut, çliroi gjithë Arabinë, me viktima simbolike nga të dy palët ushtarake... Do të realizojë çlirime të jashtëzakonshme dhe mrekulluese në saje të fuqisë shpirtërore dhe edukimit ushtarak që mbolli te njerëzit e padisciplinuar dhe bashibozukët e kohës, deri në atë masë saqë pasardhësit e tyre u shkaktuan disfata edhe dy shteteve më të fuqishme dhe madhështore të kohës, perandorive persiane dhe bizantine. Kështu i Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) i cili pamvarësisht nga kushtet negative realizoi revolucionin më të madh në historinë botërore, i mposhti mizorët e tiranët, i heshti lotët e të shtypurve. Me dritën e tij ngushëlluese fshiu brengat nga zemra. Sa bukur përshkruan këtë portret poeti Mehmed Akif Ersoj:

*Ja ku u rrit dhe arriti të dyzetat jetimi  
Ku këmbët e përgjakura ranë në ujë!  
Me një frymë e shpëtoi njerëzimin ai i pafajshmi,  
Me një të rënë i shtriu për tokë mbretërit,perandorët!  
U rringjall e drejta e të dobtit që shtypej,*

*Padrejtsia që nuk shkonte ndërmend rënien, ngordhi!  
Mëshirë që për botët ligji i tij i drejtë, vërtet!  
Hapi krahët për në tokën e atij që donte drejtësi.  
Ç'të këtë bota, është krejt e dhëna e tij,  
E detyruar ndaj tij shoqëria, i detyruar individ, i  
detyruar ndaj atij të pafajshmit i gjithë njerëzimi...  
O Zot, me këtë besim na bashko në atë jetë!...*

Personaliteti i Zotëriut tonë Hazreti Muhammedit (sal-lallahu alejhi ve sel-lem) është si një det, personalitetet e profetëve tjerë si lumenj të cilët derdhen në atë det. Ai posedonte më shumë virtyte se sa gjithë virtytet dalluese të profetëve tjerë paraprakë, të cilët sipas një transmetimi janë mbi 124 mijë, posedonte majen e moralit dhe virtyteve të bukura. Ai është një personalitet shembullor i cili, përkrah zhvillimit që kishte arritur njerëzimi deri në atë kohë në dituri dhe sferat tjera jetësore, u përgjigjet nevojave që mund të paraqiten gjer në Kiamet. Për këtë shkak i është dërguar njerëzimit si profet i kohës së fundit. Ja si shprehet Profeti i All-llahut (sal-lallahu alejhi ve sel-lem) virtytin e moralin e lartë të Tij:

*“Unë jam i dërguar të plotësoj moralin më të bukur”.*  
(Muvatta', Husnu'l-huluk, 8)

## USVEI HASENE /SHEMBULLI MË I MIRË

Profeti dhe njeriu i vetëm në histori që çdo imtësi dhe detaj i tërë jetës i është studiuar është Zotëriu ynë Hazreti Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Prej sjelljeve të përsosura nga vargu i profetëve të cilat mund të shërbejnë për orientim të njerëzimit kah Zoti i Vërtetë dhe ajo që është e dobishme deri në ditët tona kanë mbërritur vetëm disa rrëfime të caktuara. Kurse, veprat, fjalët dhe bota emocionale të cilën e ka manifestuar Zotëriu ynë Profeti i kohës së fundit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) janë ndjekur pikëpërpikë dhe janë shënuar si një tabelë nderi. Edhe më tepër, që të gjitha këto fjalë, vepra dhe detaje që kanë të bëjnë me Profetin tonë (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) kanë rastin dhe nderin që të barten deri te njeriu i fundit, deri në Kiamet.

Që të mbrojmë veten nga shpifjet që sjellin sprovat, sfidat dhe surprizat e ndryshme në jetë është e nevojshme që të vëmë në praktik në formë sa më të bukur virtytet e larta morale si mirënjohjen, durimin karshi sprovave, qëndrueshmërinë, trimërinë, flijueshmërinë, kënaqësinë, pasurinë shpirtërore, altruizmin, bujarinë, modestinë, të mos prishim baraspeshën përballë ndodhive.

Zoti i Vërtetë zgjodhi për të gjithë njerëzimin Hazreti Pejgamberin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) për të qenë shembëlltyrë me jetën e tij të pastër, modeste dhe bujare, mësues i përsosur.

Jeta e të Dërguarit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) do të jetë shembull për të gjithë brezat deri në Kiamet. Ja çka thotë Kur'ani Fisnik për Atë:

“(O i Dërguar!) Ti padyshim do të keshë shpërblim të pa ndërprerë! Vërtet, ti je në një shkallë të lartë të moralit!” (el-Kalem, 3-4) .

Tiparet dhe personaliteti i bekuar i të Dërguarit të All-lahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), madje edhe vetëm me manifestimet të cilat mund t’i kuptojë logjika e njeriut, paraqesin majen e tërësisë së sjelljeve njerëzore. Ai është Profet Kulmor dhe personalitet shembullor i cili plotësoi detyrën e thirrësit në rrugë të drejtë, duke qenë personalisht shembull konkret. All-llahu i Lartëmadhëruar e prezenton në Kur’an atë qenie të bekuar para gjithë njerëzimit me epitelin “*usvei hasene*”, shembull më i përkryer, si që përkruhet në këtë ajetet kur’anor:

لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ لِمَن كَانَ يَرْجُوا اللَّهَ وَالْيَوْمَ الْآخِرَ وَذَكَرَ  
اللَّهَ كَثِيرًا.

“Ju e kishit shembullin më të përkryer, lartë në të dërguarin e All-llahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e All-llahut në botën tjetër” (el-Ahzab, 21)

Hazreti Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) në çdo sferë të jetës ka manifestuar një bukuri dhe përsosshmëri të pashoqë. Ai posedonte të gjitha bukuritë në shpirt dhe në sjellje. Si rrjedhojë, çdo njeri mund të gjejë në jetën e ndershme dhe sunnetin, traditën e Profetit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) sjelljet më të bukura dhe më të përsosura të cilat mund t’i shërbejnë si shembull. Ai (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), është shembull si prijës fetar, është shembull si kryetar shteti, është shembull për ata që hyjnë në lidhjen e dashurisë hyjnore, është shembull me ndjenjën e falënderimit dhe modestisë kur zhytej në

dhuntitë e Zotit. Është shembull me durimin dhe nënshtrimin e tij në kohë dhe rrethana të vështira. Është shëmbull butësie dhe dhembshurie ndaj anëtarëve të familjes. Është shëmbull me mëshirën e tij ndaj të dobtëve, të vetmuarve, robërve e skllevërve, është shembull me faljen dhe mirëkuptimin ndaj mëkatarëve dhe gabimbërëve.

*Nëse ti je një njeri i pasur, mendo për thjeshtësinë dhe bujarinë e atij Profeti të lartë që sundoi mbi tërë Gadishullin Arabik, që i bëri për vete të gjithë njerëzit e mëdhenj të kombit arab!*

*Nëse ti je njeri prej të dobtëve, merr shembull prej jetës së Profetit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) që ka jetuar në Mekkë nën regjimin e padrejtë dhe mizorë të politesistëve!*

*Nëse ti je fitimtar, merr shembull nga jeta e Profetit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) të guximit dhe nënshtrimit që doli fitues mbi armiqtë në Bedër dhe Hunejn!*

*Dhe, nëse, Zoti mos e dhëntë, pëson humbje, edhe atëherë kujto Profetin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) e dorëzuar Zotit që përcillej me durim dhe trimëri mes shokëve të rënë dëshmorë apo të shtrirë të plagosur në sheshin e luftës së Uhudit!*

*Nëse ti je mësues, mendo për Profetin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) që u mësonte shokëve të soffës urdhrat hyjnore duke u përcjellë atyre frymëzimin e zemrës së vet të hollë e të ndjeshme!*

*Nëse ti je nxënës, përfytyro Profetin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) që rri para Xhebrailit që i ka sjellë shpalljen!*

*Nëse ti je predikues që jep këshilla ose një prijës i besueshëm, dëgjo Profetin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) që u shpërndan urtësi shokëve të vet brenda Xhamisë Profetike dhe vërja veshin e jepja zemrën zërit të Tij të ëmbël.*

*Nëse kërkon ta mbrosh të vërtetën, ta kumtosh të vërtetën, ta kapësh e ta ngresh në këmbë dhe, për ta bërë këtë, nuk të ndodhet ndonjë ndihmës, shih e mëso nga jeta e Profetit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), kur ndodhej në Mekkë pa asnjë lloj ndihme, ua shpalli mizorëve të vet të vërtetën dhe i ftoi në rrugë të drejtë!*

*Nëse ti je një fitimtar që e ke thyer armikun, nëse e ke thyer inatin e kundërshtarit duke dalë epror mbi të, nëse e ke shkatërruar gënjeshtren dhe e ke shpallur të vërtetën, mbaje të gjallë para syve Profetin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) i cili, ditën e fitores së Mekkës, megjithëse ishte një komandant fitimtar, hynte aty me ndjenjë falënderimi, me një thjeshtësi të madhe, i përkulur mbi deve sikur po përkulej në sexhde!*

*Nëse je pronar çifliku dhe kërkon t'i vësh në rrugë të mbarë punët e atyshme, merr si shembull Profetin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) i cili, pasi u bë pronar i tokave Beni Nadër, Hajber dhe Fedek, vuri në krye të punëve njerëzit që do t'i përmirësonin ato dhe do t'i administronin në rrugë të mirë!*

*Nëse je njeri pa njeri, mendo për jetimin e vogël të Abdullahut dhe Amines!*

*Nëse je një i rritur, shih me kujdes kah jeta e të riut-kandiat për profet që punon si çoban i kopesë së axhës Ebu Talib!*

*Nëse je një tregtar që merr rrugën e tregtisë me karvane, kupto situatën e personit më të urtë të karvanit që shkon në Siri dhe në Jemen!*

*Nëse je gjykatës, mendo zgjidhjen e tij të zgjuar e të drejtë për të vendosur Gurin e zi në Qabe ndërsa fiset mekase janë gati t'ia këpusin kokën njëri-tjetrit për këtë gjë!*



*Dhe, duke i kthyer sytë sërish sërish historia, shih Profetin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) i cili në Medine, në Faltoren Profetike rri e, duke i trajtuar para vetes si të barabartë të varfërin e të pasurin, vendos mes njerëzve në formën më të drejtë!*

*Nëse je një bashkëshort, shih me kujdes karakterin e pastër të atij personi të bekuar, bashkëshorti i Hazreti Hatixhesë dhe Hazreti Ajshesë, botën ndjesore të thellë dhe dhembshurinë e tij, trajtimin me drejtësi të të gjitha bashkëshorteve!*

*Nëse je prind, shih mënyrën e sjelljes së tij ndaj vajzës Fatime e ndaj nipërve Hasan dhe Husejn!...*

*Kushdo që të jetë në cilatdo kushte që të ndodhesh mëngjes e mbrëmje në çdo çast ke për të gjetur Hazreti Muhammedin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) si prijësin më të mirë dhe udhërefyësin më të drejtë!*

*Ai është një prijës i tillë, me anë të sunneteve, të të cilit mund të regullosh çdo gabim, të vësh në udhë punët që nuk janë rregulluar, të ringjallësh shpresën. Në saje të dritës dhe udhëzimit të tij mund të shpëtosh nga pengesat e të arrish lumturinë!*

*Me të vërtetë, figura e tij i ngjan një tufë lulësh të rralla e delikate, një tufë trëndafilash erëmirë!*

\*\*\*\*

Si që shihet jeta e Profetit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) është shembull më i përkryer edhe për ata që gjenden në pika polarisht të kundërta në shoqëri. Për shembull, jeta e një të burgosuri nuk është shembull për gjykatësin, as jeta e gjykatësit për të burgosurin. Poashtu edhe gjendja e një të varfri i cili tërë

jetën kalon duke luftuar me varfërinë në kërkim të ekzistencës, nuk mund të jetë shembull për të pasurin i cili noton në begati. Kurse jeta e Profetit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) paraqet shembëlltyrë për të dy palët. Zatën, Zoti i Vërtetë atë e barti duke nisur nga pozita më e ulët në shoqëri, sa i përket fuqisë, të qenit bonjak, duke kaluar nëpër të gjithë pozitat e jetës dhe e ngriti në pozitë më të lartë, shikuar nga aspekti i fuqisë dhe autoritetit, në pozitën e Profetit dhe prijësit shtetëror. Zotëriu ynë Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) në të gjitha manifestimet lavdëruese dhe ndëshkuese ekspozon shumë sjellje shembullore për situata të ndryshme të jetës së njeriut, qofshin ato të lavdëruara apo të përçmuara. Për këtë shkak themi se jeta e Tij, u ofron që të gjithë njerëzve, pa dallim pozite dhe rrethane, shembull praktik konkret dhe të përkryer, që do të mund ta ndiqnin sipas pozitave dhe mundësive të tyre për të realizuar atë model.

\*\*\*

Në përjashtim të profetëve dhe *salihëve*, të mirëve të cilët hapërojnë pas gjurmëve të profetëve, të gjithë ata që pretendojnë të jenë udhërefyes shembullor dhe trazues të rrugës së shpëtimit për njerëzimin, në veçanti filozofët të cilët mundohen të kuptojnë dhe shpjegojnë gjërat vetëm me fuqinë e tyre mendore, janë të mangët në këtë aspekt kurse profetët, me që të gjithë mbështeten në zbulesën, *vahjin* hyjnor, kanë ardhur si udhërefyes në rrugë të drejtë që vërtetojnë njëri tjetrin.

Kurse filozofët të cilët synojnë të jenë udhërefyes për njerëzit në rrugë të së vërtetës dhe që kanë qenë të privuar nga mbështetja hyjnore, të mbështetur vetëm në mendjet e tyre të nënshtruara epsheve dhe frymës, *nefseve* të tyre që kanë

refuzuar dhe demantuar sistemet e njeri tjetrit dhe që janë përgënjeshtuar mes veti. Për këtë shkak ata nuk kanë mundur të udhëzojnë as veten e tyre as të tjerët në rrugë të drejtë. Për shembull, Aristoteli edhe pse pati hedhur themelet e një sërë ligjesh dhe rregullash të filozofisë së moralit, ngaqë ish i privuar nga revelacioni, *vahji* hyjnor, nuk mund të gjesh një njeri që t'i ketë besuar filozofisë së tij, të ketë zbatuar atë në jetë dhe të ketë arritur lumturinë. Kështu ka ndodhur ngaqë zemrat e filozofëve nuk janë pastruar me praktika fetare, idetë dhe veprat e tyre nuk janë maturuar me ndihmë hyjnore.

Pretekst i vetëm që do të kishte shpëtuar njerëzimin nga katastrofat në të cilat e bartin atë fuqinë mendore pa edukim hyjnor dhe dëshirat epshore, është *Habli Metin*, Litari më i Fortë, Kur'ani Fisnik, i dhuruar njerëzimit nëpërmjet Profetiti të kohës së fundit Muhammedit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Kurse shembujt më konkret dhe më të qartë të thesarit të vërtetë kur'anor gjenden në personalitetin dhe traditën e pasur të Zotriut tonë Muhammedit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Atëherë për njeriun i cili është i detyruar të realizojë qëllimin e ekzistimit obligim parësor është që të zë pozitën e vet në gjithësi duke u frymëzuar nga burimi kur'anor dhe burimi i sunnetit.

Kur'ani dhe sunneti janë reçetat e lumturisë së kësaj dhe botës së mëtejme, *Ahiretit* dhe kujtim i përjetshëm nga Drita e Ekzistencës (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Ai, i la ummetit të tij dy udhërefyes të mëdhenj Kur'anin Fisnik dhe Sunnetin e ndershëm.

Hazreti Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) bëri veten të dashur edhe para se të fillonte detyrën profetike, prezentonte veten me një përsosshmëri që detyronte popullin ta

mbiquajnë atë **el-Emin**, i Besueshëm dhe **es-Sadik**, i Sinqertë. Filloi detyrën profetike pasi personaliteti i Tij ishte bërë i padiskutueshëm. Populli e donte atë dhe e njihnte karakterin e Tij të bukur, mirësinë, drejtësinë dhe ndershmërinë e tij, shumë kohë para se t'i vinte profetësia. Fisi që e kishte mbiquajtur atë el-Emin, besnik gjatë rindërtimit të Qabes, në rastin e konfliktit ndërmjet prijësve fisnorë të Mekkes për vendosjen e Gurit të Zi në vendin e vet, i qe nënshtruar gjykimit të Tij pa kundërshtim.

I Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) aq i sinqert ishte saqë Ebu Sufjani, i cili ishte një armik i përbetuar i Profetit, në periudhën para se të *rivertohe*<sup>6</sup>, në pyetjen e perandorit bizantin Heraklius “a pati ndodhur ndonjëherë të mos ketë mbajtur fjalën?”, do të detyrohet të pranojë realitetin duke u shprehur: “Jo! Ai e mban fjalën që e jep” . (Buhari, Bed’u’l-vahj 6, Salat 1, Sadakat 28; Muslim, Xhihad 74)

Poashtu edhe thënia e armikut të pamëshirshëm të Hazreti Muhammedit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) Ebu Xhehlit dhe shokëve të tij drejtuar Profetit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem): “O Muhammed, pasha zotin, ne nuk të themi se je gënjeshtar, ne të pranojmë ty si një person të sinqertë dhe i drejtë. Por ne jemi kundër fesë që ke sjellë ti”, dëshmon përshtypjen e Arabëve injorantë për Profetin tonë (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Pas ngjarjes në fjalë do të zbres ky ajetet kur’anor: “**Ne e dimë se ty të brengos ajo që thonë ata, por ata nuk të gënjejnë ty, ata mizorë mohojnë argumentet e All-llahut**” (el-En’am, 33).<sup>7</sup>

---

<sup>6</sup> Preferojmë termin *rivert* që do të thotë, rrikthim në gjendje të më parshme, ngaqë sipas qëndrimit islam, gjithë njerëzit lindin me natyrë të pastër, islame (N.R).

<sup>7</sup> Vahidi, *Esbabu Nuzuli’l-Kur’an*, thk: Kemal Besjuni Zaglul, Bejrut 1990, s. 219.

Domethënë edhe armiqtë më të tërbuar me ndërgjegje e pranojnë se Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ishte Profet i vërtetë, por e patën kundërshtuar vetëm e vetëm nga egoizmi!

Një ngjarje që ndriçon shkakun pse Zotriun e Gjithësisë (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) edhe politeistët e mbiquanin “**Muhammedu’l-Emin**”, (person prej dorës dhe gjuhës së cilit çdo kush gjen siguri dhe paqë) është edhe kjo që pason:

Gjatë ditëve në të cilat zhvillohej lufta e Hajberit një bari nga rradhët e hebrevjeve i quajtur Jesar erdhi te Hazreti Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), dhe pasi bisedoi me Profetin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) shprehu dëshirë dhe gatishmëri të përqafojë fenë islame dhe t’u bashkohet rradhëve të muslimanëve. Por, Hazreti Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) e urdhëroi atë që fillimisht t’ua kthejë kopetë pronarëve, e më pas, nëse do, do të mund t’u bashkohet rradhëve të muslimanëve. E gjithë kjo ndodhte në një kohë kur lufta zgjatte dhe fillonte koha e krizës për ushqim ndër muslimanët... Pa dyshim ky urdhër është një shembull i kuptimtë i cili thekson rëndësinë e ruajtjes dhe mbajtjen e emanetit, përgjegjësisë, detyrës, madje edhe në kushte më të vështira.

Shfrytëzimi i vërtetë i moralit dhe gjendjes së lartë të Profetit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) është e mundur vetëm me nënshtrimin që gjejmë në shprehjen “*Nëse pohon Ai, ashtu është*” të Ebu Bekrit në rastin e ngjarjes madhështore të Miraxhit.

Manifestimet e panumërta të drejtësisë, mëshirës dhe bamirësisë në jetën e të Dërguarit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) janë shembuj të pashoq për të gjithë njerëzimin deri në Ditën e Kiametit. Asnjë sy i ndërgjegjshëm i cili vështron

dritën që spërkat Ai kandil i pashoq në gjithësi, nuk mund të mohojë realitetin e tij (nëse jo më tepër) me zemër. Njëri ndër këta është edhe Thomas Carlyle i cili do të thotë:

*“Lindja e tij është xhveshje e dritës nga tirania”.*

Në njërën ndër enciklopeditë më me famë botërore, në enciklopedinë Ana Britanica gjejmë këtë citat në kontekst të dëshmisë së vleravë të Zotriut tonë Hazreti Muhammedit (sal-lallahu alejhi ve sel-lem):

*“...suksesin që e arriti Muhammedi nuk ka mund të arrijë asnjë profet dhe reformues gjatë tërë historisë njerëzore”*

B. Smith thotë:

*“Muhammedi është reformatori më i madh dhe i pashoq”.*

Kurse shkrimtari me famë Stanley Lane-Polo pranon realitetin se:

*“edhe ditët kur Muhammedi korrte fitore më të mëdha, ishin ditë që ai fitonte vlera të larta. Ai atë ditë (ditën e çlirimit të Mekkes. N.R.) i fali kurejshët pa asnjë dëmshpërblim dhe këtë falje e shndërroi në një amnesti të përgjithshme për popullin e Mekkes.”*

Shkrimtari Arthur Gilman, ndër të tjera thotë:

*“Në ditën e çlirimit të Mekkes e shohim madhërinë dhe lartësinë e tij. Kujtimet e të bërave të popullit të Mekkes ndaj tij mund të nxisnin atë që të hakmerrej, por Muhammedi e pengoi ushtrinë e tij nga derdhja e gjakut. Tregoi dhemshuri dhe butësi të madhe dhe falënderoi Zotin e tij”.<sup>8</sup>*

Filozofi La Fayette, njëri ndër ata që përgatitën themelet ideore të Revolucionit të madh francez të vitit 1789, para se të botohej Deklarata e të Drejtave të Njeriut, ka studiuar të gjithë

---

<sup>8</sup> Shih. Kamil Miras, *Tecrid-i Siîh Tercemesi*, Ankara 1972, IX, 289.

sistemet juridike dhe më në fund u bind për lartësinë që posedon e drejta islame karshi sistemeve tjera dhe do të thotë:

*“O Muhammed madhështor! Ke ngritur drejtësinë në një nivel të tillë që ka qenë i paarritshëm deri sot, madje, do të jetë i paarritshëm edhe në të ardhmen”.*

Është kjo vlerë e vërtetë që detyrohen të pranojnë, të nënshtrohen dhe para së cilës dorëzohen edhe armiqtë. Vlerat dhe virtytet e Hazreti Muhammedit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) edhe ata të cilët nuk e kanë pranuar atë për profet, gjithmonë i kanë vërtetuar...

Personaliteti i pashoq i Hazreti Muhammedit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) përmbledh në vete maturinë, përsosshmërinë morale që mund t’u përgjigjet punëve të ndryshme një nga një. Ai përbën pikën themelore të edukimit dhe arsimit gjithënjëzëror në botë. Ai, shpërndan dritë në rrugën e atyre që kërkojnë udhëzim. Udhëzimi i Tij është si një dritë që shndërrit rrugën e çdo personi që kërkonë rrugën e drejtë. Ai është prijësi i vetëm i gjithë qenies njerëzore. Rradhët e tij udhëzuese janë si shkolla që përmbledhin njerëz të të gjitha kategorive, dhe grupeve njerëzore. Aty tubohen dhe bashkohen gjithë kombet, gjuhët, ngjyrat krahas dallimeve në pozitë, gjendje sociale dhe llojllojshmëris kulturore. Nuk ekziston asnjë kriter që pengon cilindo njeri nga hyrja në të. Ajo çerdhe nuk i përkiste asnjë fisi, ish një qendër dije dhe shkence që pranonte njeriun vetëm pse është njeri. Atje nuk bëhej dallim mes të dobtit dhe të fortit...

T’i hedhim një sy e të shikojmë ata që ndoqën Profetin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), do të gjejmë mes tyre personalitete të zgjedhura si mbreti etiopian Nexhashi, i madhi i fisit Mean, Ferve, prijësi i fisit Himjer, Dhulkila, një nga të mëdhenjtë jemenas,

Merakebut, një nga guvernatorët e Omanit, Ubejd, Firuz Dejlemi, Xhaferi etj...

Pranë këtyre prijësve dhe sundimtarëve do të gjeni edhe njerëz të vetmuar si sklevër dhe të dobëtit Bilal, Jasir, Suhejb, Habbab, Ammar, Ebu Fukejhe si dhe robëreshat, shërbëtoret dhe gratë pa mbrojtje Sumejje, Lubejne, Dhinnire, Nehdijje, Umu Abis etj...

Ndër shokët e Tij të lartë kishte edhe persona me mendime të larta, ide të shkëlqyera dhe ideale të shëndosha, edhe prej atyre të cilët ishin të denjë edhe për punë më delikate, persona që dinin fshehtësitë e kësaj bote, njerëz që administrojnë vendet me përgjegjësi dhe dinjitet.

Pasuesit e Hazreti Muhammedit (sal-lall-llahu alejhi ve sellem) administrojnë qytete, qevrisën shtete. Njerëzit, në saje të administrimit të drejtë, arrijnë lumturinë, shijuan kënaqësinë e drejtësisë. Përhapën paqen dhe qetësinë ndër popuj, dhe i bënë njerëzit të ndjehen mes njëritjetrit si vëllezër.



# KAPITULLI I DYTË

- Moral i Lartë i Hazreti Pejgamberit
- Kriteret në yje

## MORALI I LARTË I HAZRETI PEJGAMBERIT

Njeriu i vetëm në historinë botërore të cilit i është njohur, studiuar dhe analizuar jeta gjer në imtësitë më të vogla është Hazreti Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Nëse duam të përshkruajmë të gjitha virtytet që përbëjnë personalitetin shembullor të Profetit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) nuk do të mjaftonin të shkruhen, madje edhe vepra voluminoze.

Edhe shkencat islame në bazë<sup>9</sup> dhe në përpjekjet e dijetarëve, *ixhtihad*<sup>10</sup> i kanë marrë për argument dhe si mbështetje të tyre aspekte dhe momente të ndryshme të të Dërguarit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Për këtë shkak, çdo aspekt i Muhammedit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) është studiuar dhe njohur veç e veç nga shkenca të ndryshme.

Rrjedhoimisht, të gjitha veprat islame që janë shkruar gjatë 1400 vjetëve, kanë patur për qëllim të komentojnë, sqarojnë dhe përshkruajnë një libër, Kur'anin Fisnik, dhe një njeri, Muhammedin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem).

Nuk është e mundur që me kapacitetet tona njerëzore të kuptojmë dhe njohim tërësisht Krenarinë e Gjithësisë, Profetin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), i cili është mrekulli botërore në vete, ngaqë, përshtypjet e fituara nga kjo botë janë të paafta të kuptojnë dhe spjegojnë Atë. Siç nuk është e mundshme të nxë një gotë uji një oqean të tërë, poashtu nuk është e mundshme për

---

<sup>9</sup> Kjo bazë në fjalë në të cilën mbështeten shkencat islame është Kur'ani dhe Sunneti, tradita profetike, të njohura me termin "*Nass*". Në ato çështje ku ekziston vendim i qartë kur'anor dhe i Sunnetit nuk ka vend për përpjekje të dijetarëve, *ixhtihad*.

<sup>10</sup> *Ixhtihad* është përpjekje e dijetarëve kompetentë fetarë për të zgjidhur problemet për të cilat nuk ekziston vendim i qartë dhe i prerë nga Kur'ani dhe Sunneti. E gjithë kjo përpjekje duhet të kryhet në suaza të përmbajtjes kura'nore dhe Sunnetit

trurin e njeriut të kuptojë ashtu siç meriton Profeti Muhammed (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem).

Edhe ne do të përpiqemi, në suaza të mundësive tona, të prezentojmë shembuj nga personaliteti shembullor i të Dërguarit të All-llahut i cili është si një oqean i pafund.

### **Portreti dhe bukuria e moralit të Pejgamberit të All-llahut**

Qenia e bekuar e pa shoq, Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), ka pasur pamje të bukur dhe biografi të përsosur. Nuk është e mundur të përshkruhet dhe prezentohet, ashtu siç meriton portreti dhe biografia e të Dërguarit të All-llahut.

Imam Kurtubiu në lidhje me këtë do të thotë:

“Bukuria e pamjes së të Dërguarit të All-llahut nuk është shfaqur tërësisht, sikur të ishin ekspozuar të gjithë bukuritë e Tij me gjithë realitetin që posedonin, shokët e Tij nuk do të kishin fuqi ta shikonin Atë.”<sup>11</sup>

I vogël është numri edhe i shokëve, *as'habëve* të të Dërguarit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), të cilët vazhdimisht e shoqëronin Atë, e që kanë shikuar në dritën e bukurisë së Tij. Transmetohet se shokët e Tij, me përjashtim të Hazreti Ebu Bekrit dhe Hazreti Omerit, të cilët shikoheshin me Atë sy më sy, madje, edhe gjatë bisedave të gjata që kishin me Profetin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) shikonin vetëm para vetes nga edukata që posedonin dhe repekti që kishin ata ndaj Profetit të All-llahut. Ata shikonin me buzëqeshje Zotëriun tonë të ndershëm, edhe Krenaria e Gjithësisë ua kthente atyre me buzëqeshje. ( Tirmidhi, Menakib, 16/3668)

---

<sup>11</sup> Ali Yardım, *Pejgamberimiz'in Şemâli*, Stamboll 1998, s. 49.

Ja si e paraqet këtë situatë Amër bin Asi, (radiall-llahu anhu), personi i cili më vonë do të njihet me epitelin Çlirues i Egjiptit:

*“Kam qëndruar një kohë të gjatë në shoqëri të Pejgamberit të All-llahut, por nga ndjenja e turpër dhe respekti që ndjeja ndaj Tij, nuk kam patur guxim që të shikoj në fytyrën e Tij të shndërritshme dhe të bekuar. Nësë dikush sot më thotë; ”Na përshkruaj dhe na shpjego Atë?”, besoni, nuk kam mundësi ta përshkruaj”. (Muslim, Iman, 192)<sup>12</sup>*

Fytyra e bekuar e Profetit Fsnik e cila shpërndante përreth siguri dhe paqe ishte fytyra më e pastër dhe më e bukur që ka ekzistuar dikur. Dijetari çifut Abdullah bin Selam, fill pas Hixhretit në Medine kishte takuar Profetin e All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), dhe kur kishte parë fytyrën e Tij të bekuar, pati thënë:

“Kjo fytyrë kurrë nuk gënjen!”, dhe qe bërë musliman. (Tirmidhi, Kijame, 42/2485; Ahmed, V, 451)

Bukuria, madhështia dhe drita që Ai rezatonte dhe butësia që Ai posedonte qe në atë shkallë, saqë nuk kishte nevojë për ndonjë mrekulli, argument dhe provë tjetër për të vërtetuar profetësinë e Tij.

Atëherë kur i Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) nuk pëlqente diçka, menjëherë dallohej nga ndrishymet që shfaqeshin në fytyrën e Tij, poashtu edhe kur pëlqente diçka, vërehej kënaqësia dhe miratimi.

---

<sup>12</sup> Shih. Ahmed bin Hanbel, *el-Musned*, Stamboll 1992, IV, 199.

Në trupin e Tij të pastër gjithmonë ndodheshin së bashku vitaliteti, ndjenja e fortë e turpit dhe vendosmëria e jashtëzakonshme. Është e pa mundur të përshkruhet thellësia e butësisë ndiesore të Tij.

Në fytyrën e Tij kishte një dritë të këndëshme, në fjalët e Tij kishte rrjedhshmëri, në lëvizjet e tij elegancë, në të folurit e Tij kishte qartësi, në shprehjet e Tij kishte oratori.

Nuk thoshte kurrë fjalë të kota, çdo fjalë ishte këshillë dhe urtësi.

Në fjalorin e tij nuk ekzistonin thashethemet dhe përgojimet. Gjithmonë gjatë bisedave kishte parasysh kapacitetin e bashkëbiseduesit.

Ai ishte i butë e modest. Nuk e tepronte në të qeshur, gjithmonë ishte i buzëqeshur.

Kush e shihte atë pa pritur e pa kujtuar kaplohej nga ndjenja e frigës. Kurse, kush krijonte me të afërsi dhe bisedonte me Të, lidhej pas tij me një dashuri të thellë.

Profeti i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) i respektonte njerëzit e çmuar sipas pozitës së tyre. Të afërmëve u bënte nderime më të mëdha. Ashtu siç sillej me mirësi ndaj anëtarëve të familjes dhe shokëve, sillej edhe me njerëzit e tjerë me butësi dhe bujari.

Shërbëtorët i mbante shumë mirë. I ushqente dhe i vishte ata, siç ushqehej e vishej vetë. Ishte bujar, nderues, i dhembshur dhe i mëshirshëm, kur duhej ishte i guximshëm e kur duhej i urtë.

Nuk është e mundur të vlerësohet realisht, si që meriton bujaria dhe fisnikëria e Tij. Ai ishte më bujar, madje edhe se personi i cili e nderon të vobegtin pa frigë nga varfëria.

Xhabiri (radiall-llahu anhu) lidhur me këtë situatë thotë:

*“Nuk ka ngjar që të thotë “jo” kur diçka kërkohej prej Tij.”*  
(Muslim, Fedail, 56)

Ai ishte personi i cili i vizitonte më së shumti të afërmit, personi më i mëshirshëm dhe më bëmirës ndaj popullit, personi i cili sillej në mënyrën më të bukur, personi i cili largohej më së shumti nga veset e shëmtuara, personi i cili posedonte edukatë dhe moral më të lartë. Ai ishte personi i cili thotë:

*“Ditën e kiametit nuk do të ketë asgjë që do të peshoëj në peshoren e besimtarit më tepër se morali i bukur. All-llahu i Madhëruar i urren ata që bëjnë vepra të pahijshme dhe ata që flasin fjalë të shëmtuara.”* (Tirmidhi, Birr, 62/2002)

I Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ishte i pa lëkundur në betim dhe premtim dhe besnik në fjalën e dhënë. Profeti qëndronte mbi çdo njeri tjetër me moralin e tij të bukur, mençurinë dhe zgjuarësinë e Tij, meritonte dhe ishte i denjë për çdo lavdërim.

Profeti ishte vazhdimisht i mendueshëm, nuk fliste pa nevojë. Heshtja e Tij vazhdonte gjatë. Kur fillonte një fjalë, e mbaronte pa e lënë në gjysmë. Mblidhte shumë ide e kuptime në pak fjalë e pastaj i thoshte. Fjalët i kishte të dallueshme. As më shumë, as më pak se sa duhej. Edhe pse kishte natyrë të butë ishte mjaft serioz dhe i paraqitshëm.

Nuk zemrohej përveçse kur kundërshtohesh e vërteta dhe shkelej e drejta. Zemrohej kur shkelej e vërteta dhe vazhdonte të jetë i zemruar derisa e drejta të vihej në vendin e vet. Vetëm kur e vërteta vihej në vendin e vet qetësohej. Kurrë nuk zemrohej për vete. Nuk merrej me mbrojtjen e vetes, me askënd nuk hynte në debat.

Ai nuk hynte në shtëpinë e askujt pa mos marrë leje. Edhe kur hynte në shtëpi të vet e ndante kohën e qëndrimit në tri pjesë; një të për adhurim të All-llahut, tjetrën për familjen, të tretën për vete. Kohën e ndarë për vehte ua kushtonte të tjerëve pa dallim pozite dhe moshe, nuk privonte askë, u fitonte zemrat të gjithëve.

Për të parandaluar zakonin e uljes në të njëjtin vend, Ai ulej në të gjitha pjesët e faltores, xhamisë. Nuk dëshironte që vendeve dhe pozitive t'u atribuohet shenjtëri. Kur hynte në ndonjë kuvend ulej ku kishte vend të lirë, dhe dëshironte që kështu të veprojnë të gjithë.

Kur dikush kërkonte nga Ai diçka për të plotësuar ndonjë nevojë, Ai nuk gjente qetësi gjersa t'ia jepte, pa marrëparasysh qoftë e rëndësishme apo jo gjëja që i kërkohesh. E kur nuk kishte asnjë mundësi të zgjidhë nevojën, mendohej të fitojë zemrën e bashkëbiseduesit me fjalë të ëmbëla. Ai ishte pjesëtar i hallit të secilit. Njerëzit pa marrëparasysh shkallën dhe pozitën shoqërore, të pasur -të varfër, të ditur- të pa ditur, të gjithë para Tij ishin të barabart me dinjitetin e tyre njerëzor. Të gjithë kuvendet e tij ishin mjedise ku sundonte gjithmonë butësia, dituria, edukata, durimi, siguria dhe amaneti.

Nuk qortonte askënd për të metat dhe gabimet që posedonte, kur paraqitej nevoja e tërheqjes së vërejtjes dhe qortimit e bënte këtë në një mënyrë indirekte që nuk përçmonte askë. Ai jo vetëm që nuk është marrë me të metat dhe gabimet e pashfaqura të askujt, por reptësisht e ka ndaluar hetimin e tyre.

Krenaria e gjithësisë flitse vetëm e vetëm për çështje nga të cilat priste *sevap* dhe mirësi. Kuvendet e Tij ishin tejet tërheqëse. Kur Ai fliste të pranishmit e dëgjonin me vëmendje dhe magjepseshin deri në atë masë sa, siç shprehej njëri ndër ata të cilët kishin rastin të jenë pjesëmarës në këta kuvende:

“qëndronim në qetësi të tillë, sikur të kishim mbi kokë ndonjë zog, ai do të fluturonte edhe nga një lëvizje më e vogël.”(Ebu Davud, Sunnet, 23-24/4753)

Edukata dhe respekti i reflektuar prej Tij te sahabët, shokët e Tij, ishte i tillë sa që ata -shpesh herë- mernim guxim edhe për t'i drejtuar pyetje. Ata qëndronin në prezencë të Profetit (sal-lallahu alejhi ve sel-lem) edhe sikur të vinte ndonjë beduin nga shkretëtira për të biseduar me Profetin, me qëllim që të përfitojnë nga fryma e Tij shpirtërore.

Ai, gjatë tërë jetës, ishte një shembull i pashoq i sinqeritetit dhe besnikërisë. Me moralin që posedonte ishte sikur një Kur'an i gjallë. Nuk urdhëronte të tjerët për asnjë vepër të cilën nuk e kishte bërë vetë.<sup>13</sup>

---

<sup>13</sup> Shih. İbni Sa'd, *et-Tabakatu'l-kubra*, Bejrut, Daru Sadr, I, 121, 365, 422-425; Hejthemi, *Mexhmau'z-zevaid*, Bejrut 1988, IX, 13.



## Modestia e të Dërguarit të All-llahut

Pejgamberi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), i cili përfitoi zemrat e njerëzve si një edukues ideal, edhe pse për një kohë tejet të shkurtër arriti suksese të cilat nuk mund t'i arrijë asnjë mbret, do të vazhdojë të jetojë me një jetë modeste pa u bërë i mvarur prej asnjë nga dhuntit e shumta të kësaj bote. Do të jetoj, si edhe më herët, në një dhomë të thjeshtë si një i varfër. Flente në një shtrat të mbushur me gjethe hurmash. Jetoj në mënyrën më të thjeshtë edhe se një person më i dobët. Herë herë, ngaqë nuk gjente asnjë lloj ushqimi, lidhte një gurë për stomaku që të shtyp urrinë dhe të falënderojë Zotin. Edhe pse i qenë falur të gjithë mëkatet që kishte bërë në të kaluarën, dhe ato që do t'i bënte në të ardhmen, vazhdimisht i falënderohej dhe i lutej All-llahut. Kalonte net të tëra në namaz, madje shpeshherë edhe këmbët i ënjeshin nga të falurit. Ndhimonte të mjerët, ngushllonte bonjakët. Ai, krahas pozitës që kishte, mirrej edhe me hallet e më të dobtëve, madje në saje të mëshirës dhe dhembshurisë që posedonte atyre u kushtonte kujdes të veçantë.

Edhe në ditën kur Profeti ishte më i forti në sytë e njerëzve, në ditën e çlirimit të Mekkes, bashkëqytetarët e vet, të cilët duke u dridhur nga friga i thonin:

“Të lutem, o i Dërguar i All-llahut më mëso fenë islame”, i qetësonte duke u thënë:

*“Qetësohu vllaçko! Unë nuk jam as mbret as imperator. Unë jam komshiu yt jetim, i cili ushqehet me mish të thatë në diell!...”*

<sup>14</sup>, sjellje kjo me të cilën i dhuroi njerëzimit një modesti të pashoqe në histori.

Po atë ditë, Ai do të prezentojë madhështinë dhe modestinë e Tij në momentin kur i tha shokut të Tij të shpellës,<sup>15</sup> Hazreti Ebu Bekrit, i cili e solli babanë e tij plak të lodhur deri te Profeti që të pranojë fenë e All-llahut:

*“O Eba Bekër! Pse e ke munduar deri këtu babanë tënd plak. Ne do të shkonim deri te vendbanimi i tij”<sup>16</sup>*

I Dërguari i All-llahut gjithmonë deklaronte modestinë e Tij dhe thoshte:

**“Unë jam një njeri, sikur edhe ju. Por mua më vjen shallje, vahj..”** (el-Kehf, 110)

Ai gjithmonë insistonte që para formulimit ku deklarohet se Ai është i Dërguari i All-llahut të qendrojë togfjalëshi, **“abduhu”**, (rob i All-llahut), me të cilën mbronte *ummetin*, pasuesit e Tij nga devijimet e popujve të profetëve paraprakë.

Edhe atyre të cilët e tepronin në respekt u thoshte:

*“Keni kujdes, mos më lartësoni më shumë se sa unë e meritoj! Ngaqë, All-llahu i Lartë mua më ka zgjedhur për rob para se të më zgjidhte për pejgamber.”* (Huthejmi. IX, 21)

I Dërguari i All-llahut kishte një enë e cila në gjuhën arabe quhet *garra*. Kjo ishte një enë të cilën e bartnin katër persona.

---

<sup>14</sup> Shih. Ibn-i Maxhe, Et’ime, 30; Taberani, *el-Mu’xhemu’l-Evsat*, II, 64.

<sup>15</sup> Hazreti Ebu Bekri ishte personi i cili e shoqëroi Profetin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) gjatë Hixhretit, shpërnguljes prej Mekkes në Medine, në të cilin udhëtim ndodhi edhe strehimi i Pejgamberit dhe Ebu Bekrit në shpellën Theur.

<sup>16</sup> Shih. Ahmed, VI, 349; Hejthemi, VI, 174; İbni Sa’d, V, 451.

Një ditë pasi Profeti fali *namazin duha*<sup>17</sup> as'habët, shokët e Tij e sollën këtë enë me ushqim, dhe që të gjithë u ulën për rreth. Më në fund edhe Profeti u ul së bashku me ata. Një beduin i cili ish prezent aty në atë momentë u habit me modestin e të Dërguarit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), Profeti vërejti këtë gjendje të beduinit dhe tha:

*“All-llahu i Madhëruar më ka krijuar mua rob të ndershëm, jo tiran inatçi.”* (Ebu Davud, Et'ime, 17/3773)

Një herë tjetër Pejgamberi kishte thënë:

*“Askush nuk do të hyjë në Xhennet në saje të veprave dhe ibadeteve, adhurimeve të veta!”*

As'habët që ishin prezent të habitur e pyetën:

*“A edhe ti, o i Dërguar i All-llahut?”*

Profeti do të përgjigjet:

*“Po, edhe unë nuk do të hyj në Xhennet derisa të më vijë në ndihmë mëshira dhe favori hyjnor!... Edhe mua nuk do të më shpëtojnë veprat e mija. Por, në Xhennet do të hyj me ndihmën, mëshirën dhe faljen e Zotit tim”* (Buhari, Rikak, 18; Muslim, Munafikun, 71-72; Ibni Maxhe, Zuhd, 20; Darimi, Rikak, 24)

Poashtu Pejgamberi i All-llahut ua tërheq vërejten atyre të cilët vishen në këtë botë me kryelartësi, fodullëk dhe mburje, se veshje e tyre në botën e pasme, *ahiret* do të jetë veshja e nënçmimit prej zjarri. Ja disa nga shumë hadithe, thëniet profetike që kanë të bëjnë me këtë aspekt:

---

<sup>17</sup> Namazi duha, është njëri ndër namazet e preferuara për besimtarët, mund të falet duke filluar që pas lindjes së diellit deri në kohën kur dielli arrin në zenit.

*“All-llahu nuk do të shikoj në fytyrën e atyre që veshin veshje tepër të gjatë me qëllim kryelartësie dhe fodullëku.”*  
(Buhari, Libas, 1,5)

*“Kush vesh në këtë botë veshje mburjeje dhe kryelartësie, All-llahu i Lartë do t’i veshë atij Ditën e kijametit veshje nënçmimi”* (Ibni Maxhe, Libas, 24)

### **Bujaria e të Dërguarit të All-llahut**

Pejgamberi i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) e përshkruante veten si një person i ngarkuar me detyrën për të dhënë, madje thoshte se All-llahu është pronari i vërtetë dhe Ai që jep çdo gjë.

Safvan bin Umeje, i cili ishte njëri ndër prijësit e fisit Kurejsh, kishte marrë pjesë së bashku me të Dërguarin Fisnik në luftërat e Hunejnit dhe Taifit. Safvani, duke shëtitur së bashku me Muhammedin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) nëpër pasurinë e tubuar si pre lufte në Xhirane, do të shikojë me lakmi në të. Krenaria e Gjithësisë i cili vërejti këtë gjendje të Safvanit do t’i thotë:

*“A shum e pëlqeve këtë pasuri o Safvan”, “Po”, do t’i përgjigjet Safvani. Atëherë Profeti do t’i thotë :*

*“Merre, qofët ytja e gjithë ajo!”*

Safvani i fascinuar do të thotë:

“As një zemër përveç zemrës profetike nuk mund të jetë kaq bujare”, do të pranojë fenë islame,<sup>18</sup> do të kthehet te fisi i tij dhe do të brohoras: “O popull! Shpejtoni dhe bëhuni musliman, ngaqë Muhammedi ndan ndihmë dhe lëmoshë të madhe pa mos ndjerë aspak frigë nga varfëria.”(Muslim, Fedail, 57-58; Ahmed, III, 107)

Njëherë një njeri erdhi tek i Dërguari i All-llahut dhe kërkoi diçka nga Ai. Hazreti Pejgamberi (sal-lâll-llâhu alejhi ve sel-lem) në atë mument nuk posedonte, asgjë që t’i jepte atij. Por i tha që të marrë borxh nga dikush e Profeti do ta paguante atë. (Hejthemi, X, 242)<sup>19</sup>

Profeti, sikur stërgjyshi i ti Hazreti Ibrahim (alejhisselam) nuk hante asnjëherëq ushqim pa mos gostitur ndonjë mysafir. U ndihmonte familjeve të borxhlinjëve që ndronin jetë, në paguarjen borxhit, ose vetë Ai personalisht i paguante borxhet e të tjerëve. Nuk falte namazin e asnjë të vdekuri, borxhi i të cilit ende nuk ishte paguar. Në një hadith Pejgamberi Bujar thotë:

*“Bujari në këtë botë është afër njerëzve, në botën tjetër do të jetë afër All-llahut në Xhennet, larg Xhehennemit. Kurse, kopraci është larg All-llahut, Xhennetit dhe njerëzve, afër zjarrit të Xhehennemit!”* (Tirmidhi, Birr, 40/1961)

Në një hadith tjetër thotë:

*“Dy cilësi nuk mund të gjenden tek besimtari i vërtetë: kopracia dhe sjellja e shëmtuar!”* ( Tirmidhi, Birr, 41/1962)

---

<sup>18</sup> Vakidi, *Megazi*, Bejrut 1989, II, 854-855.

<sup>19</sup> Shih. Ebu Davud, Haraxh, 33-35/3055; İbni Hibban, *Sahih*, Bejrut, 1993, XIV, 262-264.

## Devotshmëria e të Dërguarit të All-llahut

Profeti ishte njeriu më i devotshëm që ka egzistuar dikur. Ai i lutej Zotit të Vërtetë që t'i dhurojë virtytin e devotshmërisë në këtë mënyrë:

*“O Zoti im! Dhuroj shpirtit tim devotshmëri dhe pastroje atë! Ti je Ai i cili pastron më mirë shpirtërat, Ti je Pronari i tij dhe i Dashuri i tij!”* (Muslim, Dhikër, 73)

*“O Zoti im! Të lutem që të më dhurosh udhëzim (hidajet), devotshmëri (takva), nder dhe pasuri shpirtërore.”* (Muslim, Zikir, 72)

Profeti për shkak të devotshmërisë që posedonte jetonte si të varfërit. Sipas transmetimit që bën Hazreti Aisheja (radiall-llahu anha) Pejgamberi i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) është shpërngulur në Ahiret, në botën tjetër pa mos ngirë stomakun dy ditë rresht me bukë elbi (sipas një transmetimi tjetër, tri ditë rresh me bukë gruri). (Buhari, Ejman, 22; Muslim, Zuhd, 20-22; Ibni Maxhe, Et'ime, 48)

Profeti e lëvdon devotshmërinë dhe nxit besimtarët në devotshmëri në këtë mënyrë:

*“Më afër meje janë ata persona, pa marrë parasysh vendin ku ata gjenden, të cilët janë më të devotshëm ndaj All-llahut!”* (Ahmed, V, 235; Huthejmi, IX, 22)

*“Pa mëdyshje miqtë e mi më të afërtë janë të devotshmit (muttekitë)!”* (Ebu Davud, Fiten, 1/4242)

*“Kudo që të jesh, kij frigën e All-llahut, dhe pas çdo vepre të shëmtuar bën mirësi, kjo e shlyen atë. Sillu ndaj njerëzve në mënyrën sa më të bukur!”* (Tirmidhi, Birr, 55/1987)

Ja si e përshkruan Profeti rrugën për të fituar devotshmërinë e vërtetë:

*“Njeriu nuk ka mundësi të arrijë gradën e të devotëshmëve të vërtetë, derisa nuk largohet edhe prej disa veprave të dyshimta”* (Tirmidhi, Kiame, 19/2451; İbni Maxhe, Zuhd, 24)

Sa i qëlluar është ky hadith i Profetit i cili përshkruan vlerën e devotshmërisë, *takvasë*:

*“Nuk ka asnjë epërsi i bardhi ndaj të ziut, e as i ziu ndaj të bardhit, vlerë e vërtetë është devotshmëria (takvaja).”* (Ahmed, V, 158)

Ekziston edhe një përkufizim i bukur i Isait (alejhiselam) mbi devotshmërinë:

Një njeri erdhi tek Isai (alejhiselam) dhe e pyeti:

*“O mësues i të mirës dhe të drejtës, si mund të bëhem i devotshëm ndaj All-llahu të Lartë?”*

Isai (alejhiselam) iu përgjigj:

*“Kjo është një punë e lehtë:*

*Do të lidhesh për All-llahun me një dashuri të thellë,*

*Do të bësh vepra të mira, aq sa do të kesh mundësi, që të arrish kënaqësinë dhe miratimin e All-llahut,*

*Do të sillesh me butësi dhe mëshirë ndaj gjithë njerëzve, ashtu si që sillesh ndaj vetvetes!”*, e më pas e porositi dhe i tha:

*“Mos i bën askujt atë që nuk dëshiron që të tjerët të bëjnë ndaj teje! Atëherë do të jesh i devotshëm i vërtetë!”<sup>20</sup>*

### **Jeta asketike e Profetit të All-llahut**

Erdhi koha që të gjithë shtetet, me pëlqimin e tyre, hyjnë nën ombrellën e të Dërguarit të All-llahut. Zotëriu ynë do të sundojë mbi gjithë Gadishullin Arabik, fund e kryet. Mund të bënte çfarë të donte, por megjithkëtë, Ai do të vazhdojë të jetojë në një formë tejet modeste, dhe thoshte se Ai personalisht nuk posedonte asgjë, gjithçka që ekziston është në dorë, pronësi të All-llahut. Erdhi koha, në duart e Tij iu afruan shumë thesare të majme, karavane devesh të ngarkuar me pasuri do të rrjedhin në Medinen e Shndërritshme. Ai, të gjitha këto do t’ua ndajë nevojtarëve, kurse Ai personalisht do të vazhdoj me jetën e Tij modeste, dhe do të thotë:

*“Sikur të kisha flori edhe sa kodra e Uhudit, në përjashtim të borxheve, nuk do të kisha fshehur atë më shumë se tre ditë. (Buhari, Temenni, 2; Muslim, Zekat, 31)*

Kalonin ditë të tëra, në shtëpinë e të Dërguarit të All-llahut nuk ndizej zjarr për të gatuar ushqim, Ai, shpesh kalonte netët i urritur. (Ahmed, VI, 217; Ibni Sa’d, I, 405)

Një ditë Hazreti Omeri (radi-allahu anhu) erdhi në shtëpi tek Profeti, soditi dhomën ku jetonte Profeti, dhoma ishte e shprazur, kishte vetëm një hasër të thurrur prej gjetheve të hurmës, mbi të cilën Profeti i All-llahut qe mbështetur. Hasra e thatë kishte lënë gjurmë në lëkurën e ndershme të Profetit. Në

---

<sup>20</sup> Ahmed, *ez-Zuhd*, (pa vendë dhe vitë shtypi) f. 59.



një skaj kishte një tas me miell elbi, aty afër qëndronte e varrur edhe një strajcë uji e vjetër. Pasuria e dhomës ishte e gjithë kjo!...Në një kohë kur i tërë Gadishulli Arabik i ishte nënshtruar Zotëriut tonë, pasuria materiale e tij ishte vetëm kjo. Pasi e pa këtë Hazreti Omeri, u emocionua deri në atë masë sa që nuk mundi ta mbante veten, iu përletën sytë dhe filloi të qajë. Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) me fjalë të buta iu drejtua dhe e pyeti:

*“Ç’ke që po qanë, o Omer?”*

Omeri iu përgjigj:

“Si të mos qajë o i Dërguar i All-llahut, kur më kujtohet se Kisratë, mbretërit pers dhe Kajserët, perandorët bizantinë notojnë në begati!, kurse I Dërguari i All-llahut jeton mbi një hasër të thatë.”

Profeti ia zbuti zemrën Omerit dhe i tha:

*“ Mos qaj o Omer! A nuk dëshiron që kjo botë me të gjitha begatitë dhe shijet të jetë e tyre, kurse Ahireti të jetë i yni.”<sup>21</sup>*

Një moment tjetër i cili portretizon biografinë e përsosur të Profetit të All-llahut është edhe ky hadith profetik :

*“Çka më duhet mua kjo botë! Shembulli i kësaj bote me mua është sikur rasti i udhëtarit i cili udhëton në një ditë vape vere, dhe ndalon për të pushuar nën hijen e një druri, e pastaj përsëri merr rrugë.”<sup>22</sup>*

---

<sup>21</sup> Shih, Ahmed, II, 298; Taberani, *el-Mu’xhemu’l-Kebir*, redaktoi. Hamdi Abdulmexhid es-Selefi, Bejrut, Daru Ihjai’t-Turathi’l-Arabi, X, 162.

<sup>22</sup> Tirmidhî, Zuhd, 44/2377; Ibni Maxhe, Zuhd, 3; Ahmed, I, 301.

Pejgamberi i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) nga frika e llogaridhënies në Kijamet për përgjegjësinë e pasurisë së kësaj bote, shpesh lutej:

*“Zoti im! Më bën të jetoj i varfër, jepmë një vdekje si njeri i varfër dhe ringjallmë bashkë me të varfërit!”* (Tirmidhi, Zuhd, 37/2352; Ibni Maxhe, Zuhd, 7)

Edhe pse që të gjithë pejgamberëve iu është garantuar Xhenneti, madje, edhe ata do të merren në llogari për predikimin fetar dhe për begatitë dhe të mirat që u janë dhënë.

Në ajetin 6 të sures el-A’raf All-llahu i Lartë thotë:

**“Ne sigurisht do të marrim në pyetje edhe ata cilëve u është dërguar pejgamber, edhe vetë pejgamberët e dërguar”**

### **Butësia e të Dërguarit të All-llahut**

I Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) posedonte një zemër të butë e delikate sa që një herë vërejti një njeri i cili pështiu në tokë. Fytyra e ndershme e të Dërguarit u vrejti dhe u shtang në vendin ku gjendej. Një sahabi i cili vërejti këtë situatë të Profetit vrapoj dhe mbuloi me rërë pështymën. I Dërguari i All-llahut më pas vazhdoi rrugën.

Pejgamberi urdhëronte rregullimin dhe mirëmbajtjen e rrobave, urrente joelegancën dhe mosmirëmbajtjen e flokëve dhe mjekrës. Një herë erdhi te Profeti i All-llahut një person i cili kishte flokët dhe mjekrën e çregullt, Profeti, simboli i elegancës, i pati bërë me shenjë këti personi që të rregullojë flokët dhe mjekrën. Pasi personi në fjalë rregulloi flokët dhe mjekrën Profeti i tha:

*“A nuk është më mirë kështu sesa shëtitja e kujt do nga ju me flokë e mjekër të hallakatur si shejtani” (Muvatta’, Shaar, 7)<sup>23</sup>*

Poashtu Profeti një ditë kishte parë një njeri me flokë të shkaravitura, i prekur nga rasti kishte thënë:

*“Për çfarë shkakut ky person nuk pastron dhe kreh flokët?”*

Kurse një herë kur kishte takuar një person i cili kishte të veshura rroba të ndyta, do të thoshte:

*“A thua ky njeri nuk ka mundësi të gjejë ujë për t’i pastruar teshat?”*

Shprehje kjo që na bën me dije se muslimanët duhet të jenë të pastër dhe të rregulluar mirë. (Ebu Davud, Libas, 14/4062; Nesai, Zinet, 60)

Një herë tjetër, kur një person i cili kishte të veshura rroba të papastërta dhe të çregullta Profeti me një herë e pyeti:

*“A ke pasuri? A mos je i sëmurë?”*

Kur personi iu përgjegj se është mirë dhe se nuk është i varfër, Pejgamberi i All-llahut ia tërhoqi vërejtjen e i tha:

*“Kur All-llahu të jep pasuri, le të shihen gjurmët e pasurisë në trupin tënd!”* (Ebu Davud, Libas, 14/4063; Nesai, Zinet, 54; Ahmed, IV, 137)

Kurse në një hadith tjetër Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) thotë:

*“All-llahu dëshiron që të shohë gjurmët e dhuntive mbi personin të cilit i jep pasuri.”* (Tirmidhi, Edeb, 54/2819; Ahmed, II, 311)

---

<sup>23</sup> Bejhaki, *Shuabu’l-Iman*, Bejrut 1990, V, 225

I Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ishte njeri i mëshirshëm, i butë, shpirt delikat dhe zemërgjërë.

Kur një person disa herë e thirrte Profetin në mënyrë banale “ O Muhammed, o Muhammed!”, Ai në një mënyrë të butë, për çdo herë përgjigjej:

*“Urdhëroni, çfarë dëshironi të thoni?”<sup>24</sup>*

I dërguari i All-llahut nga modestia që posedonte çdo herë, vetë, i gostiste mysafirët. (Bejhaki, *Shuab*, VI, 518, VII, 436)

Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) madje as edhe në fëmijëri nuk ka pasur ndonjë zënkë ose debat i cili do të njolloste personalitetin dhe njerëzshmërinë e Tij.

### **Ndjenja e turpfit dhe edukata e të Dërguarit të All-llahut**

Pejgamberi i All-llahu (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), kurrë nuk fliste me zë të lartë. Pranë njerëzve kalonte ngadalë e me buzëqeshje. Kur dëgjonte ndonjë fjalë banale të papëlqyeshme, nuk thoshte gjë, por ndryshimet në fytyrë ia reflektonin ndjenjat, prandaj njerëzit përreth tregoheshin të kujdesshëm në fjalët dhe lëvizjet e tyre. Nga turpi që kishtë, nuk qeshte kurrë me të madhe, vetëm buzëqeshej. Sipas transmetimeve të sahabëve, Ai ishte më i turpshëm se një vajzë e re e mbuluar. Në këtë kontekst janë edhe hadithet e Profetit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) :

*“Turpi është pjesë e besimit, njeriu i cili është i turpshëm është në Xhennet! Kurse paturpësia është prej zemrës së ngurët, e*

---

<sup>24</sup> Shih. Muslim, Nudhur, 8; Ebu Davud, Ejman, 21/3316; Tirmidhi, Zuhd, 50; Ahmed, IV, 239.

*kush ka zemër të ashpër do të jetë në Xhehennem!...*” (Buhari, Iman, 16)

*“Turpi dhe besimi janë bashkë, kur shkon njëra shkon edhe tjetra!...”* (Taberani, *Evsat*, VIII, 174; Bejhaki, *Shuab*, VI, 140)

*“Fjala banale nuk sjell gjë tjetër veçse turp! Kurse turpi dhe edukata zbukurojnë vendin ku hyjnë ata!...”* (Muslim, *Birr*, 78; Ebu Davud, *Xhihad*, 1)

Ndjenja e vërtetë e turpit fitohet “duke kujtuar vdekjen”, e cila është pretekst për të nxjerrë prej zemrës dashurinë për këtë botë. Hazreti Pejgamberi gjithmonë porosiste dhe këshillonte shokët që të kenë turp ashtu siç duhej, realisht prej All-llahut të Madhëruar. Një herë kur ata i thanë se gjithmonë e falenderojnë Zotin me turp, Profeti i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) u tha se turp i vërtetë është ruajtja e të gjitha gjymtyrëve të trupit nga gjërat e ndaluara, *haram* dhe kujtimi i vdekjes pa mos e larguar kurrë nga mendja. Më pas, shtoi se personi i cili don botën e ardhshme, *Ahiretin*, duhet që të braktisë dashurinë për këtë botë, dhe se vetëm të tillët mund të kenë turp nga All-llahu me të vërtetë. (Tirmidhi, *Kijamet*, 24)

I Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), nuk shikonte në fytyrë askë me vëmendje, më shumë shikonte në dhë se sa në qiell. Nga ndjenja e turpit dhe personalitetin e lartë që kishte nuk i përmendte askuj gabimin në sy.

Hazreti Aisheja (radiall-llahu anhu) përcjell se Profeti kur dëgjonte ndonjë lajm të papëlqyeshëm për dikë nuk thoshte:

*“Ç’u bë me aksh personin që thotë kështu...”,* por *“ç’u bë me disa persona që thuan kështu, ...”* (Ebu Davud, *Edeb*, 5/4788)

Herë herë Zotëriu ynë ia tërhiqte vërejtjen bashkëbisedusit me shprehje të butë, me qëllim të përkujtimit se Ai nuk arsyetonte gabimin, si bie fjala:

*“Ç’ndodh me mua që u shoh ju në këtë gjendje.”<sup>25</sup>*

Pejgamberi, i cili kujdesej që të mos prekej dhe ngushtohej edhe personi të cilin e këshillonte, është simbol i mëshirës së lartë.

### **Trimëria e të Dërguarit të All-llahut**

Është e pamundur të parafytyrohet një hero më i madh se i Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Nuk është dëgjuar se Ai është friguar dhe tmeruar ndonjëherë. Edhe përball situatave të jashtëzakonëshme, tregonte durim dhe qëndrueshmëri, nuk binte në frigë dhe panik dhe të bënte veprime të panatyrshme.

Kishte kaluar në mes të atyre që kishin ardhur për ta vrarë duke kënduar këta dy ajete të sures Jasin:

إِنَّا جَعَلْنَا فِي أَعْنَاقِهِمْ أَغْلَالًا فَهِيَ إِلَى الْأَذْقَانِ فَهُمْ مُقْمَحُونَ - وَجَعَلْنَا مِنْ بَيْنِ أَيْدِيهِمْ سَدًّا وَمِنْ خَلْفِهِمْ سَدًّا فَأَغْشَيْنَاهُمْ فَهُمْ لَا يُبْصِرُونَ -

**“Ne u kemi varur në qafat e tyre hallka, ato shtrihen deri në nofulla, prandaj ata mbajnë kokat e ngritura. Para u kemi vënë një pengesë, e edhe prapa tyre një pengesë, kështu ua mbyllëm sytë, tani ata nuk shohin dot më.”** (Jasin, 8-9)

Hazreti Aliu thotë:

---

<sup>25</sup> Buhari, Menakib 25, Ejman 3; Muslim, Salat, 119; Ibni Hibban, IV, 534.

*“Gjersa lufta në Bedër vazhdonte me tërë ashpërsinë, ne herë herë strehoheshim pas shpinës së Pejgamberit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Ai ishte më trimi dhe më i guximshmi nga të gjithë ne. Ai gjendej në rradhët më të afërta me armikun.”* (Ahmed, I, 86)

Në lidhje me trimërinë dhe guximin e të Dërguarit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) sahabiu Bera (radiall-llahu anhu) kështu shprehet:

*“Betohem në All-llahun, kur lufta ashpërsohej ne strehoheshim pas të Dërguarit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), vetëm më trimi nga ne mund të qëndronte në rradhë me të Dërguarin e All-llahut!”* (Muslim, Xhihad, 79)

Ai ishte luftëtari i cili gjithmonë luftonte në rradhën e parë për të lartësuar fenë e All-llahut mbi të gjithë fetë tjera. Në luftën e Hunejnit, në rastin kur në fillim të luftës në rradhët e ushtrisë islame u paraqit një shpërndarje, Ai nuk humbi aspak sigurinë, u hodh në mesin e rradhëve të armikut hapërojë përpara me kalin e tij që ngiste, dhe shtoi trimërinë e as’habëve dhe, më në fund, me ndihmën e All-llahut u arrit fitorja!

I Dërguari i All-llahut thoshte kështu:

*“Betohem në All-llahun, me fuqinë dhe ndihmën e të cilit jetoj, dëshiroja të bije shehid, dëshmorë në luftë në rrugë të All-llahut dhe të ringjallem për të rënë shehid përsëri!...”* (Muslim, Imare, 103)

### **Butësia e të Dërguarit të All-llahut**

I Dërguari i All-llahut ishte më i buti i llojit njerëzor. (Muslim, Haxh, 137)

Ja çka thotë në këtë kontekst Ajsheja (radiall-llahu anha):

“Nuk ekziston njeri që ka moral të bukur si të Dërguarit të All-llahut. Kushdo nga anëtarët e familjes dhe shokët që e thirrte Atë, Ai menjëherë përgjigjej me: “*Urdhëroni*”, për këtë shkak edhe All-llahu i Madhëruar do të zbresë këtë ajet kur’anor:

”Me të vërtetë ti je në shkallën më të lartë të moralit.” (el-Kalem, 4)

Zotëriu ynë asnjëherë në jetë nuk është hakmarrë. Ja si e përshkruan dhembshurinë, mëshirën dhe bamirësinë e Tij Hazreti Aisheja (radiall-llahu anha) :

*“Ai nuk përçmonte askënd, nuk i përgjigjej me ashpërsi askuj, me çdokë sillej me butësi, tolerancë dhe falje, qëndronte larg të shëmtuarës. Nuk është hakmarrë për veten ndaj askuj. Nuk ka prekur me padrejtësi asnjë shërbyes, fëmij, madje asnjë kafshë..”<sup>26</sup>*

Enesi ( radiall-llahu anhu) kështu e përshkruan Krenarinë e Gjithësisë Profetin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem):

“Unë kurrë nuk kam prekur ndonjë atlas ose mëndafsh më të butë se dora e të Dërguarit të All-llahut. Nuk kam ndjerë aromë më të këndëshme se aroma e të Dërguarit të All-llahut. I kam shërbyer Zotëriut tonë dhjet vjetë të tëra Ai qoftë edhe një herë nuk më ka thënë >>uf<<. Nuk më ka thënë për gjërat që bëja unë as >> Pse e bëre kështu?<<, e as për atë që nuk e bëja >>A nuk do të ishte më mirë që të kishte vepruar kështu?<< . (Buhari, Saum 53, Menakib 23; Muslim, Fedail 82)

I Dërgari i All-llahut kishte lëvduar një sahabi duke i thënë:

---

<sup>26</sup> Shih, Muslim, Fedail, 79



*“Ti posedon dy virtyte që All-llahu i don: butësi dhe largëpamësi.”* (Muslim, Iman 25, 26)

Një beduin një herë kishte urinuar në një skaj të faltores së të Dërguarit. Shokët e të Dërguarit të All-llahut të prekur nga ky akt banal, e sulmuan këtë person. Në këtë rast Profeti i All-llahut intervenoi dhe tha:

*“Lereni të qetë njeriun, dhe derdhni një kovë ujë në atë vend. Ju nuk jeni zgjedhur për të ngarkuar njerëzit, por për t’iu lehtësuar.”* (Buhari, Vudu’ 58, Edeb 80)

E më pas i shpjegoi këtij personi rëndësinë dhe vlerën e faltores, xhamisë.

Enesi (radiall-llahu anhu) rrëfen:

“Shëtiteshim së bashku me të Dërguarin e All-llahut, Ai kishte të veshur një hirkë prej stofit të quajtur nexhran, me skaje të forta dhe të trasha. Një beduin vrapoi dhe e arriti të Dërguarin e All-llahut, dhe e tërhoqi fortë për hirke. Shikova në pjesën e qafës ku arrinte hirka, vërejta se në trupin e ndershëm të të Dërguarit Fisnik gjendeshin gjurmë si pasojë e tërheqjes së fortë të bedunit. Më pas beduini iu drejtua Profetit dhe i tha:

“O Muhammed! Urdhëro që të më japin diçka nga pasuria e All-llahut!”

Krenaria e Gjithësisë, Zotëriu ynë Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) u drejtua nga beduini dhe i buzëqeshi. Pastaj urdhëroi që atij t’i dhurohet diçka nga arka shtetërore. (Buhari, Humus 19, Libas 18, Edeb 68; Muslim, Zekat 128)

Përfundimisht, edhe rezultati madhor që arriti Ai në detyrën e kumtimit vinte nga begatitë e këtyre virtyteve dhe situatave të

larta. All-llahu i Madhëruar këtë persosshmëri dhe maturi të të Dërguarit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) në një ajet kur'anor e përshkruan në këtë mënyrë:

فَبِمَا رَحْمَةٍ مِنَ اللَّهِ لِنْتَ لَهُمْ وَلَوْ كُنْتَ فَظًّا غَلِيظَ الْقَلْبِ لَانفَضُّوا مِنْ حَوْلِكَ

“(O Pejgamber) Ti ish te i butë ndaj tyre, ngase All-llahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishte i vrazhdë e zemërfortë, ata do të largoheshin prej teje...” (Alii Imran, 159)

Me të vërtetë, njerëzit injorantë të asaj bote, do të shkrihen si qiri para personalitetit të Tij të butë, të mëshirshëm e falës, moralit të bukur, natyrës së Tij të butë dhe tolerante, mëshirës e faljes, dhe duke u çliruar nga duart e të egërve dhe të pandërgjegjshmëve do të shndërrohen si fluturat rreth Dritës së njerëzimit, ngaqë Ai nuk dëshironte devijimin por udhëzimin e njerëzimit. Nuk përfaqësonte arrogancën, por mëshirën.

### Mëshira dhe dhembshuria e të Dërguarit të All-llahut

I Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) në një hadith thotë:

*“Ata të cilët mëshirojnë, do t’i mëshirojë All-llahu i Lartë i cili është i Mëshirshëm, Rahman. Mëshironi dhe kini dhembshuri ndaj atyre që janë në tokë , që t’ ju mëshirojnë ata që janë në qiell.”* (Tirmidhi, Birr, 16/1924)

Shenjat më prekëse dhe më të thella të dhembshurisë dhe mëshirës së gjerë që posedonte Pejgamberi i All-llahut janë; lejimi për të shkurtuar namazin me qëllim që e ëma sa më parë të arrijë te fëmija, me qëllim që fëmja të mos bjerrë në ndonjë situatë të

vështirë, lotët që Ai derdhte në net të tëra duke u lutur për ummetin, ndjekësit e Tij, harxhimi i gjithë kohës për të shpëtuar njerëzit nga zjarri i Xhehennemit.

Meqë Hazreti Pejgamberi është i dërguar mëshirë për të gjithë botët, dashuria dhe mëshira e Tij e gjerë përfshin çdo gjallesë. Një ditë kërkuan nga Ai që të mallkojë, kurse Ai u përgjigj e tha:

*“Unë nuk jam i dërguar në botë për mallkim, unë jam pejgamber i mëshirës.* (Muslim, Fedail, 126; Tirmidhîi, Deavat, 118)

Kur vajti në Taif për të kumtuar Fenë Islame, politeistët injorantë dhe populli egoist i Taifit e gjuajtën me gurë Atë. Meleku i shpalljes, Xhebraili erdhi dhe i tha të Dërguarit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem):

*“A dëshiron ta shkatërroj këtë popull duke i përplasur me njëri tjetrin këta dy male?”* I Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) nuk u pajtua dhe iu përgjigj:

*“Jo, i lutem Zotit të Vërtetë që t’i bëjë pasardhësit e tyre një soj i cili do të adhurojë All-llahun dhe nuk do t’i bëjë shokë Atij në besim...”* (Buhari, Bed’u’l-halk, 7; Muslim, Xhihad, 111)

Profeti i është lutur Zotit të Lartë për popullin e Taifit, popull ky i cili e nxori Atë nga qyteti i tyre duke e gjuajtur me gurë dhe u sollën dëme të mëdha muslimanëve deri në vitin e 9-të të Hixhretit, me këtë lutje:

*“O Zot! Udhëzoje fisin Sakif! Bëri ata që të vijnë tek ne!”*

Në fund, lutja e Profetit u pranua dhe populli i qytetit të Taifit do të pranojë Fenë Islame. (Ibni Hisham, IV, 134; Tirmidhi, Menakib, 73/3942)

Ebu Usejdi (radiall-llahu anhu) një ditë erdhi tek Pejgamberi ynë me disa pengje të sjellë nga Bahrejni. I Dërguari i All-llahut e vërejti një grua pengje që vajtonte, dhe e pyeti:

*“Ç’ke që po qanë?”*

Gruaja u përgjigj:

“Ky njeri më shiti birin tim.”

I Dërguari i All-llahut e pyeti Ebu Usejdin:

*“A me të vërtetë e ke shitur birin e saj?”*

“Po” u përgjigj sahabiu. Atëherë Pejgamberi e pyeti:

*“Kujt ia ke shitur?”*

Sahabiu tha:

*“Bijëve të Absit”*

Atëherë i Dërguari i All-llahut urdhëroi e tha:

*“Menjëherë shalo kalin, shko dhe sjellja gruas të birin.”<sup>27</sup>*

Ummu’l Kajs bint Mihsan rrëfen:

“Më kishte vdekur i biri. Për këtë shkak isha mërzitur shumë, dhe nën emocione iu drejtova personit i cili bënte larjen e të birit e i thash:

‘Mos laj birin tim me ujë të ftohtë, do të mbysësh atë!’

Ukashe (radiall-llahu anha) me njëherë vrapoi dhe lajmëroi Profetin për atë që kisha thënë unë. Pejgamberi i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) buzëqeshi e tha:

*“Nëse ka thënë ashtu, atëherë do t’i zgjatet jeta”*

---

<sup>27</sup> Ali el-Muttaki el-Hindi, *Kenzu’l-ummal*, Bejrut 1985, IV, 176/10044.

Përcjellësi i hadithit, thotë: “Ne nuk dimë që dikush tjetër të ketë jetuar sa kjo grua.” (Nesai, Xhenaiz, 29)

Mëshira dhe dhembshuria e të Dërguarit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ishin cilësi gjith përfshirëse. Ai një ditë kishte thënë:

*“Betohem në All-llahun, në duart e të cilit është shpirti im, se nuk do të hyni në Xhennet gjersa nuk duheni ndërmjet vete.”*

Shokët e Tij të ndershëm thanë:

“Të gjith jemi të mëshirshëm, o i Dërguar i All-llahut”.

I Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) tha:

*“Mëshira për të cilën e kam fjalën unë, nuk është mëshira që kuptoni ju, mëshirë vetëm ndërmjet jush. Por, është mëshirë që i përfshin të gjith krijesat, po, mëshirë që i përfshin të gjith krijesat!”* (Hakim, IV, 185/7310)

### **I Dërguari i All-llahut ishte falës**

Zoti i Vërtetë e do faljen. All-llahu i Lartë premtan se do t’ia pranojë pendimin atij i cili pendohet me zemër dhe ndjen vuajtje për gabimet e bëra. Meqë All-llahu është shumë falës kërkon edhe nga robërit e tij të jenë falës.

Kusht i faljes është pendimi, respektimi i urdhërave të All-llahut dhe ruajtja prej gjërave të ndaluara, haram. Shembujt më të bukur dhe më konkret për faljen gjenden në jetën e të Dërguarit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem).

Ai e fali gruan e quajtur Hind, grua kjo që kishte përbi me kënaqëqsi mushkëritë e Hazreti Hamzës, ungjit të Pejgamberit, në luftën e Uhudit, vetëm pse ajo ishte bërë muslimane.

Edhe Habbar bin Esved ishte njëri ndër armiqtë e dalluar të Fesë Islame. Ai ishte personi që kishte rëzuar nga deveja bijën e të Dërguarit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) Hazreti Zejneben, duke e gjuajtur me shigjetë, gjersa ajo emigronte, bënte hixhret, nga Mekka në Medinë. Hazreti Zejnebja shtatëzënë, e pati dështuar fëmijën dhe ishte plagosur rëndë. Kjo plagë, më vonë, do të jetë edhe shkak për vdekjen e saj. Habbari pati bërë edhe faje tjera të ngjajshme me këtë. Ai, pas çlirimit të Mekkes, u largu nga Mekka dhe u fsheh diku. Një ditë kur Pejgamberi i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) kuvendonte me shokët e Tij, Habbari erdhi dhe u ul para Profetit dhe e lajmëroi se kishte pranuar Fenë Islame. Hazreti Pejgamberi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) e fali, madje, e ndaloi fyryjen dhe sharjen ndaj tij. (Vakidi, II, 857-858)

Ikrime, i biri i Ebu Xhehlit, ishte poashtu njëri ndër armiqtë e përbetuar të Islamit. Ai ishte arratisur në Jemen pas çlirimit të Mekkes. Bashkëshortja e tij e cila ishte bërë muslimane, e ftoi atë dhe e dërgoi te Profeti i Mëshirës (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). I Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) e priti me nderë Ikrimen, e i tha:

*“Mirësenerdhe, o kalorës refugjatë.”* Ku dhe e ndaloi që t’i përmendet në fytyrë terori që ai dhe i ati i tij kishin ushtrua ndaj muslimanëve. (Tirmidhi, Isti’dhan, 34/2735)

Pejgamberi i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) shpesh lutej:

*“O Zoti im, fale ummetin tim se ata nuk dinë.”* (Ibni Maxhe, Menasik, 56; Ahmed, IV, 14)

Prijësi i Jemames, Sumame bin Usal pasi u bë musliman, i ndërpreu marrëdhëniet tregtare me politeistët e Mekkës në një kohë kur Kurejshit Mekkas furnizoheshin me produkte ushqimore nga Jemame. Mekkasit e hutuar iu drejtuan Pejgamberit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), i cili i shkroi letër Sumames dhe e urdhëroi atë që ta vazhdonte tregtinë me mekkasit.<sup>28</sup>

Kurse këta, politeistët mekas, ishin ata që i patën munduar me uri muslimanët për tri vjet me radhë! Krenarie e Gjithësisë, Pejgamberi i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), madje, edhe këta i fali!

Edhe më tepër, Profeti i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) në vitin e 7 të Hixhretit, pas çlirimit të Hajberit, do të ndihmojë popullin e Mekkës, të cilin e kishte kapluar një thatësi dhe skamje, me flori, elb dhe hurma. Ebu Sufjani do t’i pranojë të gjithë këta dhe do t’ua ndajë të varfërve dhe skamnorëve në Mekkë, dhe do të shprehë mirnjohjen me këta fjalë:

“All-llahu e shpërbleftë me të mira të birin e vëllaut tim! Meqë ai u kujdes për farefisën e tij!” (Ja’kubi, II, 56)

Pas një kohe të shkurtë, populli i Mekkës, i cili u përkul para këtij virtyti të lartë të Profetit, që të gjithë u bënë muslimanë!

Në Hudejbije një grup njerëz kishin ardhur për ta vrarë të Dërguarin e All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), dhe të gjithë ishin kapur. Profeti i fali edhe këta. (Muslim, Xhihad, 132, 133)

---

<sup>28</sup> Ibni Abdilberr, *el-Istiab*, Kajro (pa vit botimi), I, 214-215; Ibni Ethir, *Usdu’l-gabe*, Kajro 1970, I, 295.

Pas çlirimit të Hajberit një grua kishte futur helm në gjellën e të Dërguarit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Pejgamberi sa po e futi në gojë mishin, e dalloi se ishte i helmuar. Edhe pse gruaja çifute pranoi se kishte futur helm në gjellë me qëllim që të helmojë Muhammedin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), Pejgamberi simboli i mëshirës e fali edhe atë. (Buhari, Tëbb, 55; Muslim, Selam, 43)

Profeti ishte i informuar me revelatë, *vahj*, për këtë kurth që kishte synuar hipokritja çifute Lebid dhe të tjerët të cilët e nxitën atë. Por Ai, asnjëherë nuk ia përmendi në fytyrë këtë faj Lebides, as që vrau ndonjë nga fisi i saj hebre Beni Zurajk,<sup>29</sup> sepse në Kur'an thuhet:

**“(O i Dërguar!) Ti zër rrugën e faljes, fal, urdhëro për të mirë dhe largohu prej injorantëve!”** (el-A'raf, 199)

### **I Dërguari i All-llahut dhe hakku i fqinjëve**

Hazreti Pejgamberi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) dëshironte që të tregohet shumë kujdes ndaj hakkut të fqinjëve. Në një hadith ai thotë;

*“Xhebraili aq shumë më porosiste për të mirë ndaj fqinjëve, gjersa, unë kujtoja se edhe fqinjët do të jenë prej atyre që do të trashëgojnë fqinjin.”* (Buhari, Edeb, 28; Muslim, Birr, 140-141)

Kurse në një hadith tjetër ka porositur:

---

<sup>29</sup> Shih. Ibni Sa'd, II, 197; Buhari, Tëbb, 47, 49; Muslim, Selam, 43; Nesai, Tahrim, 20; Ahmed, IV, 367, VI, 57; Ajni, XXI, 282.



*“Fqinji jomusliman, ka një hakk. Fqinji musliaman ka dy hakke. Fqinji që është edhe musliman edhe farefis ka tri hakke.”*<sup>30</sup>

Nga të drejtat e fqinjit janë: të mos shikosh në penxheren e tij, të mos e shqetësosh me aromën e gjellës që gatuan, të mos sillesh në mënyrë të papëlqyeshme ndaj tij!

Krenaria e Gjithësis, Profeti (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë:

*“...më i mirë tek Allâhu i Lartë është ai i cili është më i mirë për fqinjin e tij.”* (Tirmidhi, Birr, 28)

*“Nuk është besimtar i vërtetë ai i cili fle i ngopur, gjersa komshiu i tij është i uritur.”* (Hakim, II, 15/2166)

Shoku i Profetit, Hazreti Ebu Dher Gifari ka thënë:

*“I Dërguari i All-llahut më ka porositur që kur të pregatis gjellë t’i shtoj ujë më tepër e t’iu ndaj prej saj edhe fqinjëve..!”* (Ibni Maxhe, Et’ime, 58)

Ebu Dherri ishte njëri ndër sahabët e varfër. Domethënë, nga hadithi i të Dërguarit të All-llahut, mund të kuptojmë se skamja nuk mund të jetë arsye për hakkun, të drejtat e komshiut.

Intepretohet nga Ebu Hurejreja (radiall-llahu anhu) se i Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) një ditë tha:

*“Pasha Zotin, nuk është besimtar i vërtetë, pasha Zotin nuk është besimtar i vërtetë!”*

Sahabët që ishin prezent e pyetën:

---

<sup>30</sup> Sujuti, *el-Xhamiu’s-Sagir*, Egjipt 1321, I, 146.

“-Kush nuk është besimtar, i vërtetë o i Dërguar i All-llahut?”

Zotëriu ynë u përgjigj:

*“Personi, nga veprat e të cilit nuk janë në siguri fqinjët e tij!”*

(Buhari, Edeb, 29; Muslim, Iman, 73; Tirmidhi, Kijamet, 60)

Kurse, sipas një përcellje tjetër ka thënë:

*“Nuk do të hyjë në Xhennet ai person, nga veprat e të cilit nuk ndjehen të sigurt komshinjtë e tij.”* (Muslim, Iman, 73)

### **Sjellja e të Dërguarit të All-llahut ndaj të varfërve**

Profeti ynë njihej me butësinë dhe dhemshurinë që kishte ndaj të varfërve, jetimëve, të vetmuarve dhe vejanëve. (Buhari, Nafakat, 1; Muslim, Zuhd, 41-42) Profeti sillej me shumë mëshirë ndaj personave të cilët ishin në nivel të ulët të mirëqenies materiale.

Sahabiu Ebu Said (radiall-llahu anhu) tregon:

“Isha ulur së bashku me një grup skamnorësh muhaxhirë, disa nga këta, meqë nuk posedonin rroba që të mbulonin tërë trupin, orvateshin të mbulohen me teshat e të tjerëve. Dikush lexonte Kur’an. Pa pritur, në faltore hyri i Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) dhe u ul pran nesh. Personi që lexonte Kur’an e ndërpreu leximin me ardhjen e Profetit. Pejgamberi ynë pasi na dha selam, na pyeti:

*«Çfar jeni duke bërë?»*

Iu përgjigjëm;

«O i Dërguar i All-llahut, ky është mësuesi ynë, lexon Kur’an, e ne e dëgjojmë librin e All-llahut të Lartë».

Atëherë Krenaria e Gjithësisë Profeti (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) tha:

*«Falënderimi i takon All-llahut, i cili më krijoi dhe më mundësoi të jemë prej dhe sëbashku me ummetin tim të cilët janë urdhëruar të jenë të durueshëm!»<sup>31</sup>*

Më pas i Dërguari i All-llahut u ul në mes nesh, dhe me një modesti të lartë urdhëroi të ulemi në formë rrethi. Pasi u ulëm, të gjithë e kthyem fytyrën kah Profeti i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) e Ai na dha këtë myzhde, sihariq:

*«Përgëzime, myzhde për ju o muhaxhirë të varfër! Juve u përgëzoj me një dritë, nur të vërtetë. Ju do të hyni në Xhennet gjysmë dite para të pasurve! Kjo gjysmë dite, është e barabartë me pesëqindë vjet të kësaj bote.»* (Ebu Davud, Ilim, 13/3666)

Një ditë gjersa i Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) në Medine ishte duke ndejtur, erdhi një fis shumë i varfër dhe i mjerë. Këmbët i kishin të zbathura, lëkura u ishte ngjitur për kockash nga të nxehtit dhe urria. Pejgamberi u prek shumë, e urdhëroi Bilalin të këndonte ezanin. Gjersa Bilali e këndonte ezanin as'habët e të Dërguarit të All-llahut u tubuan. Profeti (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), i urdhëroi ata që t'i zgjasin dorën e t'i ndihmojnë këtij fisi të varfër. As'habët së bashku me Pejgamberin u ndanë ndihma të shumta këtyre

---

<sup>31</sup> Pejgameri i All-llahut me këtë hadith aludon në këtë ajet kur'anor të sures el-Kehf: "Ti personalisht, duro së bashku me ata që lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë (*razinë*) e All-llahut, dhe mos i hiq sytë e tu prej tyre e të kërkosh bukurinë e kësaj bote, dhe mos iu bind atij që ia kemi shmangur zemrën e tij prej përkujtimit Tonë dhe i është dhënë epshit të vetpse puna e tij ka mbaruar!" (el-Kehf, 28) Me këtë ajet All-llahu i lartë e porositi Profetin Fisnik që të jetë prej durimtarëve dhe të sillet me butësi dhe dhembshuri ndaj të varfërve dhe skamnorrëve, të cilët ishin edhe të parët që përqaftuan Fenë Islame.

personave të mjerë. Profeti u gëzua shumë me bujarinë e sahabive. (Muslim, Zekat, 69-70; Ahmed, IV, 358, 361)

Jeta e të Dërguarit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) është e mbushur me shumë paraqitje mrekullore, mësimdhënëse, drejtësie, ndershmërie besnikërie, dhembshurie, mëshire dhe butësie. Ai shpesh e këshillonte dhe porosiste gruan e Tij Aishen (radiall-llahu anha) duke i thënë kështu:

*“Oj Aishe! Kurrë mos e kthe prapë të varfërin, ndihmoje atë qoftë edhe me një gjysmë hurme. Oj Aishe! Duaji dhe afroji të varfërit, që të të afrojë All-llahu Ditën e Kiametit”.* (Tirmidhi, Zuhd, 37/2352)

Shoku i të Dërguarit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) Abbad bin Shurahbil (radiall-llahu anhu) rrëfen:

Një herë më kaploj varfëria, për këtë shkak hyra në njërin nga kopshtet e Medines, mbledha kallinjë, çorova, e mbusha trastën dhe ca hëngra. Në ndërkohë erdhi pronari i kopshtit, më zuri e më rahu, më mori trastën dhe më përcolli deri te i Dërguari i All-llahut. Pasi i rrëfeu ngjarjen të Dërguarit të Allahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), Ai iu drejtua pronarit të kopshtit e i tha:

*“Nuk e ke mësuar atë gjersa ai nuk dinte, nuk e ke ushqyer gjersa ai ishte i urritur!”.*

Dhe më pas urdhëroi pronarin e kopshtit që të më kthej trastën, dhe më dhuroj një, ose gjysëm tasi ushqim. (Ebu Davud, Xhihad, 85/2620-2621; Nesai, Kudat, 21)

Sipas jurisprudencës islame, fillimisht duhet studiuar shkaku i fajit, e më pas duhet orvatur të premisohet fajtori. Shikuar nga

ky këndëvshtrim dënimet në të drejtën islame kanë qëllim edukues, sikur dënimet e prindërve për fëmijët e tyre. Këtu nuk synohet përjashtimi dhe largimi i fajtorit nga shoqëria, por që njeriu të jetë i dobishëm për shoqërinë.

### **Trajtimi i robërve dhe shërbyesve nga i Dërguari i All-llahut**

Dhembshuria dhe mëshira e të Dërguarit të All-llahut përfshin edhe pengjet e luftës. Profeti urdhëron që ata të trajtohen mirë. Ebu Azizi, vëllau i sahabiut të njohur Mus'ab bin Umejr, rrëfen këtë ngjarje mësimdhënëse:

“Në luftën e Bedrit, edhe unë isha ndër ata të cilët qenë zënë robë. Unë ndodhesha nën kontrollin e një grupi të ensarëve. I Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) vazhdimisht ka urdhëruar e potencuar:

*«Trajtoni mirë robërit e luftës!»*

Pjestarët ensarë të cilët ishin me mua, për të dëshmuar se e respektojnë këtë urdhër të Profetit, hisen e bukës që u takonte atyre për ushqim të mëngjesit dhe darkës më dhuronin mua, kurse vet mjaftonin vetëm me hurma. Unë turpërohesha nga kjo sjellje, dhe i dhuroja bukën dikuj tjetër nga ata, por edhe ai pa e prekur fare më kthente përsëri mua.” (Hejthemi, VI, 86; Ibni Hisham, II, 288)

I Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), ka synuar të mënjanoj sistemin e skllavërisë, sistem ky i cili ka një të kaluar të gjatë, dhe ka hapëruar shumë në këtë drejtim. Ai, vazhdimisht nxiti lirim të skllavëve, dhe potencon se kjo vepër është një ibadet, adhurim madhor. Çdo herë kur ndonjë besimtar

kryen ndonjë vepër për të cilën duhet të paguaj *kefare*, dëmshpërblim, në radhë të parë, Profeti, ka theksuar e porositur lirimin e skllëvërve. Miku më i afërt i Tij Ebu Bekri (radiall-llahu anhu), ka harxhuar shumicën e pasurisë së tij, me nxitjen e Profetit, në lirim të skllëvërve.

Një ditë, Profeti ynë u bë dëshmitar i trajtimit të ashpër, por pa dashje, nga Ebu Dheri (radiall-llahu anhu) skllavin e tij. Pejgamberi u hidhërua shumë dhe tha:

*“O Eba Dher! Athua ti akoma vazhdon me zakonet e kohës së injorancës?”* Dhe vazhdoi:

*“Mos dëmto krijesën e All-llahut! Nëse nuk të konvenon, atëherë liroje! Mos e ngarko tepër, po e ngarkove, ndihmoje!”*  
(Buhari, İman, 22; Muslim, Ejman, 38; Ebu Davud, Edeb, 123-124)

Një njeri kishte martuar skllaven e vet me skllavin e tij. Më pas donte që t'i shkurorëzoi ata. Skllavi e lajmëroi për këtë të Dërguarin e All-llahut, e Ai urdhëroi pronarin e skllëvërve dhe i tha:

*“Ty nuk të përket e drejta e martesës dhe e shkurorëzimit! Ti mos u përziej në këtë punë!”* (Ibni Maxhe, Talak, 31; Taberani, *Kebir*, XI, 300)

Kjo dhe përgjegjësi të tjera, ndikuan që sahabët gjithmonë të preferojnë lirimin e skllëvërve. Dhe në këtë mënyrë, skllëvëria ngadal ngadalë u çrrënjos në tërësi. Domethënë, Islami është ai faktor që nxori nga qafët e njërëzimit zinxhirin e skllëvërisë, njëerën ndër realitetet e të drejtës së luftës.

Islami vazhdimisht porosit pronarin e skllëvërve që “të ushqejë skllavin me atë që ushqehet vetë pronari, t'i japë të pijë

atë që pi vetë pronari, t'a vesh me rrobat që vesh vetë pronari, të mos e ngarkoj tepër kur ai është me agjërim!". Për besimtarin nuk ekziston ndonjë rrugë dhe vepër më e mirë për të fituar shpëtimin se sa lirimi i skllavërve. Islami ka sjellë rregulla të tilla për skllavërinë, gjersa, për personin i cili i përfill dhe respekton ato rregulla, është më mirë të mos posedojë se sa të posedojë skllavër. Të posedosh skllavër, është sikur të jeshë i skllavëruar.

I Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) pak para se të ndërrojë jetë, u dha këtë amanet besimtarëve:

*"Namazain, në veçanti keni kujdes namazin. Frigohuni All-llahut për hakkun, të drejtat e atyre që posedoni në duart tua!"*  
(Ebu Davud, Edeb, 123-124/5156; Ibni Maxhe, Vasaya, 1)

I Dërguari i All-llahu (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), i ka mbyllë dyert e hyrjes së skllavërisë, kurse i ka hapur deri në fund dyert e daljes së skllavërisë, dhe vazhdimisht ka porositur dhe preferuar çlirimin e personave të skllavëruar. A thua mund të ekzistojë ndonjë model më i mirë se ky për të përfunduar skllavërinë.

Shembulli në vijim do të jetë i mjaftueshëm për të kuptuar se në çfarë pozite e ka ngritur Islami skllavërinë. Siç e dimë, Bilal Habeshiu ishte një skllav zezak. Me pranimin e Fesë Islame ai u bë muezini kryesor i Pejgamberit, dhe prijësi i të gjithë muezinëve deri në Ditën e Kiametit. Për këtë, dëshmi të gjalla janë *levhat*, tabelat me mbishkrim <<*Ja, Hazreti Bilal Habeshi (O Hazreti Bilal Habeshi)*>> të cilat zakonisht qëndrojnë në mahfilet e xhamive, monumente këto të cilat janë shembëlltyrë të qytetërimit islam.

Thënë ndryshe Islami e ka ngritur skllavin në pozitë të zotëriut. Madje edhe politeistët në fillim të revelimit, e kanë kundërshtuar Islamin mu për këtë shkak. A thua nuk bartin cilësi të njëjta edhe mohuesit e ditëve tona, të shekullit XXI? Athua nuk trajtojn si skllevër shumë njerëz të lirë edhe grabitësit e sotshëm? A nuk uzrpojnë të drejtat e njerëzve të mjerë dhe të ngratë, edhe atë në emër të lirisë, vetëm e vetëm për të të shfrytëzuar pasuritë materiale? A thua ka dallim ndërmjet skllavërimit dhe robërimit modern, i cili emërohet sot me terme të ëmbël për dëgjuesit, dhe tiranëve të së kaluarës?

Atëherë, Islami, i cili dje me parimet dhe përgjegjësitë e veta të larta e zbriti në zero, e më pas e largoi për gjithmonë, skllavërinë, edhe sot duhet të jetë reçetë e njerëzimit, që me qëndrimet që posedon të lartësojë vlerat njerëzore. Në të kundërtën njerëzimi do të shkatërrohet nën kthetrat e mendësisë që emërohet liri, por në realitet është pragmatizëm i skajshëm. Ku është lartësia e Islamit, Profeti i të cilës vëndoi kriteret e të drejtës, *hakkut*, të robërve të luftës dhe shërbëtorëve, duke potencuar me gojën e Tij të bekuar në çdo moment këtë hadith:

*“Ata janë vëllezërit tuaj; ushqeni ata me çka ushqeheni vetë ju; jepuni të pinë çka pini ju!”<sup>32</sup> ...*

Për këtë themi se, zgjedhje e vetme për çlirimin e njerëzimit, ashtu siç ishte dje, edhe sot është ndjekja e rrugës së Hazreti Pejgamberit, Muhammedit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Lidhja me Atë, ngaqë Ai e ka llogaritur çdo njeri, qoftë i pasur ose i varfër, pundhënës -punëtor, pronar-shërbëtor, i çfardo profesioni e pozite sociale qoftë. Si njeri, i ka dhuruar njerëzimit kritere të

---

<sup>32</sup> Muslim, Ejman, 36-38.



palëkundshme për nderë të dinjitetit njerëzor, deri në atë masë sa që shokëve të Tij të cilët e pyetnin:

“Gjatë ditës sa herë të falim gabimet e shërbëtorët?”

Profeti u është përgjigjur:

*“Çdo ditë nga shtatëdhjetë herë faluani!”* (Ebu Davud, Edeb, 123-124/5164; Tirmidhi, Birr, 31/1949)

Sa e kuptimtë është kjo këshillë e Oqeanit të Mëshirës, Profetit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem):

*“Kur dikuj nga ju shërbyesi ia sjell gjellën, nëse nuk e ul edhe atë në tryezë, le t’i jep atij një kafshatë ose diçka nga gjella, ngaqë me mundin e tij është përegatitur ajo.”* (Buhari, Et’ime, 55; Tirmidhi, Et’ime, 44)

Sikur të donte All-llahu i Madhëruar, do të ndodhte e kundërta: ju do të ishit skllëvër dhe robër të tyre. Atëherë, falënderoni All-llahun dhe trajtoni mirë ata.

### **Trajtimi i grave nga i Dërguari i All-llahut**

Në periudhën paraislamike të injorancës femrat trajtoheshin në atë mënyrë që dinjiteti i tyre nëpërkëmbej. Nga friga që kur të rriten të mos bëheshin prostitute, vajzat gropoheshin pa mëshirë për së gjalli. Me ndërgjegjet e ngurtësuar, në emër të ruajtjes nga fatkeqësia, kryhej një krim më i rëndë se fatkeqësia. Ja si e përshkruan All-llahu i Lartë gjendjen e mjerë të atyre njerëzve në ajetin 58 të sures en-Nahl në Kur’ani Fisnik:

**“Kur ndonjëri prej tyre lajmërohet me (lindjen) vajzë, fytyra e tij i prishet dhe bëhet plot mllef!”**

Gratë dhe vajzat nënçmoheshin duke i parë si mjet dëfrimi në një mënyrë që e thyente dinjitetin e tyre.

Me urdhërin e të Dërguarit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) u ngrit e drejta e femrës. Femra u bë shembull i nderit dhe e vlerës në shoqëri. Institucioni amënor u bë i nderuar.

Femra fitoi vlerën të cilën e meritonte me anë të hadithit të Muhammedit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem):

*“Xhennneti është nën këmbët e nënave!”<sup>33</sup>*

Sa i bukur është ky shembull për të kuptuar se sa Pejgamberi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) i nderonte dhe çmonte femrat:

Gjatë një udhëtimi shërbetorja e quajtur Enxheshe i nxiste devet duke kënduar.<sup>34</sup> Pejgamberi ynë (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), duke përdorur një shprehje të figurshme dhe delikate ia tërhoqi vëmendjen skllaves mbi mundësinë e dëmtimit të trupit të hollë të femrave, që ishin mbi deve, nga nxitimi i tepërt i tyre:

*“Oj Enxheshe! Ki kujdes që të mos thyhen xhamat!”* (Buhari, Edeb, 95; Ahmed, III, 117)

Në një hadith tjetër Hazreti Pejgamberi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) thotë:

*“O Zoti im! Ëu tërheq vëmendjen të gjithëve, të kenë kujdes që të mos keqpërdorin hakkun, të drejtën e dy të dobtëve: femrës dhe jetimit.”* (İbni Maxhe, Edeb, 6)

---

<sup>33</sup> Nesai, Xhihad, 6; Ahmed, III, 429; Sujuti, I, 125.

<sup>34</sup> Devet tërhiqen nga zëri i bukur dhe muzika. Barinjtë e deveve e shfrytëzojnë këtë veçori dhe këndojn këngë për të shpejtuar kopetë. Ky veprim në gjuhën arabe quhet *hida*.

*“Të mos keqtrajtojë asnjë musliman gruan e vet. Nëse nuk pelqen një shprehi të saj, pëlqen ndonjë shprehi tjetër.”* (Muslim, Rada`, 61)

Ngaqë, thënë realisht, femra nuk është një gjembore që meriton përçmim, por një trëndafilishte e cila meriton dashuri dhe nderë. Kjo dashuri, që i takon femrës, është dhuratë hyjnore nga vetë All-llahu i Lartë. Edhe i Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) në një hadith thotë: *“Nga bota juaj për mua, femrat dhe erërat e mira më janë bërë të dashura, kurse namazi më është bërë drita e syve.”* (Nesai, Iashretu’n-Nisa, 10; Ahmed, III, 128, 199)

Nuk duhet shikuar me sy përçmues faktin që All-llahu i Lartë ia bëri Profetit të dashura femrat, në trupin e të cilave formësohet njeriu.<sup>35</sup> Duhet ditur se kjo dashuri, është dashuria të cilën Zoti i Vërtetë e ka vendosur në natyrën e njeriut, dhe dashuri e cila është një shkallë e dashurisë drejt miqësisë dhe dashurisë, *ashkut* hyjnor. Kjo dashuri nuk është një anim nënçmues drejt femrës, por dhënia e vlerës madhështore të cilën,

---

<sup>35</sup> Nuk ekziston asnjë tendencë e pshore dhe egoiste në asnjërin nga martesat e të Dërguarit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Ai nuk ka kërkuar asnjë vajzë derisa Ai ishte i ri, por pranoi ofertën për martesë të vejushes katërdhjetëvjeçare Hazreti Hatixhes, e cila në atë kohë, ishte edhe nënë e fëmijëve jetim, dhe kaloi periudhën më të gjatë të jetës me të. Martesat tjera do t'i realizojë pas moshës 54 vjeçare, kur Ai ishte i shtyrë në moshë. Dhe të gjithë këto do t'i realizojë jo me vullnet personal por me urdhër hyjnor, në të cilat, krahas shumë urtësive hyjnore, në veçanti do të ketë për qëllim që t'ua mësojë femrave fenë e Zotit. Të gjithë të martuarat e Profetit, të cilat llogariten edhe si nënat e gjithë besimtarëve, ishin të moshuara, me fëmijë dhe të mjera. Thënë ndryshe, vetë fakti se Profeti u martua me më shumë gra në moshë të shtyrë dhe në një kohë kur detyra e Tij profetike ishte më në kulm, vërteton realitetin se këto martesat janë realizur me caktim hyjnor dhe me qëllim të kumtimit të fesë sa më lehtë masës së gjërë të shoqërisë. Për njohuri më të gjëra shih: Osman Nuri TOPBASH, *Hazret-i Muhammed Mustafa*, I, 130-140.

për ndryshe edhe e meriton ajo. Gjatë historisë njerëzore, femra një vlerë të këtillë hyjnore ka fituar vetëm në ambientin e lartë të Islamit. Të gjithë sistemet, jashtë Islamit, të cilat pretendojnë se e çmojnë femrën, në të vërtetë e vlerësojnë atë vetëm si mjet vitrinash, kurse në prapaskenë e përdorin, diskriminojnë dhe e harxhojnë si pasuri ekonomike dhe epshore.

Nisur nga ky fakt themi se sot njerëzimi pozitën e femrës në shoqëri duhet rishikuar e rivlerësuar nga këndvështrimi Islam i begatshëm dhe madhështor, që në këtë mënyrë femra të fitojë pozitën e meritur në shoqëri. Femra dhe mashkulli që nga krijimi i tyre janë si dy botëra të cilat plotësojnë njëra-tjetrën. Por në këtë plotësim të ndërsjelltë femrës nga Zoti i Vërtetë i është dhënë një rol më influent. Ashtu që femra është ajo që prish dhe ndërton shoqëritë. Shikuar nga këndvështrimi islam, ideal më i lartë konsiderohet edukimi i femrës e cila ndërton shoqërinë, në këtë kontekst ekziston edhe hadithi i të Dërguarit të All-llahut i cili thotë:

*“Kush prej jush ka tri vajza, ose tri motra nën kujdesjen e tij dhe i rrit, i edukon mirë, i marton dhe vazhdon me sjellje të butë dhe të mirë ndaj tyre ka fituar Xhennetin.”* (Ebu Davud, Edeb, 120-121/5147; Tirmidhi, Birr, 13/1912; Ahmed, III, 97)

Në një hadith tjetër Hazreti Pejgamberi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) thotë:

*“Kush nga ju rrit dhe edukon dy vajza deri në moshën madhore, unë dhe ai Ditën e Kijametit do të jemi kaq afër”,* në këtë rast, Profeti bashkoi dy gishtat e Tij të ndershëm. (Muslim, Birr 149; Tirmidhi, Birr, 13/1914)

Më pas Profeti do të theksojë vlerën e gruas së edukuar mirë, e do të thotë:

*“Kjo botë është një dobi kalimtare. Qenia më e dobishme që i sjell dobi botës është femra fetare dhe e mirë.”* (Muslim, Rada 64; Nesai, Nikah 15; Ibni Maxhe, Nikah 5)

Zakonisht, pas njerëzve të mëdhenj me ndikim në histori ka qëndruar një grua e mirë. Për shembull, kur filloi shpallja, Hazreti Pejgamberi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) mbështetjen e parë dhe më të madhe e ka gjetur te shoqja e Tij Hazreti Hatixheja. Profeti gjatë tërë jetës nuk e ka harruar këtë përkrahje. Poshtu, edhe në sukseset dhe rezultatet që arriti Hazreti Aliu, është në pah roli dhe mbështetja e shoqes së tij, Hazreti Fatimes.

Thënë ndryshe, gruaja e mirë është begatia më e madhe dhe më e dobishme në këtë botë. Për këtë shkak Hazreti Pejgamberi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) në një hadith, si kusht të të qenit i mirë përmend sjelljen e mirë ndaj femrave:

*“Shikuar nga aspekti i besimit, besimtar më i përsosur është ai i cili posedon moral më të mirë. Kurse më i miri ndër ju është ai që është më i mirë në sjellje me gruan e tij.”* (Tirmidhi, Rada, 11/1162)

Është një mjerim i pashoqë, që femra të shikohet si një mjet dëfrimi, që ajo të konsiderohet vetëm si pasuri e pashore dhe egoiste, dhe të mirresh vetëm me tiparet trupore të saj. Është mosnjohje e femrës, është verbëri ndaj vlerave të larta që All-llahut i Lartë i ka dhuruar femrës. Shikuar nga aspekti i dinjitetit femëror sa i hidhur dhe përçmues është fakti që sot femra, në botën e konsumit, deshifrohet dhe keqpërdoret si mjet reklamues.

Femra duhet edukuar në atë mënyrë që të jetë arkitekt i vërtetë në shoqëri. Ajo duhet të jetë një prehër qiellor që rrit çlirues. Nuk ekziston krijesë tjetër e cila do të meritonte dashurinë dhe nderën e këtyre nënave të vërteta, të cilat na bartin neve një herë në barkun e tyre, më pas në krahorët e tyre, kurse deri në vdekje në zemrat e tyre. Nënata besnike të cilat veten e bëjnë shtrojë dhe fli për familjen meritojnë një dashuri madhore, nderë të thellë dhe falenderim e përkushtim jetësor.

Kurse sa i përket urtësisë dhe fshehtësisë së dashurisë, që All-llahu i dhuroi Profetit, për erërat, aromat e mira e të këndshme është delikatesa dhe thellësia që u është dhuruar shpirtërave. Erërat e mira e të këndshme janë shirok qetësie të ëmbëla të cilat i pëlqejnë edhe engjëjt, ngaqë të pastërtit duan aromë të mirë e të këndëshme. Edhe lëkura e ndershme e të Dërguarit tonë (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ishte e lyer gjithmonë me erëra të këndshme. Thua jse trëndafilat shfaqeshin nga djersa e tij që pikonte. Edhe kur përkdhelte kokën e ndonjë fëmije Ai mbret i trëndafilave, nga koka e fëmijës, për një kohë të gjatë, ndjehej era e këndëshme.

Sa i përket namazit, ai ishte drita e syve të Hazreti Pejgamberit. Ngaqë namazi është bisedë dhe takim me All-llahun. Është një ibadet, adhurim që kryhet sikur ta shohësh Atë. Përkëtë themi se namazi është dritë e syve.

### **Sjellja e të Dërguarit të All-llahut ndaj jetimëve**

I Dërguar i All-llahut (sallallahu aleyhi ve selem) dridhej para jetimëve, nga që ajetet kur'anore të cilët urdhërojnë

mbrojtjen dhe përgjegjësinë ndaj jetimëve janë të shumtë. Në njërin nga ajetet kur'anore, All-llahu i Lartë urdhëron dhe nxit ndjeshmërinë dhe delikatesën ndaj jetimëve dhe thotë:

**“Ki kujdes, mos u sill keq ndaj jetimit!”** (ed-Duha, 9)

Në hadithet e Profetit lexojmë këto këshilla dhe sugjerime:

*“Shtëpia më e mirë është shtëpia ku trajtohen mirë jetimët. Shtëpia më e keqe është shtëpia ku keqtrajtohen jetimët.”* (Ibni Maxhe, Edeb, 6)

*“Nëse ndonjëri nga ju e merr dhe e dërgon në shtëpi, që të ushqeje dhe gostisë ndonjë jetim i cili gjendet ndër muslimanët, nëse ai më parë nuk ka kryer ndonjë faj që nuk falet, pa fare dyshimi All-llahu do të gradojë atë me Xhennet.”* (Tirmidhi, Birr, 14/1917)

*“Nëse dikush përkdhel kokën e ndonjë jetimi vetëm për All-llahun, All-llahu do ta shpërblej me sevape, mirësi përçdo fije floke që ka prekur...”* (Ahmed, V, 250)

I Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) vazhdimisht këshillonte për kryerjen e detyrave shoqërore shumë të rëndësishme ndaj zemrave të thyera në shoqëri. Në këtë kontekst, përcillet një hadith, ku Profeti, duke treguar dy gishtat e Tij të ndershëm pran njëri tjetrit, thoshte:

*“Kush sillet mirë ndaj fëmijëve jetim, meshkuj ose femra, të cilët gjenden nën kujdestarinë e tij, do të jetë bashkë me mua në Xhennet.”* (Buhari, Edeb, 24)

Profeti do të këshillojë, një sahabi për mjekim për të cilin shokët ishin ankuar për zemërngurtësi, me këta fjalë:

*“Nëse dëshiron të zbusësh zemrën, ushqeji të varfërit e përkdhele kokën e jetimit!”* (Ahmed, II, 263, 387)

### **Sjellja e të Dërguarit të All-llahut ndaj kafshëve**

Çdo sjellje e të Dërguarit të All-llahut ishte mbi bazë të mëshirës dhe dashurisë. Ai kish trajtuar të gjitha krijesat me dhembshuri dhe butësi, qe përgjigjur për gjithë nevojat e nevojtarëve. Madje, edhe kafshët kanë marrë pjesën, hisen e tyre nga ky Oqean i Mëshirës. Në periudhën e injorancës paraislamike njerëzit i trajtonin kafshët në mënyrë të pakujdesshme dhe të pamëshirshme. Pa mëshirë e dhembje, e pritnin mishin e kafshëve për së gjalli dhe e hanin, organizonin gara me përleshje të kafshëve. Të gjitha këto zakone që njollosnin ndërgjegjjen e njeriut i mënjanoi i Dërguari mëshirë për gjithë krijesat nga All-llahu i Lartë, Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem).

Sahabiu Ebu Vakidi (radiall-llahu anhu) rrëfen:

“Kur i Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) erdhi në Medine, medinasit hanin mish të prerë nga gungat e deveve dhe nga kofshët e dhenve.

I Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ndaloi këtë ves e tha:

*«Çfar do që pritët nga kafsha gjersa ajo është e gjallë, llogaritet si e ngordhur, nuk hahet.»* (Tirmidhi, Sajd, 12/1480)

Një ditë Profeti (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) pa në rrugë një gomar me fytyrë të përgjakur, u dëshprua dhe tha:



*“Mallkimi i All-llâhut qoftë mbi atë që ka përgjakur kështu këtë kafshë!”* (Buhari, Dhebaih, 25)

Ata të cilët kishin shqetëqsuar shpezën, zogjët e të cilës ia kishin marrë nga foleja i urdhëroi dhe u tha:

*“Kush e mundon këtë shpezë duke ia marrë zogjtë? Shpejt vëndoni zogjtë në folenë e vet!”* (Eb Davud, Edeb, 163-164/5268)

Një herë kur Profeti pa një deve të cilës lëkura i ishte ngjitur për kockash, urdhëroi e tha:

*“Frigohuni prej All-llahut për hakun e kësaj kafshe e cila nuk flet! Shaloni të ngirë, thereni të ngirë!”* (Ebu Davud, Xhihad, 44/2548)

Një ditë i Dërguari pa një njeri që therte një dele. Por ai, pasi kishte shtrirë për dhë delen, mundohej të mprehte thikën. Profeti i prekur thellë nga kjo sellje arrogante dhe e pamëshirshme, ia tërhoqi vërejtjen atij personi e i tha:

*“A dëshiron të mbysësh kafshën disa herë!? A nuk do të ishte më mirë të mprehish thikën para se të shtrish për dhë kafshën?”* (Hakim, IV, 257, 260)

Në një transmetim tjetër Profeti i pyet shokët:

*“A doni që t’ju tregoj se kush është larg Xhehennemit, dhe xhehennemi larg tij?”* Më pas përgjigjet e thotë:

*“Ata janë personat të cilët janë të butë, të ndershëm, të mëshirshëm, të afërt dhe të dhembshur.”* (Ahmed, I, 415)

Pejgamberi ynë (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) në një hadith tregon gjendjen e atyre të cilët janë të mëshirshëm dhe të atyre të cilët nuk janë të mëshirshëm:

*“Një grua mëkatore takon në shkretëtirë një qen i cili lëpinë rrerën nga etja që e kishte kapluar. Nga mëshira që posedonte e nxori këpucën e saj dhe nxori ujë nga pusi e i dha qenit të pij. All-llahu i Lartë i fali mëkatet kësaj gruaje. Një grua tjetër, duke mos përfillur macen e kishte lënë të uritur. Madje, kishte penguar atë që të mos hajë edhe thneglat. Si rrjedhojë e kësaj sjelljeje, macja kishte ngordhur. Kjo grua për shkak të pamëshirshmërisë mori rrugën e Xhehnnemit!”<sup>36</sup>*

Profeti (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) me këto kritere do të shndërroj shoqërinë injorante paraislame në një shoqëri të epokës së lumturisë (*asru sadet*). Madje edhe personat që dikur keqtrajtonin edhe njerëzit, edhe ata të cilët dikur groposhin vajzat për së gjalli, do të shndërrohen në shembëlltyrë, mëshira e dhembshuria e të cilit përfshinte edhe kafshët.

Ngaqë i Dërguari i All-llahut (sall-llallahu alejhi ve sel-lem) i cili është shembull më i mirë, *usvei hasene*, që duhet ndjekur madje edhe të drejtën, hakun e një zogu të vogël e përfillte dhe i përgatitte ata me një kujdes të papërshtuar.

Edhe gjallesat e dëmshme për njeriun, si gjarpërin dhe akrepin, urdhëronte që të mbyten me një goditje që të mos mundohen tepër. Në këtë kontekst përciellet një hadith ku Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sellem) thotë:

*“Kush i mbyt zvaranikët me një goditje fiton njëqind sevape. Nëse e mbyt me goditjen e dytë fiton më pak sevape. Në goditjen e tretë fiton edhe më pak sevape.”* (Muslim, Selam 147; Ebu Davud, Edeb 162-163/5263; Tirmidhi, Sajd, 14/1482)

---

<sup>36</sup> Shih. Buhai Enbija 54; Muslim, Sela, 151, 154; Birr, 133; Nesai, Kusuf, 14.

A nuk është një shembull i pashoq, fakti që të këshillosh që edhe gjallesat e dëmshme t'i mbysësh me mëshirë?



Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) edhe pse posedonte virtyte dhe vlera eprore, ai asnjëherë nuk lëvdohej. Llogariste dhuntitë që All-llahu ia kishte falë, thoshte **“La fahre: nuk duhet lavdëruar”** dhe kaplohej nga modestia. (Tirmidhi, Menakib, 1; Ibni Maxhe, Zuhd, 37; Ahmed, I, 5, 281)

Burimi i kryelartësisë është vetlavdërimi dhe mburrja. Kjo është gjendje e cila lazdëron njeriun. I Dërguari i All-llahut edhe pse ishte njeriu më i ndershëm nga të gjith njerëzit, dhe personi të cilin edhe All-llahu e kishte lavdëruar, vazhdimisht këshillonte dhe sugjeronte shokët e tij duke u thënë:

*“Thirrmëni mua «rob dhe i Dërguari i Allahut»!”* . (Buhari, Enbija, 48; Ahmed, I, 23)

Në natyrën e njeriut ekziston cilësia e të qenit rob. Njeriu është ose rob i gjërave dhe i dobisë personale ose rob i Zotit të vet. Të qenit rob i All-llahut, e mbron njeriun nga robëria e egos dhe rob i dobive personale.

Në shoqëritë njerëzore, në momente të veçuara kohore, hasen heronj të shquar. Kurse Hazreti Pegamberi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) është shembull i vetëm në të cilin janë të tubuara të gjithë virtytet e shquara kulmore.

Ai është shembulli më i përkryer, *usvei hasene*, i të gjitha kohërave. Gjatë tërë jetës i dhuroi njerëzimit vlera, virtyte dhe bukuri të pashembullta shpirtërore dhe materiale në të qenit rob i All-llahut, në veprat dhe në moralin e tij të përkryer.

Ai ishte udhërefyës i lumturisë së përhershme, i cili e kishte të qartë përgjithësinë e të qenit shembëlltyrë për një popull.

Edhe në baraspeshën që ngriti Ai, mes anëve polarisht të kundërta të jetës, nuk ka asnjë mangësi, të metë ose pamjaftueshmëri sado të vogël. Është e pamundur të gjendet në histori një personalitet i tillë shembullorë.

Në shoqëritë njerëzore, në momente të veçuara kohore, hasen heronj të shquar. Kurse Hazreti Pegamberi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) është shembull i vetëm ku janë të tubuar të gjithë virtytet e shquara kulmore.

Ai është shembulli më i përkryer, *usvei hasene*, i të gjitha kohërave. Gjatë tërë jetës i dhuroi njerëzimit vlera, virtyte dhe bukuri të pashembullta shpirtërore dhe materiale në të qenit rob i All-llahut, me veprat dhe me moralin e tij të përkryer.

Ai ishte udhërefyës i lumturisë së përhershme i cili në mënyrë më të denjë e kishte kuptuar përgjegjësinë e të qenit personalitet shembullor para ummetit.

Në këtë kontekst, vëmendjen që Ai i kushtonte **namazit** ishte mbi të gjithat. Vetëm një pjesë të shkurtër të natës e kalonte në gjumë, trupi i Tij i bekuar shpesh herë nuk shijonte shtratin. Kur të gjithë, në natën ethellë ishin në gjumë të ëmbël, ai qëndonte në sexhde me sy të përplot. Madje edhe në momentet e fundit të jetës, ai mblidhte veten dhe shkonte në faltore për të falë namazin me xhemaat.

Ja si e përshkruan Abdullah bin Shihir (radijall-llahu anhu), gjendjen shpirtërore të Profetit në namaz.

“Një ditë vajta tek i Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi

ve sel-lem). Ai ishte duke falë namaz, nga të qarit, prej gjoksit të tij dëgjohej një zë sikur zëri i kazanit kur vëlon.”. (Ebu Davud, Salat, 156-157/904; Nesai, Sehv, 18)

Edhe pse për besimtarët jashtë muajit të bekuar të ramazanit nuk ekziston **agjërim** tjetër i obliguar, *farz*, të ralla ishin muajt dhe javët në të cilat i Dërguari i All-llahut nuk agjëronte asnjë ditë.

Hazreti Aisheja (radijall-llahu anha) rrëfen se:

*“I Dërguari i All-llahut herë-herë agjëronte vazhdimisht pa ndërprerë, derisa supozonim se ai nuk do prish agjërimin kurrë”.*

(Buhari, Saum, 53)

Krahas agjërimit të të hënave dhe të enjteve të cilin e kishte zakon, agjëronte, thuajse vazhdimisht, ditët e trembëdhjeta, katërbëdhjeta dhe të pesmbëdhjeta të çdo muaji, gjashtë ditë në muajin shevval dhe agjërimin e ashures të muajit muharrem.

Me ajetin kur’anor që flet mbi **zekatin**, urdhëroi muslimanët që të japin zekatin dhe të kontribuojn me pasurinë e tyre në të mirë. Por kontributin më të mirë me pasuri e bëri vetë Ai. Jetësonte në formën më të bukur urdhërin kur’anor, në të cilin Zoti i Vërtetë thotë:

**“...dhe japin në rrugë të All-llahut prej asaj, rizkut, që u kemi dhënë.”** (el-Bekare, 3), dhe lavdëronte e lutej për tregtarët e sinqertë dhe të devotshëm të cilët harxhojnë pasurinë në rrugë të hajrit.

## Kriteret në yje

Njëra ndër cilësitë e veçanta të personalitetit të lartë të të Dërguarit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) është mos fshehja e asgjës që ai posedonte nga kjo botë, dhe harxhimi i çdo gjëje që ishte pron e tij në rrugë të All-llahut. Shoku i Profetit Ebu Dherri rrëfen e thotë:

“Ishim duke shëtitur me të Dërguarin e All-llahut nëpër një luginë me gurë të Medines. Kur para nesh u shfaq kodra e Uhudit ai më tha: *“O Eba Dherr, edhe sikur të posedoja thesare sa kodra e Uhudit kjo nuk do të më gëzonte fare. Në përjashtim të pjesës të cilën do të kisha ndarë për të paguar ndonjë borxh, nuk do të lejoja që qoftë edhe një dinarë të qëndrojë më tepër se tre ditë në shtëpinë time.”* (Muslim, Zekat, 32; Buhari, Istikrad, 3)

Profeti herë-herë dy, herë-herë tri ditë pa ndërprerë agjëronte *saumi visal*, agjërim ky i veçantë vetëm për profetin. Dhe kur vërente se edhe dikush prej sahabëve donte të bëjë të njejtën ndalonte ata duke u thënë:

*“Ju nuk keni fuqi të përballoni këtë.”* (Buhari, Saum, 48)

Duhet theksuar faktin se aq sa është e nevojshme të dimë se i Dërguari i All-llahut është udhërrëfyes dhe shembëlltyrë e vetme për ne, po aq është e nevojshme të dimë kriteret tona në shembëllimin e tij. Nga që veprat dhe qëndrimet e tij ndahen në dy kategori:

1. vepra të cilat kanë të bëjnë vetëm me personalitetin e Tij dhe
2. vepra të cilat i dedikohen gjith njerëzimit.

Dhe për këtë shkak themi se ne nuk jemi të ngarkuar të ndjekim dhe të shembëllem virtytet e larta të cilat i dedikohen vetëm personalitetit të Tij. Ngaqë këto situata dhe sjellje janë sikur **kriteret e yjeve**, të cilat ne nuk kemi kapacitet t'i ndjekim dhe emitojm.

Kurse, sa u përket situatave, sjelljeve dhe fjalëve që bëjnë pjesë në kategorinë e dytë, ne jemi të ngarkuar dhe përgjegjës që të hapërojmë pas gjurmëve të tij të shndëritshme dhe të ndjekim e të emitojm ato gjatë jetës sonë, në bazë të mundësive dhe aftësive tona që posedojm.

Edhe pse askush nuk ka mundësi që të arrijë përsosshmërinë dhe maturimin njerëzor që posedonte Hazreti Muhammedi (sal-lallahu alejhi ve sel-lem), çdo kush që mundohet të ecë drejt gjurmëve të tij, sipas mundësive dhe aftësive që posedon, mund të shërbejë sikur një Muhammed në miniaturë për popullin e vet.

# KAPITULLI I TRETË

\*Vendosmëria shpirtërore në ndjekjen e të Dërguarit të All-llahut”

\*Ndjekja e të Dërguarit të All-llahut me dashuri

\*Asrus-sadet/periudha e lumturisë, pasqyra e moralit dhe dashurisë ndaj të Dërguarit

\*Këngë të përmallshme të dashurisë profetike

\*Salavati sherife/urata të ndershme



## Vendosmëria shpirtërore në ndjekjen e të Dërguarit të All-llahut

Për të arritur moralin e lartë të as'habëve të ndershëm, duke përfituar nga shembulli më i lartë i të Dërguarit të All-llahut, duhet që fillimisht të përfitojmë vendosmëri shpirtërore. Sa i përket shembullit më të lartë, *usvei hasene*, All-llahu i Lartë në Kur'an thotë:

“Për ata të cilët shpresojnë shpërblimin e All-llahut në botën tjetër, dhe ata që atë shpresë e shoqërojnë duke e përmendur shumë shpesh All-llahun kanë shembull më të lartë, *usvei hasene*, në të Dërguarin e All-llahut.” (el-Ahzab, 21)

Si që shihet, në këtë ajet kur'anor potencohet se shkalloret më të rëndësishme për të përfituar nga shembulli i lartë i të Dërguarit të All-llahut janë: “shpresa në shpërblimin e All-llahut dhe në botën tjetër (*ahiret*)” dhe “përmendja (*dhekri*) e All-llahut shpesh”. Ibadetet, adhurimet, kryhen në kohë të caktuara, kurse mbrojtja e besimit, *imanit* është kusht i përhershëm. Qëndrueshmëria kundër fortunave që rrezikojnë zemrën e njeriut mund të arrihet vetëm me *dhikër*, përmendje dhe përkujtim të vazhdueshëm të All-llahut të Lartë.

All-llahu i Madhëruar në ajete të ndryshme kur'anore urdhëron dhikrin dhe thotë:

“O besimtarë? Përkujtojeni All-llahun sa më shpesh.”<sup>37</sup> Meqë pas ajetit në fjalë nuk ekziston ndonjë përkufizim në numër e as në sasi, nënkuptohet se urdhëri për dhikër, përkujtim të All-

---

<sup>37</sup> el-Ahzab, 41; Në veçanti shih: el-Xhum'a, 10;

llahut është për çdo kohë e vend.<sup>38</sup> Për rrjedhojë, ajo që duhet bërë robi është që në çdo moment dhe çdo herë kur ka mundësi të përkujtojë All-llahun. Në një ajet tjetër kur'anor All-llahu thotë: “ ... All-llahu, e le të humbur atë që do, kurse atë që pendohet nga të këqijat e shpie në rrugë të drejtë. Ata që besuan dhe me të përmendur All-llahun, zemrat e tyre qetësohen, pra ta dini se me të përmendur All-llahun zemrat qetësohen.”(er-Rad, 27-28).

Të përkujtosh e të përmendësh, të bësh dhikër All-llahun nuk do të thotë që vetëm të përsëritësh emrin e All-llahut, por, përmendja dhe përkujtimi i All-llahut të rezultojnë me qetësi dhe kënaqësi të zemrës. Zemra e cila qetësohet me dhikër, shërohet nga sëmundjet, pastrohet dhe purifikohet nga ndryshkja dhe papastërtitë, mbushet me *nur*, dritë hyjnore, dhe duke zotëruar njomësi dhe ndjeshmëri fiton etje për fshehtësitë hyjnore.

Kur të rahurat e zemrës përgatiten sipas asaj që don Zoti, fitojmë pozitivë.

Në këtë kontekst i Dërguari i All-llahut ka thënë:

*“Ndër shenjat e dashurisë së All-llahut, është dashuria për përkujtim dhe përmendje, dhikër të All-llahut.”* (Sujuti, II, 52)

Të dashuruarit asnjëherë nuk harrojnë atë që dashurojnë, nuk largojnë atë nga gjuha dhe zemra e tyre. Zemrat të cilat duan të arrijnë kënaqësinë dhe qetësinë e jetës me besim, *iman*, pa ndërprerë përmendin dhe e përkujtojnë All-llahun. Ata kur qëndrojnë në këmbë, kur janë ulur dhe kur janë të shtrirë

---

<sup>38</sup> Nëse pas ndonjë urdhëri nuk ka ndonjë prapashetë e cila ka kuptim përkufizimi, nënkuptohet se ai urdhër duhet përfillur në masë sa më të lartë që është e mundur.

përkujtojnë All-llahun, dhe duke u zhytur në fshehtësitë, hollësitë dhe imtësitë e qiejve dhe tokës thonë:

**“Zoti ynë? Këtë nuk e krijoje kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të Xhehennemit.”**( Ali Imran, 191)

All-llahu nuk e don zemrën e cila nuk arrin të përfitojë këtë thellësi dhe hollësi.

All-llahu në ajetin 22 të sures ez-Zummer thotë:

**“Të mjerë janë ata që nga zemërngurtësia e tyre nuk përmendin All-llahun.”**

Njeriu i larguar nga përmendja, *dhikri* i All-llahut për të cilin flet ajeti kur’anor, është njeriu i larguar nga dinjiteti njerëzor.

Domethënë për të ndjekur dhe për të përfituar nga vlerat e të Dërguarit të All-llahut duhet mbushur zemrën me dashuri hyjnore, duhet zhveshur nga dashuritë e fundme dhe duhet stolitur me përmendje e përkujtim të All-llahut (*dhikrull-llah*) dhe shpresë e qëllim për takim me All-llahun dhe botën e ardhshme.

### **Ndjekja e të Dërguarit të All-llahut me dashuri**

Rezultat i dashurisë së vërtetë për të Dërguarin e All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) duhet të jetë që pluhurin e rrugës së tij ta shndërrosh për kurorë, të nderosh dhe respektosh atë me gjithë zemër dhe t’i nënshtrohesh Atij. Ngaqë, Ai është personalitet, çdo aspekt i të cilit është si një oqean mëshire për

tërë njerëzimin. Sa bukur ky ajet kur'anor përshkruan mëshirën dhe dhembshurinë e Tij për besimtarët:

**“Juve ju erdhi i dërguari nga lloji i juaj, atij i vije rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i dhembshur dhe i ndershëm për besimtarët.”** (et-Teube, 128)

Njëri ndër hadithet të cilët tregojnë dhembshurinë dhe mëshirën e Tij është edhe ky:

*“O besimtarë! All-llahu ju mbrojtë! Ju mbroftë nga të këqiat! Ju ndihmoftë! Ju udhëzoftë! Ju mbrojtë nga çdo fatkeqësi, dhe ruajt për ju fenë tuaj.”*<sup>39</sup>

Ai me veprat, fjalët dhe sjelljet e tij ishte një mëshirë që përfshinë tërë njerëzimin, ishte udhërrëfyes në rrugën e udhëzimit, brengat dhe mundimet më të mëdha ishin mbi supet e Tij. Ai herë-herë (me qëllim që ummeti, ndjekësit dhe pasardhësit e tij të përfitojnë udhëzimin dhe mëshirën) gjendej në vendosshmëri dhe përpjekje të tillë, derisa All-llahu ia tërhiqte vërejtjen që të mos shkatërroj veten, duke i thënë:

**“A thua ti do ta shkatërosh veten nga hidhërimi pas tyre, nëse ata nuk i besojnë këtij libri (Kur'anit)”** (el- Kehf, 6)

**“(O Muhammed) A mos do të mbysësh veten pse ata nuk bëhen besimtarë?!”** (esh-Shuara, 3)

Ajetet kur'anore janë dëshmi të qarta se i Dërguari i All-llahut synonte që të gjithë njerëzit të besojnë në All-llahun, të shpëtojnë nga dënimi i Xhehennemit dhe të arrijnë mëshirën dhe dhembshurinë.

---

<sup>39</sup> Taberani, *Evsat*, IV, 208; Ebu Nuajm, *Hiljetu'l-evlija*, Bejrut 1967, IV, 168.

Ne si pjestarë të ummetit të Profetit jemi të obliguar që të mendojmë se sa i përgjigjemi dashurisë, dhembshurisë, mëshirës që ndjente i Dërguari i All-llahut ndaj ummetit.

Kriter i dashurisë sonë ndaj të Dërguarit të All-llahut është, duke marrë për udhërefyës Kur'anin dhe të Dërguarin e All-llahut, sa e ndjejmë prezencën e tij në shpirtin tonë. Si e ndjenin dhe përjetonin atë as'habët, shokët e ndersdhëm të cilët e donin atë dhe flijonin çdo gjë për Atë? Si u mishëruan me gjendjen e Tij, dhe si reflektuan moralin e Tij në jetë. Duhet matur dashurinë tonë ndaj Tij në bazë të këtyre kriterëve dhe duhet stolisur zemrat tona me moralin e Tij?

Mëkatet, fajet, gabimet dhe pakujdesitë tona duhet pastruar me moralin e Tij të pastër si uji i zemzemit, duhet përfituar dhe praktikuar një gjallëri shpirtërore me kuptimin dhe fshehtësinë e biografisë së Tij të bekuar.

Fshetësia e të qenit i *vaasil ilall-llah* qëndron në afrimin me zemër të pastër librit të All-llahut dhe Sunnetit, traditës së Dritës së ekzistencës, gjegjësisht moralit dhe sjelljeve të larta të Tij, pëlqyerjen e gjërave të cilat i donte i Dërguari dhe urejtjen e atyre që urente i Dërguari i All-llahut.

Dashuria hyjnore e bën zemrën vitale, e shëron dhe orienton kah e mira, hajri. Dashuria dhe urrejtja, këto dy dukuri të kundërta nuk mund të ekzistojnë së bashku në një zemër. Por, qëedoqë, zemra e cila nuk pranon shprazëtinë, në rast të mos ekzistencës së njëres i mundëson ekzistencën e tjetrës.

Rruga mes këtyre dy cilësive diametralisht të kundërta, është e pafund. Ja si i udhëzon dhe si ua tërheq vërejtjen poeti i

mirënjoher turk Kemal Edip Kyrkçyogllu, besimtarëve neglizhentë të cilët qëndrojnë larg Sunnetit dhe dashurisë së të Dërguarit të All-llahut:

*Mjerë, mjerë për të pakujdesishmit*

*Mjafton mjerimi i të dy botëve për neglizhentët!...*

O Zot, na bën neve ummet i denjë i cili do të jetë i lidhur me Atë më dashuri! Ngaqë, Ai është një horizont mëshire e dhembshurie i pashoq!...

A nuk mjafton si dëshmi se Ai gjendej në maje të paarritshme të dhembshurisë, mëshirës, zemërgjërësisë, besnikërisë dhe flijueshmërisë kulmore, lutja për udhëzim për banorët e qytetit të Taifit, të cilët e gurëzuan dhe e fyen Atë. Realitet ky, që mund ta gjejmë edhe në përgjigjen dhënë Zejd bin Thabitit, i cili në këto momente të vështira e pyeti Profetin, duke i thënë:

“O i Dërguar i All-llahut, ata të dënojnë Ty me një dënim të ashpër, e Ti edhe më tej lutesh për ata?”

Kurse Profeti i urtë i qetë iu përgjigj:

*“Unë jam i dërguar për mëshirë, e jo për dënim.”*

Me të vërtetë, njerëzimi në saje të profetësisë së të Dërguarit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ka patur udhërrëfyesin më të përsosur që priste. Për këtë shkak, ata të cilët sot jetojnë një jetë e pshore dhe egoiste janë në pozitë më me përgjegjësi se ata të cilët jetonin një jetë injorante në periudhën para ardhjes së këtij shembulli të lartë.

Shikuar nga ky këndvështrim, themi se, sot njerëzimi në një kohë kur posedon fuqi madhore dhe i është nënshtruar sundimit të egos, kanë shumë nevojë për personalitetin shembullor të Dritës së Egzistencës për të ndërtuar karakterin dhe personalitetin e tyre....

Kurse sot, kur vëshrojmë gjendjen tonë vërejmë se njëra ndër realitetet më mjeruese është kriza në sferën shpirtërore, e cila është pasojë e numrit tejet të vogël të personaliteteve të tilla shembullore.

Që edhe sot të arrijmë pozitën e Pejgamberit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), të atyre që ndoqën gjurmët e tij, e në veçanti të heronjve besimtarë të historisë sonë të cilët ishin me zemra të mbushura plot entuziazëm, kemi nevojë për njerëz shembullor të këtillë. Kemi nevojë të dëgjojmë rrëfime për ata, t'i kuptojmë ata, dhe të marrim hise nga bota e zemrave të tyre. Gjegjësisht, kemi nevojë që t'i njohim qëndrimet e tyre ndaj botës kalimtare, t'i mësojmë mënyrat se si ata arritën që njerëzimit t'i trasojnë rrugën e lumturisë duke përdorur mendjen, vullnetin, vetveten dhe pasurinë që ua kishte dhuruar All-llahu.

### **Periudha e Lumturisë pasqyrë e moralit dhe dashurisë së Tij**

Edukata e jashtme dhe ndikimi i mbrendshëm i të Dërguarit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ishin një fuqi e tillë që një popull gjysmë të egër, shumica të painformuar mbi njerëzimin, për një periudhë relativisht të shkurtë, i ngriti në një pozitë të paimagjinueshme, me dinjitet të “*sahabëve-shokëve*”, të

cilëve ua kanë lakmi historia njerëzore. I bashkoi ata nën një fe, një flamur, një ligj, një kulturë, një qytetërim dhe një qeverisje.

Shndërroi njerëzit injorantë dhe tiranë në njerëz të kulturuar, të egërit në të qytetëruar, personat me karakter të prishur dhe të shëmtuar në persona të devotshëm, në persona të denj të cilët jetojnë me dashuri dhe frigë prej Zotit. Shoqëria injorante paraislame, e cila nuk kishte kultivuar asnjë njeri me vlera gjatë tërë historisë, në saje të udhëzimit dhe vlerave shpirtërore të cilat i posedonte Profeti (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) do të nxjerrë në pah shumë persona të stolitur me virtyte dhe tipare të larta. Dhe, që të gjithë këta, sikur fanarë të besimit, të diturisë dhe urtësisë do të bartin frymëzimin që posedonin në të katër anët e botës. Drita e cila zbriti në shkretëtirë mori nën hijen e vetë pafundësinë dhe i dhuroi gjithë njerëzimit drejtësinë, të vërtetën dhe vlerat e mirëfillta.

U shfaq dhe u bë realitet fshehtësia e cila gjendet në shprehjen “*Laulake laulake*- sikur të mos ishe ti, sikur të mos ishe ti”<sup>40</sup>. U realizua qëllimi i ekzistencës.

Njerëzit e periudhës së lumturisë, *asru seadet*, të edukuar nën kujdesjen e të Dërguarit të All-llahut, të cilët janë shembuj më të përsosur të botës njerëzore, ishin një shoqëri diturie dhe urtësie.

Ajo periudhë ishte një periudhë e një mendimi të thellë, periudhë e njohjes nga sa më afër e All-llahut dhe të Dërguarit të Tij. As’habët, shokët e ndershëm të Profetit vendosën në qendër të idealit dhe mendimit të tyre *tevhidin*, njëshmërinë e All-llahut,

---

<sup>40</sup> “*Sikur të mos ishe ti nuk do të krijoha gjithësinë.*” Për hadithin i cili përkthyer këtu shih: Hakim, II, 672/4228



larguan dhe hodhën nga zemra dobitë e kësaj bote. Pasuria dhe trupi për ata u bënë mjete. U shijua kënaqësia e besimit. U përhap mëshira. Shërbimi njerëzimit u bë konditë jete. U prezentua një flijueshmëri e madhe dhe personalitet islam. Sahabët për të dëgjuar dhe mësuar, madje, edhe një hadith udhëtonin një muaj rrugë. Nuk mësonin hadithet e *raviut*, përcjellësit, i cili mashtroi kalin.

Çfarë përfituan as'habët nga i Dërguari i All-llahut:

1. Tjetërsimin, (tjetërsimin në gjendjen e të Dërguarit dhe reflktimin e saj),

2. fituan afërsi (afirim me All-llahun, njohje të Zotit me zemër).

Dhe në saje të virtyteve në fjalë, në jetën e tyre do të bëhen të qarta e mira dhe realiteti, me të gjitha bukuritë, dhe e keqja dhe e shëmtuara me të gjitha mangësitë e tyre.

Sahabët do të rikuptimësojna konceptin Zot, gjithësi dhe shpirt. Ashtu si që reflektohet dielli në pasqyrë, edhe qëllimi final i tyre ishte që të përvetësojnë dhe reflektojnë qenien e të Dërguarit të All-llahut.

Kufijët e qytetit-shtetit të vogël islam të themeluar prej, diku rreth katërqind familjeve në Medine, brenda dhjetë viteve do të arrijnë deri në Irak dhe Palestinë. Në kohën kur Hazreti Pejgamberi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) përjetonte momentet e fundit të jetës, muslimanët ishin në luftë me Bizantin dhe Persët. Por situatat, qëndrimet, mënyra e të jetuarit, pozita e zhvillimit dhe arkitektura e vendbanimeve të tyre nuk kishte ndryshuar nga ajo e para dhjetë viteve. Ata edhe më tej vazhdonin të jetonin

në askezë. Konsumimin e tepërt, pangopësinë, luksin dhe çallëmin nuk e njihnin as'habët e Profetit. Ata gjithmonë ishin nën ndikim të qëndrimit: “nesër konaku yt do të jetë varri.” Për këtë shkak, ata gjithmonë distancoheshin nga të bërit e begative botërore pronë joshjeje për vete dhe nga harxhimet e tepërta. Me gjithë kënaqësinë dhe entuziazmin e besimit, imanit, këto dhunti përdorën si mjete për udhëzim dhe lumturi të njerëzimit. Jetën e tyre e formësuan në drejtim të fitimit të miratimit dhe kënaqësisë së All-llahut. Njëri ndër pretekstet për përhapjen e Islamit ndër popujt e shtypur, të diskriminuar, të marginalizuar dhe të kolonizuar në mënyrë të shpejt si agimi i mëngjesit, është edhe fakti që as'habët kudo që arrinin, me modestinë e tyre, manifestonin një identitet islam të përsosur.

As'habët, nxënësit personal të të Dërguarit të All-llahut, ishin besimtarë të veçantë të cilët trajtonin robërit e All-llahut, njerëzit, me dhembshurinë dhe mëshirën e të Vërtetit, *Hakkut*, të mbushur me altruizëm, sinqeritet, drejtësi, pasuri shpirtërore dhe dritë, *nur*, profetike. Ata kishin të vendosur në qendër të miqësisë Zotin dhe Profetin e Tij. Dhe në këtë mënyrë një shoqëri e cila nuk dinte shkrim e lexim ishte ngjitur në maje të qytetërimit. Që të gjithë mendjet dhe zemrat gjendeshin në emocione të larta kur thonin: “Çfarë don All-llahu prej nesh, si preferon i Dërguari i All-llahut të na shohë neve”.

Me këta njerëz u formësuan shekujt dhe kohërat. Iu dhurua njerëzimit një periudhë e lumturisë/ *asru seadet*.

Ata u çliruan nga pozita në të cilën egoja, *nefsi* e shtyn njeriun kah e keqja dhe e shëmtuara, në besimtarë autokritikë. Njerëzit e egër dhe beduinë u bënë si engjëj.

Në këtë kontekst njëri ndër personalitetet më me rëndësi të metodologjisë të së drejtës islame Karrafi (v. 684) thotë: “I Dërguari i All-llahut, edhe sikur të mos kishte asnjë mrekulli tjetër, do të mjaftonte brezi i as’habëve të ndershëm, të cilin ai vetë i edukoi, për dëshmi të profetësisë së tij.”

Ata ishin shembuj të gjallë të mrekullisë kur’anore. Ata ishin maja e njerëzimit, të cilët kishin arritur kulminacionin në përfaqësimin e të kuptuarit, shkathtësisë dhe vlerave tjera njerëzore.

Në atë periudhë funksioni i mendjes dhe zemrës të cilat e ngritën në pedestal besimtarin, u përdorën me një harmoni të lartë dhe të koordinuar. Duke u ruajtur vitaliteti i emocioneve dhe dashurisë tek besimtari u thellua të menduarit. Njerëzit jetonin të vetëdijshëm se kjo botë është një vend sprove. Zemrat përvetësuan rrjedhat e madhërisë dhe fuqisë hyjnore. Udhëtuan për të urdhëruar në të mirë dhe për të ndalur nga e keqja deri në Kinë, Semarkand, e më vonë, deri në Andaluzi/Spanjë. Ajo shoqëri injorante e periudhës paraislame u shndërrua në “njerëz që dinë të vërtetën”. Mbrëmjet u shndërrun në ditë. Dimrat u bënë behare. U zhvillua të menduarit, filluan mendimet rreth njeriut të krijuar nga një pikë uji, rreth shpezës së shfaqur në natyrë nga veza, rreth drunjve të shfaqur në natyrë nga një farë e imët, etj...

Jeta u përqëndrua në kënaqësinë e All-llahut. Çaste më të këndëshme dhe më të kuptimta për sahabët ishin momentet kur ata u përciellnin njerëzve mesazhin e njëshmërisë së All-llahut, *teuhidin*. Njëri ndër sahabët fatzi, të cilit tiranët i njohën vetëm tre minuta kohë para varjes, do të shprehet: ”Domethën kam edhe tre minuta kohë për kumtim të teuhidit.”

Thënë ndryshe, as'habët e Profetit (sal-lall-llahu alejhi ve sellem) jetuan me Kur'anin, për Kur'anin dhe ia dhuruan jetën Kur'anit. Ata ekspozuan një aktivitet dhe shërbim të paparë gjatë historisë. Përjetuan malltretime, diskriminime, dhunë, por asnjëherë nuk u larguan nga vlerat që besonin. Me qëllim të përhajes së fjalës së All-llahut ata u shpërndanë nëpër botë duke lënë pas vetes pasuritë, vendlindjet, familjet, rehatinë dhe flijuan çdogjë për këtë ideal të lartë. Vazhdimisht mundoheshin që të mësojnë diçka nga Kur'ani dhe të jetësojnë atë që e kishin mësuar prej Kur'anit. Nuk u ndan nga Kur'ani, madje, edhe në momentet më të vështira.

Sahabiu Abdall (radiall-llahu anhu) të cilin i Dërguari i All-llahut e kishte caktuar rrojtat gjatë një udhëtimi, do të lajmërojë për sulm të armikut bashkërojtarin Ammar (radiall-llahu anhu) vetëm pasi kishte marrë disa shigjeta në trup. E kur Ammari e pyeti: "E pse nuk më lajmërove fillë pasi të goditi shigjeta e parë", ai iu përgjigj: "Lexoja një sure nga Kur'ani dhe nuk pëlqeja që të ndërpris namazin para se të përfundoja atë. Por kur më goditën shigjetat njëra pas tjetrës, ndërpreva leximin, bëra ruku dhe kështu përfundova namazin. Pasha All-llahun, sikur të mos kisha frigë se do të humbasim këtë pozitë të cilën na urdhëroi Profeti ta ruajmë, do të kisha preferuar vdekjen para se të ndërpris leximin e sures kur'anore."

As'habët e ndershëm jetuan një jetë të përqëndruar rreth boshtit kur'anor. Çdo element përbërës i fesë për ata ishte një kënaqësi e pafund. Çdo ajet kur'anor që zbriste, për ata ishte siku tryezë e zbritur nga qielli. Qëllimi final i tyre ishte të mësojnë dhe praktikojnë Kur'anin dhe Sunnetin, respektivisht që të jenë

shembull i bukur. Një tabelë madhështore e cila tregon entuziazmin e besimit të sahabëve është rasti i një sahabeje e cila gjatë kurorëzimit e pranoi për *mehir*<sup>41</sup> të mjaftueshëm që i shoqi t'i mësojë pjesët kur'anore që ai i zotëronte.<sup>42</sup>

Ata ishin as'habët, shokët të cilët e preferonin namazin e natës, leximin e Kur'anit dhe dhikrin gjatë natës karshi shtretërve të ngrohtë, derisa personat të cilët kalonin afër shtëpive të sahabëve gjatë natës dëgjonin zërin e sahabëve të cilët lexonin Kur'an, përmendshin dhe kujtonin, bënë dhikër All-llahun. Pejgamberi i All-llahut atyre ua mësonte Kur'anin madje edhe në rrethana shumë të vështira.

Sahabiu Enes (radial-llahu anhu) rrëfen se Talha (radial-llahu anhu) njëherë kishte vajtur tek i Dërguari i All-llahut dhe e kishte takuar të Dërguarin në këmbë duke ua mësuar Kur'anin *as'habi sufes*. Kurse Profeti kishte të lidhur një gurrë për stomaku me qëllim që të drejtojë trupin e raskapitur nga uria. ( Ebu Davud, Hilje, I, 342).

Detyrë parësore e tyre ishte mësimi dhe kuptimi i librit të All-llahut, kurse dëshira më e madhe ishte leximi dhe dëgjimi i Kur'anit. As'habët shembëllenin të Dërguarin e All-llahut, dhe si rrjedhojë, qyteti i Medines së Shndërritshme u mbush me hafizë dhe dijetarë.

Ja e këtillë ishte periudha e lumturisë, *asru saadet*.

---

<sup>41</sup> *mehër*- Pasuria të cilën femra kërkon nga kandidati me të cilin do të martohet.

<sup>42</sup> Shih. Buhari, Nikah, 6, 32, 35; Fedailu'l-Kur'an, 21, 22; Muslim, Nikah, 76.

A thua sikur të tuboheshin të gjithë sociologët, psikologët, pedagogët, social-antropologët, arkitektët e shoqërisë, filozofët dhe ekspertë të proviniencave tjera, të të gjithë botës, do të mund të krijonin një shoqëri të vogël e cila do t'i ngjante shoqërisë së periudhës së lumturisë, e cila ishte e stolitur me gjithë virtytet më të larta që ekzistojnë. Edhe projekti i shoqërisë ideale, “*Medinetu’l-fadila*”, i imagjinuar nga Farabiu ngeli si ushqim molëzash...

### **Këngë të përmallshme për dashurinë profetike**

Kroni i vetëm i mëshirës dhe dashurisë i cili përcjell njeriun në oqeanin e dashurisë së All-llahut është Hazreti Pejgamberi, Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Me që dashuria për të dërguarin don të thotë edhe dashuri për All-llahun, mospërfillja e të Dërguarit të All-llahut don të thotë edhe mospërfillje të All-llahut.

All-llahu i Lartë në një ajet kur’anor urdhëron e thotë:

“(O i dërguar) Thuaj: Nëse e doni All-llahun, atëherë ejani pas meje që All-llahu t’ju dojë e t’ju falë mëkatet...” (Ali Imran, 31).

Pas *kelimej tevhidit*, fjalës së njëshmërisë « لا اله الا الله », (“Lailahe il-lall-llah”), vjen fjala, « محمد رسول الله », (“Muhammedur-resul-ull-llah”). Çdo kelimej tevhidë dhe salavati sherif, uratë e ndershme, është fryt i dashurisë dhe afërsisë së të Vërtetit. Lumturia e kësaj dhe botës së mëtejme dhe gjithë çlirimet shpirtërore arrihen vetëm me fryte të dashurisë së Tij.

Gjithësia është manifestim i dashurisë hyjnore. Esenca themelore e këtij manifestimi është “drita muhammediane” kurse rruga e vetme për të arritur deri te Qenia Hyjnore kalon nëpër dashurinë për Profetin.

Përjetimet shpirtërore të adhurimeve, principialiteti në sjellje, vyeshmëria etike, delikatesa e zemrës, drita dhe ëmbëlsia në pamje, thellësia në vështrim, të gjitha bukuritë janë vlera të reflektuara në zemër nga dashuria për Dritën e Ekzistencës, Muhammedin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem).

Sa e qëlluar në këtë kontekst është thënia e poetit mistik Mevlana Xhelaled-din er-Rumi:

*“Eja oj zemër! Festë e vërtetë është njësimi me Muhammedin e Lartë. Ngaqë, drita e gjithësisë, vjen nga nuri i asaj ekzistence të bekuar.”*

Mu për këtë, pretekst i patejkalueshëm për të merituar dashurinë dhe miratimin e Zotit, është ndjekja e përvojës së të Dërguarit të All-llahut. Domethënë, asnjë besimtar nuk mund të arrijë gradën e njeriut ideal, *“insani kamil-njeriut të përsosur”*, të cilën e mëton feja islame, nëse në adhurimet dhe sjelljet e tij nuk hapëron sipas rrugës së Sunnetit të Hazreti Muhammedit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Nuk do të mund të përjetojë kënaqësinë dhe qetësinë e vërtetë të fesë. All-llahu i Lartë ka ekspozuar modelin e *“njeriut të përsosur-insani kamil”*, të cilin e synon islami në personalitetin e Hazreti Pejgamberit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). All-llahu e dërgoi atë mëshirë për të gjithë botërat dhe personalitet shembëlltyrë për të gjith besimtarët.

Atëherë, çfarë ndere me vlerë është kjo nderë të cilën All-llahu i Lartë e ka bërë kusht për ne robrërit për të arritur dashurinë Hyjnore?!

Pa mëdyshje, kjo gjendje e lartë fillon me dashurinë e përzemërt për të Dërguarin e All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) dhe me pjesëmarrjen nga bota e Tij shpirtërore. All-llahu i Madhëruar në Kur'anin Fisnik urdhëron që të ndiqet i Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) i cili është *"usvei hasene-shembull më i mirë"*, e thotë:

**"...çka t'ju jep peygamberi, atë merreni e çka t'ju ndalojë, përmbajuni dhe kini frigë All-llahun, se All-llahu është ndëshkues i ashpër."** (el-Hashër, 7)

**"O ju besimtarë, respektoni All-llahun dhe të Dërguarin e tij dhe mos i çoni kot veprat tuaja."** (Muhammed, 33)

**"Kushdo që i bindet All-llahut dhe të dërguarit, të tillët do të jenë së bashku me ata që All-llahu i shpërbleu: Me profetët, besnikët e dalluar, dëshmorët dhe të mirët. Sa shokë të mirë janë ata."** (en-Nisa, 69)

Kur'anin Fisnik, i cili është si një ferman dhe rregullore hyjnore e zbritur për ummetin nga All-llahu, është i ekspozuar në zemrën e të Dërguarit të All-llahut. Sigurisht që edhe fshehtësitë kur'anore shfaqen sipas nivelit të shndërrimit të zemrës në botën shpirtërore të Profetit të All-llahut. Nëse edhe ne, sikur as'habët e ndershëm kemi nderin të hyjmë në atë botë dhe kemi fatin që të shikojmë bukuritë hyjnore, urdhërat-ndalesat, dituritë e urtësitë, manifestimet e atjeshme, shkurt, nëse lexojmë fjalën hyjnore me manifestimet dhe komentet e klimave shpirtërore të Tij, atëherë



zemrat tona do të bëheshin sikur flutura rreth Tij, sikur të dashuroarit profetik të periudhës së lumturisë, *asru saadet* dhe për çdo fjalë urdhër dhe aludim të Tij do të arrinim dashurinë, entuziazmin dhe nënshtrimin ndaj shprehjes “të qofshim kurban ty o i Dërguar nëna, baba, pasuria dhe shpirti im”. Qenia e shndërritshme e Profetit është një vendstrehim dhe burim frymëzim i njerëzimit. Të urtët, *arifët*, e dijnë që pretekst i egzistencës së qenieve është dashuria ndaj dritës muhammediane, për këtë shkak e gjithë ekzistenca i është kushtuar dritës së qënies së Hazreti Muhamedit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), gjithë ekzistenca është krijuar për nder të Hazreti Muhammedit. Ngaqë ai është një ekzistencë e tillë që All-llahu i lartë i thotë “i dashuri im” (*Habibi*)<sup>43</sup>.

Sa mirë për ata besimtarë të cilët i kanë dhënë zemrën dhe e dashurojnë All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, dhe janë në gjendje që këtë dashuri ta mbajnë mbi gjithë dashuritë tjera. Mundësia për t’iu afruar realitetit muhammedian, është më shumë se me arsye, me dashuri dhe *ashk*/pasion. Qejt e *rebiul-evvelit*,<sup>44</sup> të cilët i nderoi Ai, janë hapur për besimtarët si mëshirë dhe falje. Sipas të dhënave që ofrojnë burimet tona, njëra ndër mëndeshat (nënat e qumshtit) me fat të të Dërguarit tonë është edhe Thuvejbeja. Thuvejbeja ishte skllave e Ebu Lehebit, armikut të përbetuar të Profetit, e kur Thuvejbeja do t’i japë myzhde Ebu Lehebit për lindjen e nipit, ai, vetëm e vetëm nga fanatizmi fisnor do ta lirojë Thuvejben. (Halebi 138)

---

<sup>43</sup> Shih: Tirmidhi, Menakib, 1/3616; Darimi, Mukaddime, 8; Hejthemi, IX, 29

<sup>44</sup> Pranvera e parë, muaji në të cilin lindi Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem).

Madje edhe ky gëzim, nga fanatizmi fisnor, do të mjaftojë për lehtësimin e dënimit të Ebu Lehebit, në Xhehennem, gjatë ditëve të hëna. Në këtë kontekst, ja çka na rrëfen Abazi (radiall-llahu anhu).

Një ditë, pas vdekjes e pashë në ëndërr vëllaun tim Ebu Lehebin, ishte në një gjendje shumë të rëndë, dhe unë e pyeta:

“Si u trajtove në varr?”,

Ebu Lehebi m’u përgjigj:

“Ngaqë u gëzova për lindjen e Muhammedit dhe lëshova të lirë Thuvejben, ditët e hëna dënimi paksa më lehtësohet. Atë ditë një çikë freskohem me ujë që më del mes gishtit të madh dhe atij tregues.”<sup>45</sup>

Kurse Ibni Xhezeri në këtë kontekst thotë: “Nëse denimi i Ebu Lehebit, armikut të përbetuar të Profetit, lehtësohet vetëm e vetëm pse u gëzua për lindjen e të Dërguarit të All-llahut, atëherë duhet menduar se çfarë do të jetë favori dhe fisnikëria të cilën Zoti i Lartë do të tregojë për ata besimtarë të cilët nderojnë natën e mevludit, natën e lindjes së Krenarisë së Gjithësië, dhe vetëm e vetëm nga dashuria për atë hapin zemrat dhe tryezën?...

Ajo që duhet bërë gjatë muajit të lindjes së Profetit është, që të organizohen kuvende, takime dhe biseda shpirtërore për të ripërtrirë frymëzimin, me qëllim të shfrytëzimit të begative të muajit të shenjtë, të organizohet gosti për të afërmit, të ndihmohen jetimët, të varfërit, të mjerët, të gëzohen ata me sadaka dhe të mësohet e të lexohet Kur’ani.”

---

<sup>45</sup> Ibni Kethir, *el-Bidaje*, Kajro 1993, II, 277; Ibni Sa’d, I, 108, 125

## Dashuria e as'habëve të ndershëm për të Dërguarin e All-llahut

As'habët, shokët e ndershëm të Profetit aq shumë e donin të Dërguarin e All-llahut sa që është e pamundur të përshkruhet kjo dashuri. Një dashuri e tillë mund të realizohet vetëm e vetëm me dashuri e frymëzim hyjnor, përndryshe është e paaritshme.

As'habët e ndershëm ishin të radhitur me sinqeritet rreth të Dërguarit të All-llahut, sikur ujvarë dashurie, dhe ishin shndërruar në ujë qiellor. Ashtu që kishte nga ata të cilët vetëm e vetëm “ngaqë Ai kështu kishte vepruar”, dhe për të shijuar ndjenjën e ndjekjes dhe emitimit, ecnin nëpër rrugët nëpër të cilat kishte ecur Ai, merrnin erë trëndafilat që kishte marrë Ai, ndalonin në vendet në të cilat ishte ndaluar Ai. Janë të panumërta manifestimet nga zemrat e djegura e të përvëlura me dashurinë dhe ashkun e të Dërguarit të All-llahut të as'habëve të ndershëm. Ja disa nga këta:

Ja si e përshkruan fytyrën e ndritshme të Dërguarit të All-llahut Hazreti Aisheja, e cila e donte atë pa masë:

وَلَوْ سَمِعَ أَهْلُ مِصْرَ أَوْصَافَ حَدِّهِ

لَمَا بَدَّلُوا فِي سَوْمِ يُوسُفَ مِنْ نَقْدٍ

لَوَائِمُ زُلَيْحَا لَوْ رَأَيْنَ جَبِينَهُ

لَأَتَرْنَ بِالْقَطْعِ الْقُلُوبَ عَلَى الْأَيْدِ

*“Sikur të dësgjonin populli i Egjiptit për bukurinë e të Dërguarit të All-llahut.*

*Nuk do të harxhonin madje asnjë metalik në tregtinë e Jusufit.*

*Gratë që fyen Zylejhanë, sikur të kishin parë ballin e Profetit.*

*Që shndërritte si nurë, në vend të duarve do të kishin prerë zemrat”.*

Pa mëdyshje Pejgamberi është, ashtu si që shprehim edhe në deshmi, *shehadet*, një njeri dhe rob i Zotit, shikuar nga aspekti njerëzor, por nga aspekti biografik ai është *mbreti i të dërguarve*. Sa bukur e përshkruan këtë aspekt poeti mistik Aziz Mahmud Hudaji, i cili kap këtë hollësi dhe botë të fshehtë:

*Kjo botë është pasqyrë egziston nga i Vërteti*

*Nga pasqyra e Muhammedit All-llahu shihet çdo herë...*

Profeti (salallahu alejhi veselem) është epiqendra e manifestimit të dashurisë hyjnore e lartësuar nga dashuritë fugurative të krijimit duke u përkryer. Pa dyshym besimtari, kur ai ndjen rrënoqethjet hyjnore dhe emocionet e thella, kur shpirti shprazet nga të gjitha pamjet dhe nuancat që i takojnë frymës, *nefsit* karshi të Dërguarit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sellem) është në rrugë të njësimit, të marrjes pjesë nga dashuria profetike.

Poeti Mevlana Xhelaludin er-Rumi shprehet e thotë:

*“ Dy botë janë krijuar për një zemër! Mendo kuptimin e shprehjes, ‘po të mos ishte ti nuk do të kisha krijuar këtë botë’ !...”*

Për këtë, themi se dashuria për të Dërguarin e All-llahut është një pasojë kulmor e cila e shenjtëron njerëzimin në të dy botët. Edhe as'habët e ndershëm me ndërmjetësim të kësaj dashurie, domethënë meqë ata janë ngjyrosur me dashurinë e Krenarisë së Gjithësisë, kanë arritur grada të paarritshme.

Një panoramë tjetër e cila prezenton dashurinë e pashoke të as'habëve të ndershëm është edhe kjo:

Gjatë Hixhretit, shpërnguljes, kur Hazreti Ebu Bekri dhe Profeti ynë ngjiteshin për në shpellën Theur, Ebu Bekri, hapëronte herë para e herë pas të Dërguarit të All-llahut. Kur i Dërguari i All-llahut e vuri re këtë gjest e pyeti, Ebu Bekrin:

*“O Eba Bekër, pse vepron kështu?”*

Ebu Bekri iu përgjigj: “O i Dërguari i All-llahut! Në momentet kur frigohem që politeistët mekas mund të na ndjekin, ndalem e eci pas teje, e kur shoh gjurmë të ndonjë prite shpejtoj e eci përpara teje”.

Në fund arritën në shpellën Theur. Ebu Bekri i tha të Dërguarit të All-llahut: “O i Dërguar i All-llahut, ju pritni për një moment këtu derisa unë të pastroj shpellën!,” dhe hyri brenda pastroi bukur dhe kontrolloi shpellën me dorë, dhe kur gjente ndonjë birrë e mbyllte atë me pjesë të grisura nga rrobat e tij, kështu mbylli të gjitha birrat me pjesët e grisura të teshave të tija, me përjashtim të një vrime, dhe pasi e mbylli atë me thembër i tha të Dërguarit:

*“E tash mund të vish brenda në shpellë.”*

Në mëngjes kur zbardhi drita, i Dërguari i All-llahut e pa Ebu Bekrin, me rroba tejet të grisura dhe e pyei për shkakun. Kur Ebu

Bekri i trgoi çfarë kishte bërë me teshat, i Dërguari u prek dhe u emocionua tej mase, çoi duart lartë dhe iu lut, bëri dua, All-llahut për Ebu Bekrin.<sup>46</sup>

Sa mësimdhënëse është dashuria e gruas së fisit Dinar, nënë e pesë dëshmorëve, shëhidëve e cila pati humbur babanë të birin dhe burrin në luftën e Uhudit.

Ditën e betejës së Uhudit qyteti i Medines ishte i tronditur me një lajm. Dhe kur në qytet u hap lajmi nga persona të cilët bërtitnin “Muhammedi vdiq!” filluan vajet, zëri i vajeve shpërtheu qiellin, të gjithë dolën në rrugë, dhe përpiqeshin të marrin ndonjë lajm nga ata që vinin që andej, gruaja ensarase Sumejra edhe pse paraprakisht u informua për vdekjen e dy djemve, burrit dhe babasë, pa mos u thyer pyeste për gjendjen e të Dërguarit të All-llahut, për çështjen e cila me të vërtetë e mundonte atë, e thoshte: “A mos i ka ndodhur diçka Atij”, as’habët iu përgjigjën: “Falë Zotit Ai është mirë. Ai është gjallë ashtu siç dëshiron ti.”

Sumejra vazhdoi duke thënë:

“Pasha Zotin, nuk mund të bindem e të qetësohem derisa të shoh Atë me sytë e mi.”

Kur e pa Profetin, vrapoi dhe e kapi për cepin e teshave dhe i tha:

“Nënë e baba të qofshin fli, o i Dërguari i All-llahut! **Meqë, Ti je gjallë unë nuk mërzitem për asgjë tjetër!**” (Vakidi, I, 292; Hejthemi, IV, 115)

---

<sup>46</sup> Shih: Ibni Kethir, *el-Bidaje*, III, 222-223; Ali el-Kari, *Mirkat*, Bejrut 1992, X, 381-382/6034; Ebu Nuajm, *Hilje*, I, 33.

Enes Bin Maliku rrëfen:

“Njëherë një person erdhi tek i Dërguari i All-llahut dhe i tha:

“O i Dërguari i All-llahut, kur do të krisë Kiameti?”

I Dërguari e pyeti atë:

“*Çfarë ke përgatitur ti për ahiret, botën e përtejme?*”

Ai iu përgjegj e i tha:

“Dashurinë për të Dërguarin e All-llahut!”

Atëherë i Dërguari i All-llahut i tha:

“*Atëherë ti në atë botë do të jesh së bashku me atë që e do.*”

Enes Bin Maliku në vazhdim të transmetimit në fjalë thotë:

“ Neve nuk na ka gëzuar asnjë lajm tjetër, përveç lajmit për hyrje në islam (pranim të islamit), aq shumë sa lajmi: “**me të vërtetë, ti do të jesh në atë botë së bashku me atë që e do.**”

Ja edhe unë e dua All-llahun, të Dërguarin e Tij, Ebu Bekrin dhe Omerin dhe, edhe pse nuk mund t’i bëj veprat që bënë ata, shpresoj të jemë së bashku me ata në Ahiret. (Muslim, Birr, 163)

Pa mëdyshje, që çdo besimtar të hyjë në kuadër të këtij përgëzimi të të Dërguarit të All-llahut (salahl-llahu alejhi ve sellem) duhet të stolisë zemrën e tij me ashkun, dashurinë, dritën dhe nurin e Profetit.

Kur ndërroi jetë i Dërguari i All-llahut (salall-llahu alejdi ve sellem) gjendja e as’habëve ishte sikur qiriu i cili shkrihet, atë ditë zemrat nga ndarja me të Dërguarin e All-llahut për një çast u poqën nga zjarri i pikëllimit. As’habët të pikëlluar përjetonin

situata të ndryshme. Madje, Hazreti Omeri, me një çast kishte kaluar veten. Hazreti Ebu Bekri mundohej që të qetësojë as'habët dhe të mbajë nën kontroll situatën. Ngaqë zemrat e të dashuruarve të cilët nuk mund të qëndronin, madje, asnjë ditë pa mos parë të Dërguarin e All-llahut, nuk do të shihnin Atë në këtë botë kalimtare kurrë më.

Sahabiu Abdulla bin Zejd, i cili nuk mund të përballonte këtë pikëllim ndarjeje, drejtoi duart kah qielli dhe me një zemër të thyer do t'i lutet All-llahut me një sinqeritet dhe do t'i thotë:

“O Zoti im! Tashmë verbëromi sytë! Të mos shoh asgjë në botë pas Profetit të cilin shumë e dua!” Dhe në të vërtetë në atë moment iu verbëruan sytë.<sup>47</sup>

Ebu Bekri (radiall-llahu anhu) pas vdekjes së të Dërguarit të All-llahut kur donte të përcillte ndonjë hadith, përkujtonte të Dërguarin e All-llahut dhe qante, dhe mezi e përcillte hadithin.

Ja si e përshkruan Ebu Hurejreja këtë gjendje të tij:

“Njëherë Ebu Bekri hypi në mimber, shkallore të xhamisë, dhe tha: e dini që vitin e kaluar në vendin ku unë qëndroj tash qëndronte...,” dhe filloi të qajë, më pas përsëriti këtë fjalë dhe përsëri filloi të qajë, kjo gjendje u përsërit disa herë.” ( Tirmidhi, Deava, 105/3558; Ahmed I, III) .

Ebu Bekri, gjersa ishte gjallë i Dërguari i All-llahut, edhe pse vazhdimisht e shoqëronte Atë, ai përsëri ndjente mall për Të. Kurse pas vdekjes së Tij ky mall do të ndizet e do të përvëlojë Ebu Bekrin. Ja si i përshkruan emocionet dhe mallin e Ebu Bekrit

---

<sup>47</sup> Kurtubi, *el-Xhami*, Bejrut 1985, V, 271



për takim me Hazreti Pejgamberin e bija e tij, Aisheja (radiall-lahu anha):

“Babai gjersa ishte në shtrat të vdekjes më pyeti: çfarë ditë është sot!”

“ E hënë”, iu përgjigja.

Ai i emocionuar më tha:

“Nëse ndroj jetë sot, mos vononi varrimin tim deri nesër, ngaqë, për mua dita më e dashur është dita kur jam më afër të Dërguarit të All-llahut.” (domethënë çasti kur do të takoj Atë). (Ahmed, I, 8)

Disa nga as’habët e ndershëm, shikonin me zili të sëmuret të dashuruar në të Dërguarin e All-llahut, të cilët synonin që sa më shpejtë të vijë çasti i takimit me All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, dhe përcillnin selame dhe përshendetje nëpërmjet tyre deri tek sulltani i zemrave tona, i Dërguari i All-llahut.

Për shembull, njëherë Muhammed bin Munkedir (radiall-lahu anhu) vizitoi gjatë sëmurjes së vdekjes ashikun e të Dërguarit të Allahut, Hazreti Xhabirin. Kur kuptoi se vdekja i është afruar Xhabirit, Muhammed bin Munkediri, ashiku i Profetit, zemra e të cilit ishte përmalluar për Profetin i tha Xhabirit:

“Përcilli Muhammedit (salall-llahu alejhi ve sel-lem) selame prej nesh!” ( Ibn Maaxhe, Xhenaiz, 4)

As’habët fisnikë, ashikë të profetit kishin dëshirë të rikujtojnë momentet që kan të bëjnë me Hazreti Pejgamberin.

Bera (radiall-llahu anha) tregon se i ati i saj në çdo çast mendohej të dëgjonte ndonjë kujtim mbi të Dërguarin, dhe në këtë kontekst përcjell këtë ngjarje:

“Ebu Bekri bleu një samar 13 dirhem prej babait tim. Ebu Bekri i tha babait tim:

‘Thuaj Berasë që të dërgoj në shtëpinë time këtë samar’, kurse babai im, ashiku i Profetit të All-llahut, i tha:

‘Jo! Derisa të më rrëfesh udhëtimin tënd me të Dërguarin e All-llahut prej Mekkës deri në Medine, përderisa politeistët mekas u ndiqnin.’

Ebu Bekri filloi të rrëfejë Hixhretin, dhe i tha:

‘U larguam nga shpella dhe u nisëm në rrugë atë natë, dhe nesër pa ndërprerë ecëm deri në drekë. Në drekë hodha një sy përreth që të gjeja ndonjë hije, diku larg pashë një shkëmb dhe mendova se aty mund të gjejmë pak hije. Kur vajtëm tek shkëmbi, i shtrova të Dërguarit të All-llahut një shtrojë nën hije të shkëmbit, dhe i thashë:

‘O i Dërguari i All-llahut, urdhëroni uluni e pushoni pak!’

Profeti u ul të pushojë kurse unë vështroja përreth, në ndërkohë pashë një bari që po kulloste kopenë në drejtim të shkëmbit, edhe ai si që dukej, kërkonte hije.

‘Bariu i kujt je ti?’ e pyeta. Ai tregoi emrin e një personi prej kurejshëve të cilin unë e njihja.

Unë e pyeta:

‘A kanë qumësht dhentë?’

‘Po’, ma ktheu përgjigjen.

Atëherë unë i thash:

‘Mirë, a ka mundësi të na mjelësh pak qumësht nga dhentë?’

‘Po, pse jo.’ u përgjigj ai.

Më pas, nga kopeja zuri një dele dhe e moli. Paraprakisht i thashë bariut të pastrojë mirë duart dhe gjinjtë e deles. Moli delen dhe na dha pak qumësht. Unë kisha një matarë për të Dërguarin të cilën e mbyllsha me një bez. Më pas qumështit i shtova dhe pak ujë dhe ia dërgova Profetit, Krenarisë së Gjithësisë, i cili në ato momente ishte zgjuar nga gjumi, dhe i thashë:

‘Urdhëroni, o i Dërguari i All-llahut.’

I Dërguari i All-llahut (salall-llahu alejhi ve sel-lem) piu qumështin, kurse unë paksa u qëtsova...”<sup>48</sup> (Buhari, As’habu’n Nebi , 2; Ahmed, I ;2)

As’habët aq shumë e nderonin, respektonin dhe dashuronin Profetin, derisa, disa prej tyre nuk qethnin flokët ngaqë ua kishte prekur i Dërguari i All-llahut. (Ebu Davud, Salat, 28/501)

Sa manifestim i bukur i dashurisë profetike është hadithi në të cilin zonjat sahabe motivonin dhe u mbjellnin dashurinë profetike fëmijëve të tyre.

---

<sup>48</sup> Sipas traditës arabe paraislame qumështi i të gjithë kafshëve, për udhëtarët konsiderohej i lejueshëm. Pronarët e kopeve ua bënë me dije barinjve të tyre këtë moment, dhe i këshillonin që të mos refuzojnë asnjë udhëtar, që do të kërkonte qumësht nga kopetë. (Suhejli, *Ravdu’l-nuuf*, Bejrut 1978, II, 152)

Zonjat sahabë qortonin fëmijët e tyre kur ata kalonin kohë të gjatë pa mos u takuar me të Dërguarin e All-llahut.

Meqë sahabiu Hudhejfe (radiall-llahu anhu) disa ditë nuk kishte takuar Profetin, e ëma e tij u nxeh, dhe e qortoi atë. Ja si rrëfen këtë ngjarje vetë Hudhejfeja:

“Nëna më pyeti: Kur je takuar për së fundi herë me të Dërguarin e All-llahut?”

Unë iu përgjegja dhe i thash:

“Kan kaluar ca ditë që nuk jam takuar me të Dërguarin e All-llahut.” Nëna ime u nxeh dhe më qortoj fortë.

Unë i thash:

“Prit nënë, mos u nxeh do të shkoj me një herë tek i Dërguari i All-llahut, do të fal namazin e mbrëmjes së bashku atë, dhe do të lus atë që të bëj dua për ty dhe për mua....!” (Tirmidhi, Menakib, 30/3781; Ahmed, V, 391-392)

Gjendja e muezinit kryesor të Profetit, bilbilit të xhamisë Profetike, Hazreti Bilallit (radiall-llahu anhu) ishte krejtësisht ndryshe. Kur ndërroi jetë Krenaria e Gjithësisë, Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) Bilalli sikur gëlltiti gjuhën, mbylli gojën për të mos hapur kurrë. Medineja iu duk e ngushtë.

Halifeja i atëhershëm Hazreti Ebu Bekri iu lut atij disa herë që të thirrte ezanin, që të rringjallte kujtimet e shenjta të ezaneve të kohës së të Dërguarit të All-llahut. Kurse Bilalli iu përgjigj:

“O udhëheqës i besimtarëve, nëse më pyet mua, unë nuk kam fuqi të thërras ezanin. Mos më lodh, të lutem më ler të qetë.”

Hazreti Ebu Bekri (radiall-llahu anhu) i përmalluar për të Dërguarin e All-llahut, këmbëngulte që Bilalli të thërret e zanin, duke, i thënë atij:

“Apo e privon ummetin, pas vdekjes së Profetit edhe nga muezini i dashur i tij?”

Bilalli i cili nuk mundte të përballojë insistimet e tij, një ditë në namazin e sabahut, sytë e mbushur me lot e i përmallur u ngjit në minare të xhamisë. Por, kur për një çast iu kujtuan ato ditë të lumturisë, e kaploi vaji dhe nuk pati mundësi të përfundojë ezanin, dhe zbriti nga minareja. Ebu Bekri, kuptoi këtë gjendje të thellë të bilbilit, dhe nuk insistoi edhe më tepër.

Bilalli, i mbushur me kujtime të shenjta të kohës profetike, nuk mundi të qëndrojë edhe më tej në Medine, dhe pas namazit të mëngjesit të kësaj dite, mori rrugën për në Sham (Damask).

Me mall për takim me të Dërguarin e All-llahut, ai vazhdimisht merrte pjesë në luftërat rreth kufijve të shtetit në kërkim të *shehadetit*, dëshmorisë. Por, caktimi i All-llahut ishte i tillë, ai kthehej vazhdimisht prej lufte si luftëtar, *gazi*. Dhe kështu kaluan vite të tëra, madje, edhe pas kohës së kolerës e cila u përhap në Sham, e që mori jetën e mbi 25. 000 personave, Bilalli do të ngelë i gjallë e i shëndoshë. Por, gjatë gjithë jetës zemra do t'i përvëlohet nga kjo ndarje. Një ditë, Bilalli e pa në ëndërë të Dërguarin e All-llahun (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), ku Profeti i thoshte Bilallit:

*“Ç’është kjo ndarje o Bilall, a thua, ende nuk erdhi koha e takimit!”*

Bilalli i pikëlluar, në atë moment u zgjua dhe mori rrugën për në Medine, për të vizituar varrin e ndershëm të të Dërguarit të All-llahut. Dhe, gjersa qante e vajtonte para varrit të Profetit, aty erdhën nipat e Pejgamberit, Hazreti Hasani dhe Hazreti Husejni. Kur Bilalli i pa dy nipat e Profetit, të cilët Profeti i përqafoi dhe thoshte se, ata janë si dy dyert e Xhennetit, për një çast humbi veten, pastaj u këndell dhe përqafoi ata me mall. Ata i thanë Bilallit:

“O Bilall, shumë kemi dëshirë të dëgjojmë thirrjen tënde të ezanit.”

Bilalli nuk mundi të refuzojë këtë ofertë madhore, dhe filloi të thirrte ezanin. Medineja për një çast u dridh nga kumbimi i zërit të muezinit të Profetit. Kur Bilalli, gjatë ezanit përsëriti shprehjen:

*“Eshhedu ene Muhammede’r-Resulall-llah”*, të gjithë banorët e Medines burra, gra, fëmijë, vrapuan drejt Xhamisë Profetike duke menduar se Profeti është ringjallur. Nuk është parë kur që në Medine, pas vdekjes së Profetit, të ishte qarë e vajtuar kaq shumë.<sup>49</sup>

Ky ashik i të Dërguarit të All-llahut, do të ndërojë jetë në moshën 60 vjeçare në Damask, në çastet e vdekjes gëzohej e përsëriste vazhdimisht fjalët: “Nesër, inshall-llah, do të takoj shokët e mi të dashur, Hazreti Muhammedin dhe shokët e tij.”

Me një rën anë bashkëshortja e tij, duke qarë për Bilallin thoshte “mjerë për mua”, në anën tjetër, Bilalli i gëzuar thoshte:

---

<sup>49</sup> Ibni Esir, *Usdu’l-gabe*, I, 244-245; Zehebi, *Sijeru a’lâmi’n-nubela*, Bejrut 1986-1988, I, 357-358.

“Ah sa bukur, sa mirë!” (Dhehebi, Sijer, I, 359)

Këtë dashuri të as’habëve fisnikë e gjejmë qartë edhe në përcjelljen e hadithëve. Kur as’habët përcillnin një hadith nga Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) nga frika që të mos bëjnë ndonjë gabim në përcjellje, u dridhej trupi u zverdhej fytyra. Për shembull kur sahabiu Abdulla Bin Mesud, thoshte:

“*Kale resulullah*-ka thënë i Dërguari i All-llahut!”, e kaplonte një e dridhur e fortë. Shumë as’habë transmetues, duke i pasur parasysh dobësitë njerëzore, kur i atribonin ndojnë fjalë të Dërguarit të All-llahut thonin:

“Kështu, ose diçka ngjashëm me këtë ka thënë i Dërguari i All-llahut.” ( Ibn Maaxhe, Mukadime, 3)

Ndodhte kështu sepse ai ishte një Pejgamber, për të cilin edhe trangu i hurmës, mbi të cilin ai mbante hutben, ligjeratën e së premtës, do të qajë me mall. Derisa edhe të pranishmit do të dëgjojnë edhe rënkimet e të qarit të trungut. Nga gishtat e Tij do të rrjedh ujë për ummetin e etur. Të sëmuret të cilët pinin ujë nga ena me të cilën ai merrte abdestin gjenin shërim. Personat të cilët gjendeshin në shoqëri të Tij rreth sofrës dëgjonin zërin e tesbiheve, lartësimeve të ushqimit që gjendej në sofër.<sup>50</sup> Qimet e bekuara të mjekrës dhe flokëve të tij, të quajtura “ *sakalli sherif*” do të mugullojnë mëshirë për besimtarët, duke u rruajtur në minberet, shkalloret e xhamive.

Ai, imami i ringjalljes në Kiamet!

Ai, ndërmjetësues për falje për mëkatarët!

---

<sup>50</sup> Për këto dhe mrekulli të ngjajshme me këto shih: Buhari, Menakib, 25.

Ai, që ka qarë për ummetin e Tij, duke u lutur: ummeti im, ummeti im!

*Livaul-hamd* (flamuri i falënderimit) në dorën e ij!

Të gjithë profetët, nën hijen e Tij!

Dora e parë që do të hapë portat e Xhennetit, dora e Tij

Sa bukur e përshkruan këtë pamje poeti Shejh Galib:

*Hutbeja të këndohet nga minberi i klimës së përjetësisë.*

*Vendimi yt dëgjohet në gjyqin e ditës së llogarisë*

*Korali i pritjes të këndohet në qiellin e Zotit të gjithësisë*

*Në qiej e në tokë përmendet emri yt i nderuar i mirësisë!*

*Ti je Ahmed, Mahmud dhe Muhammed zotëriu ynë!*

*Mbret i vendosur për ne nga Zoti, zotëriu ynë!*

### **Ujvarat e dashurisë së periudhës pas as’habëve të ndershëm**

Ky karavan i ashkut dhe dashurisë profetike, i cili mugullon mëshirë për gjithë botërat, ka vazhduar të ekzistojë edhe pas periudhës së as’habëve, njejtë si burim freskie dhe entuziazmi, drejt oqeanit të takimit (*vusllat*). Paqja dhe lumturia e të dy botve janë të mundura vetëm e vetëm me posedimin e dashurisë dhe afërsisë për të. Në një hadith tregohet fakti që të dashuruarit për të Dërguarin e All-llahut do të ekzistojnë deri në Kiamet, në të cilin thuhet:



*“Një pjesë nga ummeti im që do të më duan mua më shumë, do të shfaqen në botë, ndër ata që do të vijnë pas meje. Ata do të jenë të gatshëm të flijojnë pasuritë dhe familjet e tyre për të më parë mua.”* (Muslim, Xhennet, 12; Hakim IV, 95/6991).

Zoti ynë, na bën neve të mundur që edhe ne të jemi pjestarë të këtij grupi të njerëzve! Amin.

Sa mësimdhënës është ky shembull, në të cilin tregohet se dashuria dhe pasioni për të Dërguarin e All-llahut i të dashuruarve, ashikëve në Të, i tejkalon të gjitha mundimet kalimtare:

Abdull-llah bin Mubarek rrëfen e thotë:

“Isha tek Imam Maliku, ai na përcillte neve hadithe të të Dërguarit të All-llahut, në ndërkohë nga gjurmët në fytyrë mësohej se ishte nën mundime. I ndrohej ngjyra në fytyrë, dridhej, por megjithkëtë nuk ndërpriste interpretimin e haditheve. Kur mbaroi mësimi dhe u shpërndanë të pranishmit, iu afrova dhe e pyeta:

‘O Eba Abdull-llah! Sot vërejta tek ju diçka të jashtëzakonshme?’

Ai m’u përgjigj:

‘Po, gjatë ligjërimit erdhi dhe më kafshoi një akrep disa herë, i përballova dhe i durova që të gjitha dhimbjet nga respekti dhe ndera që kam ndaj të Dërguarit të All-llahut.’<sup>51</sup>

Imam Maliku (radi-allahu anhu), në shenjë rrespekti për tokën ku pati shkelur Profeti, sa ishte në Medine, nuk kaloi hipur

---

<sup>51</sup> Munavi, *Fejzu’l-Kadir*, Bejrut 1994, III, 333; Sujuti, *Miftahu’l-Xhenne*, s. 52.

mbi kafshë, nuk mbathi këpucë. Kur dikush e pyeste atë për ndonjë hadith, ai bënte një parapërgatitje të gjatë, merrte abdes, e rrihurte çallmën, parfymosej me errëra të mira misku, ulej mbi ndonjë vend të lartë, dhe vetëm pastaj i pranonte vizitorët apo nxënësit. Ai përgatitej për t'iu përgjigjur me dinjitet frymës shpirtërore profetike të përfaqësuar në hadithe. Ai tregojte shumë i kujdesshëm e i vëmendëshëm në përcjelljen e haditheve.

Derisa ai ishte imam në Xhaminë Profetike, Mesxhid'un-Nebevi, në të cilin gjendet edhe varri i Profetit, *ravzai muttahare*, gjithmonë fliste me zë të ulur, në shenjë respekti për Profetin. Një herë kur në xhaminë e Profetit kishte ardhur halifi i kohës, Ebu Xhafer el-Mensuri, i cili nga pakujdesia, fliste me zë lartë, Imam Maliku, ia pati tërhequr vërejtjen Halifit që të kontrollonte zërin e të mos fliste me zë të lartë, duke i thënë:

“O Halif! Ule zërin në këtë ambient! Paralajmërimi i All-llahut që të mos flitet me zë të lartë në prani të Profetit u qe bërë sahabëve që, pa mëdyshje, kanë qenë shumë më të shquar se ju!”<sup>52</sup>

Po ashtu Imam Maliku e pati falur valiun e Medines, që i pati bërë padrejtësi, duke i thënë:

“Më vjen turp të jem paditës në Ahiret për një person që është nip i të Dërguarit të All-llahut!”

Prijësi i madh i ummetit, i lidhur ngusht me dashuri me të Dërguarin e All-llahut, Sejjid Ahmed Jesevi, nga dashuria dhe pasioni i lartë që ndjente për Profetin, i cili ka vdekur në moshën

---

<sup>52</sup> Këtu aludon në këtë ajet ku'anor: “O ju që keni besuar, mos ngritni zërin tuaj mbi zërin e Pejgamberit..” (el-Huxhurat, 2)

63 vjeçare, kur arriti në moshën 63 vjeçare, u përshëndet nga qëndrimi mbi dhë, dhe vazhdoi detyrën e tij si kumtues në një vend si varr.

Dijetari i madh e i shquar i hadithit, ideatori Imam Neveviu ishte i lidhur aq shumë pas Profetit, sa që nuk pati ngrënë shalqi kurrë në jetë, vetëm e vetëm pse s'e dinte se në çfarë mënyre kishte ngrënë shalqinin Profeti. Ky dijetarë i urtë, është larguar nga të ngrënit shalqin meqë nuk ka dashur që, madje, edhe në një çështje të jetës të veprojë jashtë modelit të Profetit, të cilin e kishte ndjekur në të gjitha sferat e jetës.

Në të kaluarën ka qenë zakon që në vula të shënohej diçka tejet domethënëse apo proverbiale, veçanrisht në poezi. Për të shënuar faktin se Zoti e krijoi këtë gjithësi në saje të dashurisë për dritën muhammediane, Nëna Mbretëreshë, Valide Sulltan, e mbiquajtur Bezmi Alem, pati shkruar në vulën e saj këto vargje:

*Muhammedi nga dashuria u krijua;*

*Nga dashuria pa Muhammed ç'është krijuar?!*

*Nga dalja e Tij, Bezmi Alem u bë e paharruar!...*

Kurse poeti i mirënjohur mistik Fuzuli, në të famshmen Kaside e Ujit, kështu e shpreh këtë djegie e përmallim:

*O sy, mos derdh ujë mbi zjarrin e përflakur të zemrës sime,*

*Se s'ka ç'i bën uji këtij zjarri të ndezur me kaq flakërime!*

*S'e di, a ngjyrë uji ka qielli që vërtitet pa pushuar,*

*Apo uji i derdhur nga sytë e mi qiellin ka mbuluar?*

*Le të mos mundohet kot kopshtari ta ujisë trëndafilishten që nuk çel,*

*Se një mijë trëndafilishte të ujisë, si fytyra jote trëndafil nuk çel!*

*O miq, në vdeksha me dëshirën për t'ia puthur dorën Atij,*

*Bëni një shtëmbë me dheun tim e jepni ujë të dashurit madhor të pijë!*

*Për ta arritur atë tokë ku ka shkelur këmba e tij plot nur,*

*Një jetë të tërë vrapon uji duke përplasur kokën gur më gur!*

Autori i mevludit, kryeveprës së letërsisë turke Sulejman Çelebiu, thotë se, madje, edhe dielli rrotullohet si flutur përreth Tij, duke u shprehur:

*Një nur i çuditshëm që dielli i vërtitet përreth si flutur...*

Poeti Nabi, në rrugë për në haxh, kur karavani iu afrua Medines së Shndërritëshme, u prek dhe u hidhërua shumë kur pa një pasha i cili nga pakujdesia i kishte zgjatur këmbët drejt varrit profetik, *ravzai muttahir*. I prekur thellë poeti do të recitoj këto vargje, me të cilat tregon respektin ndaj të Dërguarit:

*Ruhu nga pa edukata, është ky vendi i të dashurit të Zotit ky.*

*Është vendvëzhgimi hyjnor, është posti i Mustafasë ky.*

*Me plotë edukatë hyr, o Nabi, në këtë vendpreheje.*

*Vendi ku vërtiten engjëjt, është pragu i puthur nga profetët ky!*

Njëri nga të urtët e mëdhenj të kohëve të fundit, Mehmet Esad Efendiu, e ka shprehur kështu zjarrin përvëlues të dashurisë që ndjente për Profetin:

*Nga manifestimi i bukurisë sate, i dashuri im, pranvera digjet flakë!*

*Trëndafili, bilbili, zymbili, tokë e gjemba digjen flakë!*

Sa të bukura janë këto vargje të poetit lirik të kohëve të vona, të mbiquajtur Jaman Dede, i cili megjithëse i krishterë, pas shijimit të kënaqësisë së njohjes së të vërtetës muhammediane, që kthyer në një besimtarë sylotë dhe në një të dashur të pasionuar të Pejgamberit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem):

*Pa ujë në shkretëtirë shpirt në dhënça, dhiembje s'ndej;*

*Në gjoks më vlojnë vullkanet, në oqeane freskim s'ndej;*

*Flakë në reshofshin nga qiejt dhe më prekshin, s'ndej;*

*Me bukurinë tënde më lehtëso se u dogja, o Resulull-llah!*

*Ç'fat të mbyll sytë me dashurinë, në rrugën tënde të jap shpirt!*

*A s'mundet, mbreti im, në intimitetin tënd të jap shpirt!*

*Me sytë në të shuar, e lehtë në vëllazërinë tënde të jap shpirt!*

*Me bukurinë tënde më lehtëso se u dogja, o Resulull-llah!*

*U nënshtrova, i dërrmuar, shërimi i këtij mjerimi është tek ti!*

*M'u plasën buzët nga zjarri, m'i lehtëson kur përmendësh ti!*

*Kur të ta dojë zemra, përkthele këtë Kitmirin, ti!*<sup>53</sup>

*Me bukurinë tënde më lehtëso se u dogja, o Resulull-llah!*

Harenë dhe entuziazmin e banorëve të qiellit me rastin e miraxhit të të Dërguarit të All-llahut, poeti Kemal Edip Kyrkçyogllu e shpre kështu:

*Me që ia soditi fytyrën natën e miraxhit,*

*Bie në tokë në sexhde falënderim qielli me fytyrë përdhe...*

*Çdo natë hyn në ihram Shpirti i Shenjtë*

*Për të hyrë te intimiteti i nderuar si mik me zemër plot hare...*

*All-llah, All-llah, sikur ta shoh dhe një herë, thotë,*

*Pas fytyrës së bukur i mahnitur e humb mendjen kush e sheh...*

I Dëguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) është personalitet të cilin ndjekësit dhe ata që e kanë pranuar Atë si udhërefyës kanë qenë për njerëzimin personalitete të shkëlqyeshëm si yjet në qiell. As'habët e ndershëm, miqtë e Zotit dhe të mirët kanë fituar vlerë në bazë të afërsisë që ata kanë pasur me atë Krenari të Gjithësisë.

Vallë në zemrat tona sa kemi pjesë nga klimat shpirtërore të personave si Abdull-llah bin Zejdi, Bilal Habeshiu, Imam Neveviu, Sejjid Ahmed Jeseviu?

Edhe ne, duhet mbajtur nivelin e dashurisë ndaj të Dërguarit të All-llahut në korniza të manifestimeve të dashurisë, e cila duke filluar nga as'habët e ndershëm, me këto kritere duhet mbajtur se

---

<sup>53</sup> Kitmir: simbolikisht, qen roje i derës.

sa ne jetojmë si ummet i denjë ndaj Tij, dhe shpirtit tonë duhet bërë një vaksinim me qëllim ripërtrirjeje dhe rizgjimi.

Kriteret për të matur situatat e prijëtarëve shpirtërorë, për të cilët e kemi fjalën këtu, janë kriteret e heronjve shpirtërorë të ekstazës të cilët janë personalitete yje. Por ajo që i bën ata yje në qiejt e zemrave të besimtarëve që do të vijnë në të ardhmen deri në kijamet është dashuria, ashku, pasioni dhe lidhshmëria e tyre me të Dërguarin e All-llahut.

E dimë se dashuria dhe pasioni janë si lidhje korenti ndërmjet dy zemrave. Është kusht i patejkalueshëm që të mbjellësh në zemër këtë potencial nëse don të jeshë një besimtarë i mirë. Krizat të cilat i përjeton njerëzimi në ditët tona vijnë si rrjedhojë e humbjes së këtij potenciali të zemrës. Mu për këtë, sa e sa vlera asgjësohen, humben dhe coptohen në dhëmbëzorët e egos, *nefsit*. Kur rrjedhat dhe tendencat janë çdo herë egoiste dhe vetëm për këtë botë, askush nuk ka mundësi të gjejë rrugën për shkënditë e shpirtit. Që zemra të realizojë ngritje nga dashuria figurative drejt dashurisë reale, që udhëtimi i Mexhnunit i cili fillon prej Lejlas të përfundojë në Zotin, duhet që zemra e rëndomtë, duke u maturuar, pjekur, si rrjedhojë e ushtrimeve shpirtërore, të arrijë fuqi për dashuri të tillë. Të gjitha këto krime, trazira dhe situata të papëlqyeshme vinë si pasojë e mungesës së dashurisë së realtë, *ashkut*.

Madhësia e dashurisë së vërtetë matet me flijimin dhe riskun që personi e bën për të dashurin kur ka nevojë. Ai që diçka dashuron shumë, kur nevojitet, flijon veten dhe nuk shijon ndjenën e flijimit. Lëviz qetë sikur paguan borxhin. Por ata të cilët nuk e njohin dashurinë e vërtetë, ata të cilët nuk kanë hyrë

në rrugën e përsosshmërisë, maturimit, harxhojnë dhe mendojnë zemrën duke jetuar nën sundimin e egos, *nefsit*.

Të ngarkohesh me emanetin të cilin nuk e kanë pranuar, madje, as malet, don të thotë privilegji hyjnor dhuruar njeriut. Kusht për të përfituar me plotë kuptim të fjalës këtë privilegj dhe dobi është arritja e dashurisë, ashkut të vërtetë. Ngaqë kjo përplasje dhe ndeshje në shpirtin e njeriut mund të tretet dhe të humbet vetëm në dashuri të vërtetë. Njeriu i përsosur, *insani kamil*, me reflektimet që fiton nga një personalitet shembullor, xhvesh shpirtin nga tendencat shtazarake dhe shëndëron zemrën në bahçe Xhenneti, prej ku do të hapen dritare për pamje hyjnore. Zoti ynë në Kur'ani Fisnik në ajetin 29 të sures el-Hixhër thotë: **“Dhe i dhash atij nga shpirti im”**, ku ia përkujton njeriut esencën madhështore që ia dhuroi All-llahu atij.

Nëse ky sihariq dhe kjo esencë madhështore do të lartësojë njeriun, si rrrjedhojë e pasionit dhe dashurisë, në përsosshmëri, atëherë zemra fillon të ngrihet drejt botës së fshehtë hyjnore. Sekretet e botës hyjnore nxjerrin në shesh realitetin e ekzistencave, sekretin e quajtur njeri dhe gjithësi. Atëherë robi fillonë të shohë pamjet e manifestimeve të zemrës së shëndoshë, *kalbi selim*. Kur njeriu arrinë këtë përsosshmëri, atëherë fillojn të hapen perdet e errësirës ndërmjet njeriut dhe All-llahut; njeriu shijon ndjenjën e fshehtësisë: **“të vdesësh para se me vdekur”**. Kjo botë, dhe dashuria e fundme për të, e gjithë bukuria kalimtare, largohet nga syri dhe del nga zemra. Shpirti, në këtë mënyrë, arrin kënaqësinë e papërshekruar të afërsisë me Krijuesin e tij.



Kurse ata të cilët nuk kanë pasur fatin të shijojnë dashurinë e vërtetë, janë ata të cilët sillen e rrotullohen në kornizat shtazarake që përndryshe, ekzistojnë te njeriu, dhe nuk kanë hudhur asnjë hap drejt sferës engjëjlore. Njohja, *marifeti*, është në dashuri. Ngaqë pretekst i ekzistencës është dashuria. Mëshira hyjnore e cila do të bartë njeriun nga robëria në lumturi, është i Dërguari i All-llahut, i prezentuar për njerëzimin si shembëlltyrë më e bukur, *usvei hasen*. Rruga e lumturisë së realtë arrihet vetëm nëse dashurinë e vërtetë e mësojmë nga vetë Ai, Profeti, duke u tretur në Të dhe duke ndjekur atë me këtë dashuri. Ngaqë, i Dërguari i All-llahut është bebëza syrit, esenca dhe preteksti i krijimit të gjithësisë. Është udhërrëfyes takimi, *vuslat*, mes njeriut dhe All-llahut. Ai me gjendjet e Tij kulmore, ka qenë një shembull i përkryer që portretizon nënshtrimin para All-llahut, gjendje këto para të cilave rrëfimet dhe shpjegimet ngelin të mangëta nga përshkrimi i realt. Shkurt thënë, Ai është mëshirë dhe pasion, dashuri që përfshin tërë gjithësinë. Zemrat e të dashurve, ashikëve, të cilat i janë nënshtruar Atij, në këtë botë gjithmonë digjen dhe përvëlohen me dashurinë që kanë për të, dhe në çdo moment do të kapërdinë pikëllimin e takimit madhështor me Atë.

Kjo është ajo dashuri e cila e bën Junusin Junus, e bën Mevlananë Mevlana<sup>54</sup>. Poeti Mevlana Xhelaled-din er-Rumi në saje të kësaj dashurie do të hedhë hapat në drejtim të klimës së lumturisë së vërtetë të përhershme. Lumturia e tij ishte e pafund, eterne, për takim me të Fuqishmin Apsolut, All-llahun. Ngaqë ata kur xhveshen nga robërimi material i lëkurës së fundme dhe

---

<sup>54</sup> Autori këtu e ka fjalën për dy poetët e njohur sentimental mistik islam, Junus Emre dhe Mevlana Xhelaled-din er-Rumi, të cilët kanë ndikim të madh tek ai. (N. R.)

ngjiten drejt pafundësisë, gëzohen vetëm e vetëm me pafundësinë. A thua si dhe sa mund të jetë e mundur lumturia me të fundmit?

Nga një aspekt fjalët në vazhdim të Mevlana Xhelaled-din er-Rumiut, rrëfejnë burimin e lumturisë dhe harresë së tij:

*“Unë do të jemë rob i Kur’anit gjersa të kem shpirt.*

*Unë jam pluhuri i këmbës së Hazreti Muhammedit.*

*Nëse dikush do të përcjell prej meje, madje, qoftë edhe një fjalë tjetër, unë jam larg tij dhe fjalës së tij!”*

Domethënia e të qenit pluhur i këmbës së Hazreti Muhammedit dhe vënies së kokës në rrugë të Tij don të thothë të jetosh i lidhur me dashuri për Të dhe të ndjekësh sunnetin, rrugën e Tij në çdo sferë të jetës.

Një rrugë tjetër që duhet fituar për të ndjekur denjësisht dhe për të përvetësuar botën shpirtërore të Dritës së Ekzistencës, është bërja shprehi e përsëritjeve të salavateve, uratave për Profetin. Shprehi kjo që do të frymëzojë në zemrat tona dashuri profetike.

### **Salavati sherife/përsëritje të ndershme**

Zoti I Vërtetë, në Kur’anin Fisnik betohet në jetën e Profetit tonë (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Përmend emrin e lartë të Tij së bashku me emrin e Vet, dhe e ka bërë kusht për të qenë rrob besimtarë, besimin në profetësinë e Tij. Ka shprehur pakënaqësinë për ngritjen e zërit në prezencë të Tij dhe për përmendjen e emrit të Tij si ndonjë emër të rëndomtë. Dhe, edhe

më tepër, duke treguar se All-llahu dhe engjëjt e përshëndesin atë me salate/urata shumë, ka këshilluar e kushtëzuar besimtarët që të përshëndesin Atë shpesh me salate dhe selame.

Ashtu si që kuptohet edhe nga ajeti i 56-të i sures el-Ahzab, në të cilin thuhet:

“Me të vërtetë All-llahu dhe engjujt e Tij i dërgojnë salte/urata Profetit. O ju besimtarë madhëronie atë duke i dërguar salate/urata dhe selame/përshëndetje”, për besimtarët është një urdhër hyjnor që të përshëndesin Atë me salate dhe selame.

Njëri ndër as-habët e dalluar të Profetit, sahabiu Ubej bin Kab (radiall-llahu anhu) rrëfen e thotë:

“Pasi kaloi një e treta e natës, i Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) u zgjua dhe tha:

*‘O njerëz! Përmendeni dhe përkujtojeni (bëni dhikër) All-llahun. Përmendeni dhe përkujtojeni All-llahun! Do të fryej suri iparë, i cili do të dridh botën. Më pas do të pasojë i dyti. Vdekja do të vijë me të gjitha vështirësitë. Vdekja do të vijë me të gjitha vështirësitë.’*

Atëherë unë e pyeta Hazreti Pejgamberin:

“O i Dërguar i All-llahut! Unë përsëris shpesh salavatet e ndershme për ju, a thua sa duhet bërë këtë gjatë ditës?”

Profeti më tha:

*“Përsërit sa të duash.”*

Unë përsëri e pyeta:

“Athua mjafton që një të katërtën e lutjeve t’ua kushtojmë salavateve?”

Profeti mu përgjegj;

*“Sa të duash kushtova salavateve. Por, sikur të bësh më tepër për ty është më mirë.”*

Atëherë i thash:

“Do t’ua kushtoj gjysmën e lutjeve salavateve.”

Kurse Ai më tha:

*“Sa të duash kushtova salavateve. Por sikur të bësh edhe më tepër për ty do të jetë edhe më mirë.”*

Unë përsëri e pyeta:

“Atëherë a mjafton që dy të tretën e kohës së ndarë për lutje t’ua kushtoj salavateve.”

Ai më tha:

*“Sa të duash, por sikur të shtosh do të jetë më mirë për ty.”*

Unë përsëri e pyeta:

*“E çfar mendoni sikur t’ua kushtoj salavateve gjithë kohën të cilën e ndaj për dua, lutje.”*

M’u përgjigj:

*“Atëherë All-llahu i Madhëruar do t’i largojë të gjithë brengat dhe do t’i falë të gjitha mëkatet.”* (Tirmidhi, Kijame, 23/2457)

Ja ky është preteksti pse ashikët e Profetit i bëjnë shprehi dhe ushqim shpirtëror salavatet dhe selamet. Salavatet dhe

selamet ndikojnë që në zemër të besimtarit të shtohet dashuria ndaj të Dërguarit të All-llahut.

Pa mëdyshje, për të ndjekur denjësisht dhe për të përfituar nga shembëllyra më e bukur e Tij, është kusht që të kuptohet realiteti kur'anor dhe Sunneti. Kurse kjo do të jetë e mundur me afrim ndaj moralit shembullor dhe thellësive të Hazreti Muhammedit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) .

Asnjë njeri nuk arriti që të përshkruajë virtytin e vërtetë të Tij. Nuk mundi të kuptojë denjësisht moralin dhe natyrën e Tij. Dijetarët, të urtët, mbretërit e zemrave dhe Xhebraili e kunsideruan nderë ndjekjen e rrugës së Tij, pritjen në derën e Tij e llogaritën respekt.

Nga ana tjetër, sipas edukatës islame, lutjet fillojnë e mbarojnë me falënderime e madhërime, *hamde*, për All-llahun dhe salavate për të Dërguarin e All-llahut. Ekziston një mendim dhe qëndrim se All-llahu nuk refuzon salavatet të cilat, në të njejtën kohë, janë edhe lutje. Prej këtu buron realiteti që lutjet tona t'i stolisim, në fillim dhe në fund, me salavate. Domethënë të fusim lutjen tonë ndërmjet dy lutjeve, dhe të shpresojmë për pranimin e tyre.

Në këtë kontekst Hazreti Omeri (radiall-llahu anhu) thotë:

“Lutja ri varur mes tokës e qiellit. Nuk ngrihet deri tek All-llahu derisa nuk themi salavate për të Dërguarin e All-llahut.”  
(Tirmidhi, Vitr, 21/486)

I Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) një ditë prej ditësh pa një njeri i cili i lutej All-llahut pas namazit, pa

mos falenderuar dhe pa mos thënë salavate për të Dërguarin e All-llahut, dhe tha:

*“Ky njeri shpejto.”*

Më pas e ftoi këtë person dhe e këshilloi duke i thënë:

*“Kur dikush nga ju do t’i lutet All-llahut, fillimisht le të falënderoj dhe madhërojë All-llahun, më pas le të çoj salate dhe selame për të Dërguarin e All-llahut. E më pas le të lutet çka të dojë.”*(Tirmidhe, Deavat, 64/3477)

Ibën Abbasi përcjell një hadith në të cilin theksohet rëndësia e ndërmjetësimit të Profetit të All-llahut në lutje, ku thuhet:

Zhvillohej luftë ndërmjet hebrenjëve të Hajberit dhe fisit Gatafan, hebrenjtë hajberas pësonin disfatë në çdo ballafaqim. Në fund iu lutën All-llahut në këtë mënyrë:

“O Zot! Të lutemi, që për hirë të profetit të ummetit të kohës së fundit, për të cilin ke premtuar Ti se do të vijë, na ndihmo neve që të jemi ngadhnyes”, dhe me të vërtetë hajberasit në këtë luftë ngadhnyen kundër fisit Gatafanë.

Por, më pas, ata refuzuan profetësinë dhe librin të cilin e sollti Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), për hirë të të cilit All-llahu u kishte ndihmuar në ballafaqim me armikun e tyre. Për këtë shkak All-llahu i Lartë zbriti këtë ajet kur’anor:

“E kur u erdhi atyre prej All-llahut libri (*Kur’ani*) që është vërtetues i atij, që e kishin pranë, e që para se t’iu vinte e kërkonin ndihmën e tij kundër mosbesimtarëve, e mohuan atë (*Muhammedin*) që e njihnin, kur u erdhi. Pra mallkimi i All-

**llahut qoftë kundër mosbesimtarëve!”** (el-Bekare, 89) (Kurtubi, II, 27; Vakidi, f. 31)

Siç kuptohet, madje edhe jomuslimanët të cilët i luten All-llahut për hirë të Profetit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) shfrytëzojnë mëshirën dhe begatinë që solli Ai për gjithë botërat.

All-llahu i Lartë në Kur'anin Fisnik, duke iu drejtuar të Dërguarit të All-llahut thotë:

**“Po, All-llahu nuk do t'i dënojë ata, derisa ti (*Muhammed*) je në mesin e tyre dhe All-llahu nuk do t'i dënojë, derisa ata kërkojnë falje (*bëjnë istigfarë*).”** (el-Enfal, 33)

Ky lajmërim hyjnor ka ardhur për politeistët. Ja, nëse, edhe politeistët fitojnë privilegjei të këtilla vetëm e vetëm pse gjendeshin në afërsi materiale me Atë, janë të pakapshme dhe të paarritëshme për arsyen njerëzore begatitë hyjnore që do t'i arrijnë besimtarët. Dhe nëse ata besimtarë nuk mjafton vetëm me besimin në atë qenie të bekuar, por marrin pjesë edhe nga dashuria profetike prej të Dërguarit të All-llahut për të formësuar esencën e besimit në fjalë...Ja, këtu, fjala ngel e mangët!...Me të vërtetë, çfarë grade do të arrijë zemra e njeriut në dashurinë për të Dërguarin e All-llahut, prehja dhe lumturia shpirtërore që do të arrijë në këtë botë dhe pozita që do të meritoj në ahiret do të jenë të atij niveli.

Për këtë arsye, kujdes, mos harro t'i çosh shpirtit të Tij të ndershëm salavate dhe selame! Ngaqë je nevojtar për ndërmjetësimin e Tij në ditën më të tmershme!...

# KAPITULLI I KATËRT

- Në shkollë e arsyes dhe zemrës: Personaliteti shembullor
- Sa e duam ne Atë



## Në shkollën e arsyes dhe zemrës

### Personaliteti shembullor

#### Edukata hyjnore: arsimimi që bën njeriun njeri

All-llahu i Madhëruar ka krijuar tokën dhe qiejt për njeriun.<sup>55</sup> Kurse njeriun, nuk e ka lënë të papërgjegjshëm për gjërat që ia ka lënë në disponim dhe për vetveten.<sup>56</sup> Domethënë All-llahu, e ka drejtuar edhe gjithësinë edhe njeriun sipas ligjeve hyjnore. Ai, kështu, ka caktuar që njeriu të jetë në baraspeshë të lirisë së ëmbël dhe përgjegjesisë. Ja si e përshkruan All-llahu i Madhëruar këtë segment në Kur'an:

**“Ai e ngriti edhe qiellin dhe ai vuri drejtësinë. Që të mos kaloni kufirin në drejtësi.”** (er-Rahman, 7-8)

Domethënë njeriu është njësuar me harmonin hyjnore të gjithësisë. Ashtu si që nuk ekziston asnjë prishje të baraspeshës në gjithësi, edhe njeriu, nuk duhet devijuar nga rruga drejt All-llahut. Të urtë, *arif*, janë ata të cilët kanë jetuar në suaza të baraspeshës dhe harmonisë në fjalë. Ata janë rrobërit më fatlumë të të dy botëve. Ata të cilët jetojnë të pasionuar vetëm pas kënaqësive dhe argëtimit kalimtare janë të privuar nga fshehtësia e ardhjes dhe vajtjes nga kjo botë.

Këta nuk kanë arritur të mëshirohen me harmonin dhe artin hyjnor të Zotit të Vërtetë, nuk kanë kuptuar harmonin madhështore. Mjerë për ata të cilët kalojnë jetën në humnerën e injorimit dhe mashtrimit, Ahireti për ata do të jetë pikëllim i madh.

---

<sup>55</sup> el-Xhathije, 13.

<sup>56</sup> el-Kijame, 36.

Zgjidhja e kësaj çështjeje gjendet e fshehtë në realitetin njeri. Është e vërtetë e pakontestueshme se njeriu, i cili është dërguar në këtë botë me qëllim sprove, është i përshtatshëm edhe për të mirën edhe për të keqen. Ngaqë, sprovat kërkon që njeriu të ketë mundësi edhe për të drejtën edhe për gabimin.

Rrjedhoimisht jeta e njeriut, në botën e brendshme dhe të jashtme, është në konflikt ndërmjet të së mirës dhe të së keqes, dhe që të dyja këto duan të sundojnë me njeriun. Domethënë, te njeriu ashtu si që ekziston fuqia e të mirës ekziston edhe fuqia e së keqes (frymës, nefsit të paedukuar).

Arsyeja, të menduarit, të gjykuarit dhe vullneti nuk janë të mjaftueshme që e mira të dalë ngadhënjimtare karshi të keqes në këtë konflikt. Sikur të mjaftonin vetëm këto elemente, atëherë All-llahu i Lartë nuk do të ndihmonte/mbështeste njeriun e parë të krijuar, Hazreti Ademin, edhe me revelatë, *vahj*. Nuk do t'i kumtonte atij të vërtetat të cilat do të udhëzojnë njerëzimin në lumturinë e kësaj dhe botës së pasme. Por, All-llahu i Lartë ka udhëzuar njerëzimin vazhdimisht drejt të Vërtetës me shpallje, zbulesë hyjnore, dhe me profetë. Ka dërguar libra të cilat kanë mbështetur e përforcuar arsyen dhe zemrën e njeriut, ka edukuar njerëzimin me edukatë hyjnore. Ngaqë arsyeja është si ndonjë thikë me dy teha, e shtyn njeriun në terror, poashtu e çon njeriun të bëjë vepra të pëlqyeshme.

Njeriu me arsye arrin në "*ahseni takvim-formën më të bukur*", respektivisht, në pozitën më të lartë të cilën mund të arrijë njeriu. Por shpesh njeriu për shkak të arsyes zbrit në nivelin "*bel hum edal-l-nivelin më inferior se të kafshëve*". Atëherë themi se arsyeja duhet mbajtur nën disiplinë. Kjo disiplinë është edukata hyjnore e shpallur, është udhëzimi

profetik. Nëse arsyeja gjendet nën kontroll të shpalljes e dërgon njeriun në shpëtim. Nëse privohet nga udhërrëfimi i shpalljes, mund të jetë pretekst për pasoja të hidhura.

Në historinë njerëzore mund të gjejmë shumë tiranë të cilët në të njëjtën kohë kanë qenë edhe në kulm të arsyes. Por këta njerëz, sa e sa terrore dhe padrejtësi kanë kryer e nuk kanë ndjerë fare mundim të ndërgjegjes. Ngaqë, krimet që kanë kryer ata, janë vepra më të mençura për ta! Për shembull mbreti hun, Hulagu, gjatë invazionit në Bagdad, do të mbysë 400 mijë njerëz të pafajshëm, por ai nuk ndjente asnjë mundim të ndërgjegjes. Poashtu edhe prindërit e fëmijëve të Mekkes, të periudhës së injorancës paraislame, i dërgonin fëmijët e tyre femra në shkretëtirë për t'i varrosur për së gjalli, pa mos ua varur veshin britmave të zemrave të nënave të përvëlura. Sipas tyre, ishte e njëjtë të presësh një dru dhe një skllav. Madje ata këtë e pranonin si të drejtë legjitime dhe si diçka normale.

Edhe këta ishin njerëz të cilët posedonin arsye dhe ndjenja. Por ishin sikur dhëmbët e ndonjë dhëmbëzori të cilët punojnë prapshtë. Vepronin prapsht.

Këta dhe shumë momente të ngjajshme me këta dëshmojnë se njeriu është krijesë e cila nga prirjet dhe dëshirat që vijnë nga krijimi, ka nevojë për udhëzim, edukim dhe udhërrëfim. Por edhe udhëzimi duhet të jetë komform natyrës së njeriut. Kjo është e mundshme vetëm e vetëm me edukim hyjnor, me kumtimin dhe udhëzimin e profetëve. Në të kundërtën, nëse ndodh një udhëzim i papërshtatshëm për natyrën e njeriut, kjo mund të jetë pretekst për të keqe dhe dëm.

Cila cilësi sondon në karakterin e njeriut, ajo do të luajë rol asgjësues për cilësinë e kundërt. Nëse mbisundon e mira atëherë

e zhduk influencën e të keqes. E nëse mbisundon e keqja, atëherë mundohet të mbisundojë mbi të mirën. Dhe kështu konflikti i mbrendshëm i njeriut zgjatë gjatë gjithë jetës. Për këtë shkak Zoti i Vërtetë, me favorin e vetë, dërgoi profetë dhe *evlija*, miq të Zotit, si udhërefyes dhe edukues. Vetëm ai njeri i cili është i edukuar nën përkujdesjen e duarve të shkathta, frymëzuese dhe të bekuara ka zbuluar bukuritë e natyrës njerëzore. Në këto përkujdesje cilësitë e ngrira sikur akull, shndërrohen në kopshte behari. Ashut si që njerëzitë injorant të kohës paraislame në saje të udhëzimit të Krenarisë së Gjithësisë do të shndërrohen në personalitete më të çmueshme të njerëzimit.

Respektivisht, nëse njerëzit u përmbahen udhëzimeve profetike shndërrohen në njerëz me të cilët është i kënaqur All-llahu, dhe të cilët meritojnë lëvdata. Kurse ata të cilët bien nga provimi hyjnor, konflikti ndërmjet frymës, *nefsit* dhe shpirtit, bien në pozitën e më të poshtërve. Edhe jeta e kësaj bote është krijuar për të sprovuar njeriun se cilën nga këto qëllime do të realizojë. Njeriu me vullnetin e tij të lirë do të drejtojë tendencat pozitive dhe negative në njërën nga këto dy rrugë polarisht të kundërta.

Ky orientim do të realizohet sipas përfundimit të konfliktit ndërmjet frymës dhe shpirtit. Por gjersa të realizohet kjo, njeriu përjeton momente të llojllojshme. Nëse njeriu gjendet në një kopsht me trëndafila shndërrohet në aromë të këndshme. E nëse gjendet në vende të kundërta me këto, mbushet me erëra të papëlqyeshme. Pa mëdyshje, reflektimi i rrethit shihen tek ai. Dhe për këtë themi se qenia më e nevojshme për udhëzim, edukim dhe pastrim është njeriu.

Bota e mbrendëshme e njerëzve të paedukuar dhe personave zemra e të cilëve nuk ka gjetur prehje, i përngjanë pyllit në të cilin janë të strehuar kafshë të shumta. Në çdo njeri, sipas natyrës së tyre gjendet i fshehur një karakter si i kafshës. Dikush është kurnaz sikur dhelpër, dikush mishngrërës sikur hijenë, dikush energjik sikur milingonë, e dikush helmues sikur gjarpër.

Dikush kafshon kur e përkdhel, dikush thithë gjak sikur shushunjë, dikush para teje qesh kurse pas të bën varrin. Që të gjithë këta janë karaktere që gjenden tek kafshët.

Nuk ka shpëtuar veten me edukim shpirtëror nga sundimi i frymës, *nefsit* njeriu i cili nuk ka arritur të ndërtojë një karakter të shëndoshë, njerëzit e këtillë gjenden në harkun e virtyteve të shëmtuara. Te dikush sundon një, te dikush tjetër disa nga karakteret shtazarake. E kur ky realitet i brendshëm reflektohet në fytyrë, nuk është vështirë të njihen këto karaktere, për ata që janë kompetentë. Për rrjedhojë, sjellja e tyre është si pasqyrë e sinqertë e cila reflekton botën e brendshme të tyre.

A nuk është komunizmi, sistem ky i themeluar mbi gjakun e njëzet milion njerëzve, reflektim i një zemre të egër? A nuk janë piramidat, të cilat në të njëjtën kohë janë varreza të mijëra njerëzve për një Faraon, dëshmi të një tiranie të padhimbëshme? Këta, edhe më tej nga sa e sa injorantë, konsiderohen si monumente historike magjepëse, shikuar nga aspekti racional. Por kur këta vështrohen nga prizmi i të vërtetës dhe të drejtës, bie në sy një portret i cili do të mahnitte madje edhe hijenat më gjakatare.

Që të gjitha këto dëshmojnë faktin se nëse në një popull sundojnë njerëz me karakter bretkose, ai vend shndërrohet në baltovinë.

Nëse udhëheqin njerëz me karakter gjarpëri dhe kolopendre, helmohet populli i tërë, fillon terrori dhe anarkia. Por kur në një popull sundojn persona me natyrë trëndafili, i tërë vendi shndërrohet në trëndafilishte, njerëzimi gjen prehjen dhe lumturinë e vërtetë.

Ja për këtë themi se edukata hyjnore është kusht i patejkalueshëm. Personat që gjenden larg edukatës hyjnore të shpallur, madje edhe nëse nuk manifestojnë panoramë të këtyllë terrori, dhe herë-herë veprojnë me drejtësi dhe sjelljetë bukur, ata çdo herë janë potencial për të manifestuar sjellje terrori. Ngaqë, bukuritë e fituara pa edukatë hyjnore janë kalimtare. Në veçanti në momente të vështira dhe gjatë momenteve kur dëshirat egoiste rebelohen, te personat e privuar nga edukata hyjnore, shfaqen, çdo lloj sjelljsh të shëmtuara dhe defektive. Egoja e paedukuar i përgjigjet një macjeje të dashuruar në miun. Kjo macë, duke ngrënë ushqimin e mjaftueshëm për të, nëse sheh një mi, lë anësh dhe nëpërkëmb ushqimin e shijshëm që i gjendet para vetes, dhe hudhet në ndjekje të miut. Edhe njeriu nëse nuk edukohet në suaza të kriterëve hyjnore, edhe pse zemra i është nënshtruar bukurive të panumërta, egoja e shtynë atë zemër të ndjekë miun dhe shkatërron njeriun. Nëse shikojmë jetën e Faraonit dhe Nemrudit, shohëm se sa e sa njerëz, këta tiranë gjakpirës, kanë ekzekutuar vetëm e vetëm për hirë të dëshirave personale, duke i vënë njerëzit në pozitë të një miut të pavlerë. Kurse edukata hyjnore, jo vetëm mbytjen e njeriut të pafajshëm, urdhëron, që njeriu të jetë si një qiri dhe të dridhet edhe para një hakkut të vogël të robit. Hazreti Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ka ndaluar prerjen e paqëllimtë qoftë edhe të një dege të gjelbërt të ndonjë druri. Krenaria i Gjithësisë, në rrugë për në

çlirim të Mekkes, ndërroi rrugën e ushtrisë së Tij, vetëm e vetëm, që të mos frigojë një bushtër që i jepte gji këlyshit. Osmanlliu i edukuar me këtë frymë, me tharmën e mëshirës që trashëgoi nga Hazreti Pejgamberi, do të themelojë vakëfe të shumtë ku do të arrihet kulminacioni në shërbim të njeriut dhe do të shprehet dhembshuri ndaj krijesave tjera. Këtë dhembshuri e kanë vërejtur edhe vizitorët dhe udhëtarët e rastit që vinin në atë kohë në Stamboll. Sipas të cilëve, madje, edhe qentë dhe macet që gjendeshin në lagjet ku jetonin muslimanët shëtitshin rreth njerëzve, kurse në lagjet tjera kur ata shihnin ndonjë njeri largoheshin me vrap.

Që të gjitha këto janë manifestime të edukimit apo të paedukimit të njeriut. Njeriu është ai i cili derdh gjak, ai i cili ujit tokën me gjak, ai i cili pin gjak, poashtu njeriu është ai i cili i ofron gjak ose trëndafil nevojtarit. Por ja që në këtë botë njerëzit me karaktere polarisht të kundërta jetojnë së bashku. Nëse do të shembëllenim këtë realitet do të shohim, se kjo situatë i ngjanë gjendjes së drenushës së butë e cila është e mbyllur në një ahur së bashku me kafshë tjera me natyrë të vrazhdë e të egër. Herëherë jetojnë afër njëri-tjetrit një koprac dhe një bujar, një i urtë dhe një injorant, një tiran dhe një i mëshirshëm. Kopraci është i pamëshirshëm, frigacak, larg shërbesës. Në të kundërtën bujari është i mëshirshëm, modest, në shërbim të njerëzve. I padituri, injoranti, nuk kupton dijetarin e urtë, tirani mendon se është i drejtë dhe çdo herë përdor forcën. Domethënë, në këtë botë jetojnë së bashku persona të cilët kanë shpirt engjëllor dhe pranë tyre hijenat. Njëri është në rrugën e njohjes, kërkesës dhe shërbesës së të Vërtetit, *Hakkut*, tjetri llogarit lumturi të jetuarit me tipare të qenieve inferiore, qëllimi final i të cilëve është:

ushqimi, epshet, pozita dhe pasionet e ndryshme. Në realitet, është një sprovë e rëndë të jetosh në një botë e cila ngërthen në vete karaktere të ndryshme. Qëllimi i vërtetë i njeriut është të kalojë këtë provim dhe të fitojë miratimin dhe takimin me All-llahun. Për këtë shkak ai duhet të zhvishet nga e shëmtuara dhe të përvetësojë virtytet e lavdëruara.

Qenia njerëzore, e cila është qiellore nga aspekti shpirtëror, fizikisht është e krijuar nga dheu. Kur shpirti do të kthehet tek All-llahu, trupi do të kthehet në tokë. Njeriu, nga aspekti fizik mban cilësi të qenieve tjera. Për këtë shkak, është e nevojshme që ai të përgatisë veten me një edukatë dhe pastrim hyjnor, të mbajë nën kontroll egon e tij dhe të ushqejë dhe forcojë shpirtin. Në të kundërtën është e patejkaluaeshme disfata karshi djallit nga jashtë, dhe fuqive destruktive egoiste, *nefsani*, nga mbrenda. Në këtë kontekst All-llahu i Lartë në një ajet kur'anor thotë:

**“Pasha njeriun dhe Atë që e krijoi atë! Dhe ia mësoi se cilat janë të këqiat dhe të mirat e tij. Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten (nga papastërtitë shpirtërore dhe fizike). E ka dështuar ai që e poshtëroi vetveten.”** (esh-Shems, 7-10)

Ja si i komenton dhe i përshkruan poeti Mevlana Xhelaled-din er-Rumi, të keqen (*fuxhur*) dhe të mirën (*takvallëkun*) të cilat All-llahu i Lartë i përmend në këtë verset kur'anor:

*“O ti që udhëton drejt të Vërtetit,Hakut! Nëse dëshiron të mësosh të vërtetën, nuk ka vdekur as Musai e as Faraoni, sot ata jetojnë në ty, janë të fshehur në qenien tënde, vazhdojnë luftimet në zemrën tënde. Për këtë shkak, duhet të kërkosh në veten tënde këta dy persona që vazhdojnë të luftojnë ndërmjet veti!”*

Poashtu, Rumi në këtë kontekst këshillon dhe thotë:



*“Mos ushqe e mos zgjero lëkurën! Ngaqë, në fund ajo do të jetë një kurban që do t’i jepet dheut. Ti, shiko të ushqesh zemrën tënde! Ajo është ajo që do të ngrihet në madhëri dhe do të nderohet!”*

*“Ushqeje trupin me pak ushqim të yndyrshëm dhe me pak mjaltë. Ngaqë ai i cili ushqen tepër atë, në fund, bëhet pre e dëshirave egoiste dhe poshtërohet!”*

*“Ushqeje shpirtin me ushqime shpirtërore. Ofroji mendim të pjekur, kuptim të hollë dhe ushqime shpirtërore, le të shkojë i fortë dhe i qëndrueshëm në vendin e vajtjes!”*

Egoja e paedukuar i përngjet drurit me rrënjë të kalbura. Shenjat e të kalburit vërehen në degët, gjethet dhe frytet e saj. Nëse ka ndonjë sëmundje në zemër, kjo manifestohet në lëvizjet e trupit. Këta janë cilësi egoiste, frymore, si zilia, urrejtja, kryelartësia, të cilat kanë nevojë për kurim të shpejtë. Përmirësimi i këtyre cilësive negative është i mundur nëse ndiqet udhëzimi që dëshiron dhe ka porositur All-llahu. Dy tendenca elementare që shërbejnë që njeriu të ndërtojë personalitetin e tij konform miratimit të All-llahut të Lartë janë: shembëllimi dhe emitimië.

### **Tendenca për shembëllim dhe emitim**

Njeriu, që nga momenti i lindjes, në çdo sferë të jetës, ka nevojë për të marrë për shembull dikë. Ngaqë ai, mendimet, besimet dhe veprat e veta, si gjuhën, fenë, moralin dhe shprehjet, elemente këto që e formësojnë jetën e tij, gjithmonë i percepton nga përshtypjet e shembujve që i ekspozohen atij. Edhe pse herë herë ndodhin përjashtime të vogla, në përgjithësi kjo është kështu. Për shembull: fëmija fillimisht mëson gjuhën që flasin

prindërit e tij, më pas me shembuj tjerë mëson gjuhën e dytë, të tretë, dhe të katërt. Respektivisht, nga një aspekt, edukimi dhe arsimimi i njeriut nuk është gjë tjetër vetëm se emitim i gjërave pozitive dhe negative që vijnë si pasojë e prirjes për emitim që gjendet në natyrën e vetë njeriut. Dhe për këtë njeriu është nën influencën e të ëmës, në duart e të cilës është rritur, të atit, rrethit familjar dhe të ambientit në të cilin jeton dhe bëhet anëtar i shoqërisë si një personalitet pozitiv ose negativ, si rrjedhojë e ndikimeve në fjalë.

Derisa, zakonisht, njeriu aftësitë e dukshme, si gjuhën, i mëson lehtë, ai ballafaqohet me sfida serioze gjatë formësimit të fesë, moralit dhe botës shpirtërore. Ngaqë, pengesat si nefsi, fryma, dhe djalli, pengesa këto të pandara nga njeriu, të cilat vullneti hyjnorë ia dhuroi njeriut me qëllim sprove, e largojnë njeriun nga emitimi i këtyre vlerave. Njerëzit, si rezultat i tendencës për emitim dhe shembullim që gjendet në natyrën e tyre, pasionohen pas personave të cilët i pranojnë si udhërefyes, dhe mundohen që në suaza të mundësive të tyre të ndjekin ata. Për rrjedhojë njerëzimi, derisa feja, morali dhe bota shpirtërore e tyre nuk formësohen nga pejgamberët dhe miqtë e Zotit, nuk mund të shpëtojnë nga rebelimi, neglizhenca dhe sajimi. Në këtë mënyrë lumturia e përhershme e tyre shndërrohet në dështim të hidhur. Për rrjedhojë, sot, sa e mjerueshme është gjendja e disa njerëzve të cilët i marrin për model dhe mundohen t'i arrijnë disa “personazhe yje”, të cilët notojnë në argëtim të pakontrolluar, dhe në këtë mënyrë humbin lumturinë e përhershme.

Kjo gjendje e mjerueshme nuk është gjë tjetër vetëm se shkatërrim i frontit të zemrës së shprazur, duke ua dhuruar

personave të gabuar me qëllim të mbushjes së saj. Ja si e shembëllen këtë gjendje të mjerueshme poeti Mevlana Xhelaled-din er-Rumi:

*“Nuk habit fakti se qengji hik nga ujku. Ngaqë ujku është gjuetari dhe armiku i qengjit. Por ajo që të bën të habitësh është kur qengji ia dhuron veten ujkut.”*

Për këtë shkak themi se njerëzimi gjithmonë ka nevojë për udhërrëfyes shpirtëhollë, të ndjeshëm dhe delikat.

### **Personaliteti shembullor i Profetit**

Meqë ndjekja dhe emitimi i personave të cilët njeriu i pëlqen dhe i don është një tendencë që buron nga natyra njerëzore, është një moment shumë me rëndësi që njeriu të gjejë shembull më të përsosur dhe të hapërojtë pas gjurmëve të tyre. Për këtë shkak Zoti i Vërtetë, favori dhe fisnikëria e të cilit janë të pa fundme, krahas librave që ua shpalli njerëzimit, dërgoi edhe profetë, të cilët janë manifestime të gjalla të këtyre librave dhe posedues të mijëra e mijëra tipareve hyjnore. Ata janë personalitete shembullore të cilët manifestojnë sjellje të përsosura në sferën e fesë, diturisë dhe moralit. Për rrjedhojë të gjithë këta profetë do t'i ofrojnë njerëzimit shërbesa të pashembullta, duke lartësuar sjelljet shembullore gjatë historisë njerëzore.

Në cilin skaj të botës të vërehet ndonjë sistem i drejtë nëmes njerëzve, nëse ka dhembshuri dhe mëshirë që lidh zemrat e njerëzve më njëra tjetrën, ose nëse në një shoqëri të pasurit ndihmojnë të vobektit me dhembshuri, nëse të fuqishmit mbrojnë të diskriminuarit, nëse të shëndoshët mbajnë në dorë nevojtarët e sëmurë, nëse pronarët e thesareve kujdesen për

jetimët dhe ushqejnë dhe mbrojnë vejushat, dieni, se pa mëdyshje, këto vlera janë përcjellë në këtë shoqëri nga profetët dhe ndjekësit e tyre.

Familja njerëzore, që ka filluar me Hazreti Admin dhe Havanë (alejhiima es-selam) për të jetuar në prehje fetare dhe në ambient lumturie kanë zgjedhur vendin e Qabesë në Mekë për vend adhurimi. Më pas njerëzimi, bijtë e Ademit të shpërndarë nëpër tokë, si rezultat i nevojave jetike dhe shoqërore, do të vazhdojnë jetën e tyre fetare duke u udhëzuar herë herë me profetë, dhe, disa herë kur të vërtetat hyjnore ndryshoheshin nga disa manipulues dhe injorantë, Zoti i Vërtetë, dërgoi profet dhe rigjallëroi fenë duke larguar këto intervenime. Njerëzimi në këtë mënyrë do të arrijë në *ahirzaman*-kohë të fundit, duke u mbrojtur, me favorin hyjnor, nga krizat personale dhe shoqërore. Dhe në fund, erdhi “*asru-saadet*/periudha e lumturisë” e cila i përngjet mesditës, dhe me Zotëriun tonë Hazreti Muhammedin (salall-llahu alejhi ve sel-lem) jeta fetare në vendin e fillimit do të tregojë një maje përsoshmërie të fundit. Është e pamundshme të supozohet ndonjë përsoshmëri tjetër pas përsoshmërisë muhammediane. Ngaqë feja është përkryer duke u rigjallëruar me profet të dërguar dhe feja islame është bërë fe me të cilën është i kënaqur (*razi*) All-llahu (xhel-le shanuhu). Atëherë themi se për tendencën emituese të njeriut, e cila është pjesë e natyrës njerëzore, shembull i përkryer është i Dërguari i All-llahut, i cili gjatë jetës së tij ka manifestuar shembuj konkret dhe të panumërt. Pa dyshim sukcesi në emitim të Profetit tonë, është i lidhur me dashurinë tonë ndaj Tij, duke qenë të pasionuar në karakterin dhe përsoshmërinë e tij.

## Sa e duam ne Atë?

### Të përdorim zemrën dhe arsyen

All-llahu i Lartë, e krijoji njeriun shembullor, e nderoqi atë duke bërë *ahseni takvim*, qenie më të lartë. Derisa, gjithçka që ekziston në qiej dhe në tokë, i është dhënë në shërbim të tij, natyrisht, të gjithë këta vetëm për ata që mendojnë, që do të thotë se detyra jonë më e lartë është të mendojmë dhe meditojmë mbi dhuntitë e All-llahut, që na ka dhuruar neve, dhe të vlerësojmë ata sipas qëllimit të tyre. Në veçanti jemi të obliguar të shfrytëzojmë dhe përdorim zemrën dhe arsyen tonë në formën më të drejtë

Si duhet përdorur arsyeja?

Arsyeja nuk duhet ti nënshtrohet *nefsit*, egos-frymës, por duke njohur të vërtetat hyjnore duhet të jetë e vetëdijshme që gjendet në botë të sprovave.

Si duhet përdorur zemrën ?

Zemra është vend i vërtetë i dashurisë, pasionit të reatë ndaj Zotit të lartë. Është vendshikimi hyjnor. Për rrjedhojë, duhet mbajtur pastër nga çdo lloj mëkati dhe çdo gjëje që largon atë nga Zoti, duhet të jetë e mbushur me *dhikër*, përmendje dhe përkujtim, dhe *tevhid*, njëshmëri të All-llahut. Dhe në fund duhet dërguar para All-llahut një zemër të shëndoshë, *kalbi selim*. Për të realizuar këtë duhet që:

### Shembulli i vetëm - Hazreti Pejgamberi

All-llahu i Lartë, na ka dërguar neve profet me qëllim udhëzimi dhe tërheqje vërejtjeje. Si rezultat i favorit dhe fisnikërisë së Tij të pafund, kanë ardhur, në periudhën deri para

1400 vjetëve, mbi 124 mijë profet. All-llahu i Madhëruar më në fund do të dërgojë Profetin më të dashur, më të zgjedhur, më të çmuar dhe më të veçantë. Çdo profet ka qenë i dërguar për një popull. Profetët i udhëzonin popujt e tyre, te të cilët ishin dërguar, sipas përkatësisë së tyre shoqërore. Kurse, Zoti i vërtetë dërgoi Krenarinë e Gjithësisë, të Dërguarin e All-llahut, Muhammedin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) për gjithë njerëzimin. I dhuroi periudhës deri në kiamet kumtimin te Tij. All-llahu, i dhuroi botës Atë, në kohën kur femohimi dhe injoranca ishin në kulminacion, udhërrëfyes si një diell. Na dhuroi neve si një dhuratë dhe një favor.

### **Mrekullia më e madhe**

All-llahu i Madhëruar i dhuroi të Dërguarit të All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) mrekullinë më të madhe: Kur'anin Fisnik. Kur'ani deri në Kiamet do të dëshmojë se është fjalë e All-llahut dhe do të dëshmojë profetësinë e të Dërguarit të All-llahut. I gjithë njerëzimi deri në Kiamet do të shohë dhe do të njohë këtë mrekulli të Profetit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Hazreti Pejgamberi, në saje të mrekullisë kur'anore, do të nzjerr në shesh një shoqëri të tillë që do të njihet me epitetin *asru saadet*-periudha e lumturisë. Asnjëherë nuk ka ekzistuar, as që do të ekzistojë ndonjë shoqëri në botë sikur kjo, ngaqë atë kohë, nga njerëzimi i injorancës, respektivisht nga njerëzit e fundit të Oqeanit Indian, do të shfaqen njerëz me vlera më të larta se majat e Himalajeve. Një shoqëri e egër e cila varroste vajzat e tyre për së gjalli, në saje të edukimit, inspirimit dhe shpirtit të Profetit, do të stoliset me ndjenjën e mëshirës, dhembshurisë dhe përgjegjësisë, e cila nuk do të mund të përballojë, madje, edhe

gëlltitjen e qengjit nga ujku diku në breg të lumit Dixhle. Vetëm ky sukses mjafton për të dëshmuar madhërinë e personalitetit të Profetit dhe për të provuar se ç'shembull i përkryer, *usvei hasene* ishte Ai.

### **Të verbërit mohojnë diellin**

Nëse sytë nuk janë të verbër detyrimisht e shohën Atë, nëse nuk janë me të meta fizike nuk mund të gjejnë asnjë mangësi tek Ai. Ata të cilët duan t'i mveshin atij ndonjë mangësi, nuk bëjnë gjë tjetër vetëm se manifestojnë dobësitë, gabimet dhe mangësitë e tyre. Historia është e stërmbushur me akuza të pahijshme dhe tirani që popuj të ndryshëm kanë manifestuar kundër profetëve. Të vërtetat hyjnore, të cilat i kumtonin profetët, ua prishnin rehatinë egoiste disa personave. Për këtë shkak ata, për të arsytuar dhe legalizuar mënyrën e tyre të jetesës egoiste, mundoheshin t'ua mvishnin mangësitë e tyre profetëve. Për rrjedhojë, edhe sot të gjith fushatat që zhvillohen kundër Profetit, reflektojnë imoralitetin dhe paaftësinë e atyre që i bëjnë këto akuza.

Çdo qenie mund të zhvillojë jetën vetëm në një ambient të përshtatshëm për natyrën e saj. Edhe qenia njerëzore nuk bën përjashtim nga ky rregull. Ashtu siç është e pamundur të adaptosh për jetë një bletë, ushqimi dhe hapësira e frymëmarrjes të së cilës është bota brenda esencës së lules, në një ambient jashtë botës në të cilën është mësuar të jetojë, poashtu nuk është e mundur të bësh të jetojë një mi, natyra e të cilit është e përshtatshme për ndytësira, në një bahçe me trëndafila. Ashtu si që ushqehen shpirtërat e lartë me inspirimet që reflektohen nga

realiteti muhammedian, poashtu edhe shpirtërat mëkatarë dhe të ndytë prehen me ndytësira.

Hazreti Ebu Bekri (radiall-llahu anhu) shiqon në fytyrën e ndershme të Profetit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), magjepset dhe thotë: “Oh, sa e bukur është kjo fytyrë e bekuar.” Kjo, në realitet, don të thotë shikim i botës së brendëshme të reflektuar në atë pasqyrë.

Ebu Bekri thënies së Profetit: “*Nuk kam shfrytësuar asnjë pasuri tjetër sa kam shfrytëzuar pasurinë e Ebu Bekrit*”, do t’i përgjigjet me fjalët: “A nuk ekzistojmë unë dhe pasuria ime vetëm për Ty, o i Dërguari i All-llahut?!...” (Ibn Maaxhe, Mukadime, II), nga kuptohet se Ebu Bekri dhe gjithçka që ai posedonte ishin të nënshtruar dhe të tretur në të Dërguarin e All-llahut, ngaqë bota e tij e brendshme ishte si një pasqyrë që reflekton moralin e profetit fisnik Muhammedit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Kurse kryearmiku i All-llahut dhe Profetit, Ebu Xhehli nga ajo fytyrë e bekuar fiton përshtypje polarisht të kundër dhe ngel i huaj përballë bukurisë dhe madhërisë së fytyrës së bekuar. Pretekst për këtë është fakti se që të dy ata e shihnin veten e tyre, respektivisht, botën e tyre të brendshme, në pasqyrën muhammediane. Ngaqë, profetët janë sikur pasqyrë, çdokush e sheh veten e vet tek ata. Asnjë pasqyrë nuk gënjen për hatër, nuk tregon të bukurën të shëmtuar, të shëmtuarën të bukur? Reflekton vetëm atë që gjendet para saj.

Feja Islame është në mbrojtje të All-llahut të Madhëruar. Të gjithë ata të cilët pretendojnë të sulmojnë Kur’anin dhe Hazreti Pejgamberin, kurdo kurdo do të përjetojnë dënimin hyjnor. Të potencojmë se ëshë e pamundur të asgjësohet tendenca për të vërtetën dhe të vërtetin, të cilin All-llahu e ka krijuar në natyrën



e njeriut. Edhe pse pabesia përhapet me dhunë, ajo nuk mund të pengojë shfaqjen e rrënjëve të vendosura në thellësitë fetare shpirtërore dhe të ndërgjegjjes. Nuk mund të ndalohet nevoja e njeriut për t'u afruar tek Zoti i vetëm. Nuk mund të mënjanojen këto kënaqësi të natyrës së njeriut. Ngaqë, fuqia hyjnore, nevoja për fe dhe afrim kah Zoti janë *sunnatullah*, ligje të pandryshueshme të Zotit të Vërtetë. Sa bukur poeti Mevlana Xhelaled-din er-Rumi, e përshkruan gjendjen e personave që sillen si të verbër karshi realitetit dhe mundohen të shuajnë dritën hyjnore, ku thotë:

*“Të shash diellin, i cili shndrërit gjithësinë, të kërkosh mangësi tek ai, të verbër janë sytë e mi, të erësuar janë, mjegullim është të vetfyhesh, të vetnënçmohesh.”*

*“Nëse All-llahu don që të gris perden e dikujt, nëse don të nxjerrë në shesh turpin e tij, i dhuron zemrës së tij dëshirë për të fyer njerëzit e mirë.”*

Njerëzimi duhet menduar si të falënderojë Hazreti Pejgamberin. Ngaqë ajo zemër e cila nuk është mbushur me ndjenja falënderimi karshi mundimeve të Tij, nga lindja deri në vdekje për të shpëtuar dhe udhëzuar njerëzimin, nuk është zemër.

Dashuria e profetit për ne ishte shumë më e lartë se dashuria e prindërve për fëmijët e tyre. Profet ky, i cili na tregon se nuk ekziston asnjë njeri të cilit i janë kanosur sa Atij, se askush nuk është munduar dhe persekutuar sa Ai, nuk është detyruar askush të rijë i uritur sa Ai. (Tirmidhi, Kiamet, 34/2472)

Por, Ai asnjëherë nuk është ankuar për veten, kurse mundimet që përjetonin ummeti i Tij, ia përvëltonin zemrën. Ai ishte një profet i mëshirshëm dhe mendonte për ne në këtë botë,

dhe do të mendojë, do të përpiqet dhe do të përkujdeset për faljen dhe për shpëtimin tonë edhe në *mahsher*/vendgrumbullim, madje do të bëjë sexhde dhe do t'i lutet Allahut me sy të lotuar për *shefaat*, ndërmjetësim, derisa All-llahu t'ia pranojë lutjet e tij për ummetin të cilin shumë e don...<sup>57</sup>

Ne sot duhet të duam atë më shumë se veten tonë, të bëhemi besimtarë ashtu siç dëshiron Ai dhe të lidhim zemrën me atë Profet, i cili gjersa ishte në këtë botë mudohej aq shumë për ne, kurse në Ahiret do të lutet për ndërmjetësim, *shefaat*.

### I dashuruari ndjek të dashurin

Profeti ynë në një hadith thotë: “*Njeriu është së bashku me atë që e don.*” (Buhari, Edeb, 96)

Sa e duam ne Zotëriun tonë Pejgamberin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem)? Natyrisht kjo dashuri kërkon të ndahet mes veti, duke u mirëkuptuar dhe bashkjetuar. Njeriu është me atë që e don në të folur, njeriu është me atë që e don në bisedë, në sjellje, në qenie, në ndjenja, në mendime dhe në të jetuar. Respektivisht, nëse në dashuri nuk ekzistojnë këto momente të bashkimit dhe nëse i dashururuari ndjek rrugë krejtësisht të kundërt nga i dashuri, atëherë nuk mund të jenë së bashku ngaqë kjo do të thotë se ai nuk e don atë. Atëherë ne sot sa e duam Zotëriun tonë, Profetin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), sa e ndjekim sunnetin, traditën e tij? Fëmijëve dhe rrethit tonë, sa u tregojmë për Profetin tonë?

---

<sup>57</sup> Shih. Buhari, Enbija, 3, 9; Muslim, Iman, 327, 328; Tirmidhi, Kiamet, 10.

## **Për të ndjekur Atë duhet pasur edukim shpirtëror**

Për të arritur lumturi në këtë botë me brenga dhe në këtë mejdan me britma kemi nevojë që të ndjekim në çdo sferë të jetës Muhammedin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), duhet shembëllyer Atë në marrëdhëniet shoqërore, në marrëdhëniet familjare, në punë, e tjerë, e tjerë... Ai është shembulli i vetëm i cili duhet ndjekur nga gjithë njerëzit e shtresave të ndryshme. Si do të ndjekim atë? A thua duke lexuar nga ndonjë fletë! Jo, por duke e kalitur, edukuar zemrën tonë me njohuri mbi Atë.... Ja si i përshkruan All-llahu i Madhëruar themelet e këtij edukimi në ajetin 21 të sures el-Ahzab:

**“Ju e kishit shembull më të lartë (*usvei hasene*) në të Dërguarin e All-llahut, kuptohet ai që shpreson në shpërblimin e All-llahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shpesh All-llahun”** (el-Ahzab, 21)

Kushti i parë i këtij edukimi është shpresa për takim me All-llahun. Duhet mos haruar kurrë faktin se një ditë do të japim llogari para All-llahut, dhe duhet të jetojmë me këtë vetdije.

Kusht i dytë i këtij edukimi është shpresa për takim me Atë? Duhet kuptuar atë që është kalimtare, dhe duhet tejkaluar kufijt e saj. Sa bukur e paraqet këtë moment poeti Mevlana Xhelaled-din er-Rumi:

*“Jeta e kësaj bote është një ëndërr. Të jesh pronar i thesareve në botë i përngjet gjetjes së pasurive në ëndër. Pasuria e kësaj bote ka ngel në këtë botë duke u bërë hir prej brezi në brez.”*

Shikuar nga ky aspekt, është e obligueshme që të jemi të vetëdijshëm se gjendemi në një botë sprove. Dhe në këtë mënyrë duhet larguar dëshirat egoiste dhe duhet pranuar zemrën tonë si

udhëpërshkrues të pafund, duhet fituar vetëdije sipas të cilës Ahireti do të jetë një mejdan takimi. Për të arritur këtë duhet marrë hise nga personaliteti shembullor, *usvei hasene*, i Profetit tonë. Atëherë, All-llahu na premtton Xhennetin dhe na jep fjalën se do të na mundësoj të shohëm bukurinë e All-llahut të Madhëruar.

Kurse kushti i tretë i këtij edukimi është përmendja, *dhikri*, i shpeshtë i All-llahut. Duhet që zemra të jetë vazhdimisht me All-llahun. All-llahu i Madhëruar në Kur'anin Fisnik, sa i përket këtij momenti, urdhëron e thotë: **“përkujton All-llahun, kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë në krah...”** (Ali Imran 191), domethënë vazhdimisht janë me All-llahun, vazhdimisht janë me vetëdije se gjenden nën kamerën hyjnore. Zoti ynë është më afër nesh se aorta jonë, atëherë ne sa jemi ne afër Tij? Për të formuar këtë afërsi, kemi nevojë për të marrë shembull Profetin Tonë (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem).

### **Vlera e Profetit dhe ne**

Pa mos e kuptuar mirë vlerën dhe nderën e të Dërguarit të All-llahut, nuk mund të marrësh rrugë derjt All-llahut të Madhëruar. Vetë All-llahu i Lartë, në Kur'anin Fisnik, na tregon vlerat e Pejgamberit të All-llahut ku thotë:

**“Është e vërtetë se All-llahu dhe engjujt e Tij me madhërim e mëshirojnë Pejgamberin. O ju që keni besuar, madhërojeni pra atë (duke rënë salavatë) dhe përshëndeteni atë me selam.”** (el-Ahzabë, 56)

All-llahu i Lartë dhe engjujt i dërgojnë urata, salavate krijesës më të ndershme, Muhammedit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Ky realitet i tejkalon kufijtë e zemrave, arsyeve dhe

mundësive tona. Si mund të dërgojë urata All-llahu i Madhëruar për një qenie që vetë ai e ka krijuar? Edhe pse ka shumë komente mbi këtë çështje, por kjo, edhe më tej ngel një enigmë hyjnore, *sëri ilahi*. Por është shumë e qartë se All-llahu i Madhëruar, ka një dashuri dhe respekt shumë të veçantë ndaj Profetit tonë Muhammedit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). All-llahu i Lartë kërkon që edhe ne të kuptojmë këtë realitet dhe urdhëron e thotë:

**“O besimtarë! Edhe ju dërgoni salate, (urata) të panumërta atij, dhe me një nënshtrim të vërtetë jepni atij selam (luteni për paqë)?”**

Por këto salate dhe selame nuk duhet përsëritur vetëm me gojë. E gjithë qenia jonë duhet të përjetojë dhe të jetë e vetëdijshme për këto urata dhe përshëndetje. Çdo sjellje në jetën tonë familjare, në punën tonë të përditshme, në marrëdhëniet tona ndërnjerëzore, duhet manifestuar në pajtueshmëri me salatet dhe selamet për të Dërguarin e All-llahut. Duhet menduar se a thua i Dërguari i All-llahut (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) buzëqeshet i kënaqur nga sjelljet tona në familje, nga marrëdhëniet tona tregtare, nga marrëdhëniet ndërnjerëzore? A thua buzëqeshet nga mënyra e edukimit të fëmijëve tanë? A thua buzëqeshet i kënaqur nga *ibadetet*, adhurimet tona? Nësa këtoa pyetje nuk ia parashtrijmë vetes sot, nëse sot nuk vetllogaritemi, nesër (në ditën e mahsherit) llogaria jonë do të jetë shumë e tmershme. Padyshim ditën e kiametit do të na thuhet:

اقْرَأْ كِتَابَكَ كَفَىٰ بِنَفْسِكَ الْيَوْمَ عَلَيْكَ حَسِيبًا

**“Lexo librin tënd! Sot mjafton për ty vetja yte si llogaritës.”**  
(el-Isra, 14).

Atëherë në librat e veprave tona do të kemi mundësi të shohim të gjitha gjendjet tona, do të shikojmë jetën tonë, filmin e

jetës sonë. Si i kemi falur namazet? Si i kemi agjëruar ramazanet? Kemi kryer ibadetet vetëm formalisht, apo edhe me zemër dhe me shpirt dhe vetëdije? Çfarë kemi bërë karshi dhuntive të panumërta të cilat na i ka dhuruar All-llahu në këtë botë? Sa i kemi shfrytëzuar në rrugë të mbarë dhuntitë, si shpirtin, arsyen, pasurinë dhe trupin. Nesër në Kiamet të gjitha këto do të na ekspozohen e ne do t'i vështrojmë ne ekranet e kiametit. Por çështja kryesore është që gjendjen dhe veprat tona t'i shikojmë në këtë botë, dhe të marrim masa të nevojshme.

### **Sprova e dashurisë dhe edukatës**

Të gjithë njerëzit në këtë botë janë në sprovë, kjo botë është një shkollë sprove hyjnore. Njëra nga sprovat me rëndësi të kësaj shkolle është dashuria për Hazreti Pejgamberin, respekti dhe edukata ndaj Tij. All-llahu i Lartësuar në Kur'an thotë:

**“O ju besimtarë, respektoni All-llahun dhe të Dërguarin e tij dhe mos i çoni kot veprat tuaja.”** (Muhammed, 33)

**“O ju që keni besuar, mos ngritni zërin tuaj mbi zërin e Pejgamberit dhe mos iu ngërmoni atij si i ngërmoheni njëri-tjetrit, e të zhduken veprat tuaja duke mos e ditur ju.**

**Ata që ulin zërat e tyre pranë të Dërguarit të All-llahut, All-llahu zemrat e tyre i ka përshtatur për devotshmëri, ata kanë falje mëkatesh dhe shpërblim të madh.**

**Ata që të thërrasin përtej mureve, shumica e tyre janë që kuptojnë.** (el-Huxhuratë, 2-4)

Domethënë, respekti ynë ndaj të Dërguarit të All-llahut, ndjekja e sunnetit të profetit, njohja jonë mbi Profetin, janë sprova të devocionit, *takvasë* së zemrës sonë, janë ndërmjetësues të afërsisë sonë me All-llahun.

Ata të cilët sillen në formë banale ndaj Tij, flasin me zë të lartë në prezencë të Tij, ata të cilët nuk nderojnë Atë janë njerëz të cilët nuk logjikojnë, njerëz me të meta. Atëherë, si duhet marrë për shembull të Dërguarin e All-llahut? Përgjigjen e kësaj pyetje e gjejmë në Kur'anin Fisnik, në të cilin All-llahu i Lartë thotë:

**“Kush i bindet Pejgamberit, ai i është bindur All-llahut, e kush e refuzon, (dije o i Dërgur se) Ne nuk të dërguam ty roje kundër tyre.”** (en-Nisa, 80)

### **Kriteret e dashurisë ndaj Profetit**

Hadithi në vazhdim i përcjellur nga Abdullah bin Hisham është shumë i kuptimtë kur është në pyetje niveli i dashurisë ndaj Profetit:

“Njëherë ishim në shoqëri me të Dërguarin të All-llahut (sal-lallahu alejhi ve sel-lem), Profeti Fisnik, nga të pranishmit e kishte të kapur për dore Omerin (radiallahu anhu), atëherë Omeri iu drejtua Profetit dhe i tha:

‘O i Dërguari i All-llahut, në përjashtim të vetes sime, ti je më i dashur se çdo gjë tjetër për mua’.

I Dërguari i All-llahut në këtë rast i tha Omerit:

*‘Jo, pasha Zotin, në duart e të cilit është shpirti im, derisa unë nuk jam më i dashur për ty edhe se shpirti yt nuk konsiderohesh se ke besim, iman të plotë!’*

Atëherë Omeri tha:

‘Pasha All-llahun, Ti je më i dashur për mua se shpirti im?’, kurse i Dërguari i All-llahut ia ktheu:

*‘Tash u bë tamam, o Omer!’* (Buhari, Iman 3)

Edhe ne duhet ndjekur dhe respektuar të Dërguarin e All-llahut me një dashuri të këtillë. Duhet pranuar atë si sundimtar

të vetëm të fronit tonë shpirtëror dhe si udhërrëfyes në jetën tonë

All-llahu i Madhëruar në Kur'anin Fisnik, në suren el-Ahzabë, thotë:

النَّبِيُّ أَوْلَىٰ بِالْمُؤْمِنِينَ مِنْ أَنفُسِهِمْ

“Pejgamberi, për besimtarët është më prioritar se sa vetja e tyre...” (el-Ahzab, 6)

Ai për ne është më afër se shpirti ynë. Edhe në një hadith tjetër dashuria ndaj të Dërguarit të All-llahut është paraqitur si kusht i besimit të vërtetë, në të cilin përcillet se Profeti ka thënë:

*“Pasha All-llahun, në duart e të cilit gjendet shpirti im, asnjëri prej jush nuk llogaritet se posedon besim të plotë, derisa unë të mos jem për atë më i dashur se vetja e tij, nëna e tij, babai i tij, fëmijët e tij, dhe gjithë njerëzimi.”* (Buhari, Iman, 8)

Shokët e të Dërguarit të All-llahut këtë realitet gjithmonë e potenconin duke e përsëritur shprehjen: “Të qofshim fli nëna, babai, shpirti im dhe çdo gjë, o i Dërguari i All-ahut!”

Qëndrimi indiferent, ose mosnderimi i kësaj dashurie është rrjedhojë e injorancës. Kurse përqaftimi i kësaj dashurie është reçetë e këtij shpëtimi.

### **Shenjat e dashurisë profetike**

Njeriu përmend shpesh atë që e don shumë, në çdo moment hapë fjalën mbi të, dhe flet me ëndje për temat që kanë të bëjnë me atë. Bisnesmeni i dhënë pas punës së tij, vazhdimisht flet rreth tregtisë së tij. Kështu fitova, kështu humba, në këtë tregti ka aq dobi, etj. etj.... Dikush e don shumë fëmijën e tij dhe në çdo



rast në çdo vend flet për të. Por, as'habët e ndershëm dhe *evliatë*, miqtë e All-llahut gjithmonë kanë folur për të Dërguarin e All-llahut, dhe për këtë kanë ndjerë kënaqësi të pafundme. Ja kjo është njohje e vërtetë, emitim dhe dashuri e plotë, mall për të qenë me Atë së bashku! Lusim All-llahun që të na mundësojë të gjithë neve që ta njohim nga afër dhe ta duam më gjithë zemër Krenarinë e Gjithësisë, Muhammedin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem).

**Amin!**

Njëra prej të fshehtave të dashurisë, e cila është shkaku i ekzistencës së gjithësisë është hyrja e atij që e do dikë, në rrugën e tjetërsimit përkah natyra e atij që duhet, sado i dobët e i paaftë të jetë ai që do, dashuria e bën që, megjithatë, të dalë diçka në përputhje me madhësinë e emrit ndaj të cilit është prirur.

**Vështirë është të përshkruash Atë ashtu siç e meriton Ai**

Komandanti i njohur Halid bin Velid (radiallahu anhu) gjatë një udhëtimi, do të ndalet për pushim tek një popull. Kryepari i atij populli, do ta ftojë Halidin, dhe do t'i thotë:

“A mund të ma përshkruash Muhammedin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem)?” Halidi iu përgjigj:

“Fjalët e mia janë të mangëta për të përshkruar të Dërguarin e All-llahut, nëse dëshiron të përshkruaj çdo imtësi, unë nuk kam mundësi të bëj këtë!”

Kryepari përsëri iu lut e i tha:

“Na përshkruaj atë aq sa ke mundësi. Na përshkruaj atë shkurt?”

Halid bin Velidi atëherë i tha:

الرَّسُولُ عَلَى قَدْرِ الْمُرْسَلِ

“I Dërguari posedon vlerat e Atij që e ka dërguar!”  
(domethënë i Dërguari posedon tipare dhe vlera të Zotit të Gjithësisë, Krijuesit të ekzistencës, tash ti llogarit vlerat e tij!)<sup>58</sup>

All-llahu i Madhëruar na dhuroftë neve pjesë nga dashuria që as’habët e ndershëm posedonin për Pejgamberin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) na mundësoftë që jetën tonë ta zbukurojmë me dashuri për Muhammedin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem).

**Amin!**

---

<sup>58</sup> Munavi, V, 92/6478; Kastalani, *Mevahib-i Ledunnijje Tercumesi*, Stamboll 1984, s. 417.

## Pasthënie

Për të miratuar *shefaatin*, ndërmjetësimin e lartë të të Dërguarit të All-llahut është e rrugës, që edhe një herë të bëjmë një vetllogari sa i përket nivelit të ndjekjes së Profetit, duhet të riorganizojmë jetën tonë në suaza të kritereve të përmendura në këtë vepër; kemi nevojë për një ambient të sigurtë meditimi dhe përpjekjeje. Duhet të mundohemi që të reflektojmë bukuritë e pashoqe në ummetin e Tij, që adhurimet, sjelljet, ndjenjat, mendimet, të sotshmen, ta nesërmen, të organizojmë me emocione dhe inspirime të denja për ta. Njeriu emiton dhe ndjek i pasionuar atë që dashuron në bazë të dashurisë që posedon. Për të ndjekur dhe emituar denjësisht Dritën e Ekzistencës, duhet njohur dhe vlerësuar denjësisht personalitetin shembullor të Tij, me tërë kuptimin e plot të fjalës.

Fusha sa do që të jetë pjellore, nuk gjelbëron derisa nuk kalojnë mbi të rretë me shi dhe errërat pranverore me diell. Edhe zemra e njeriut, për t'u bërë si një tokë pjellore duhet që paraprakisht t'i nënshtrohet Krenarisë së Gjithësisë, Muhammedit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), i cili është më i larti i të parëve dhe atyre që do të vijnë më pas; është burimi, vlerat dhe fisnikëritë e të cilit nuk harxhohen, është preteksti i gjithë begative dhe mëshirave të gjithësisë. Kur'ani Fisnik i mbushur me vlera të pafundme i ka zbritur Atij, i është dhuruar gjithësisë së besimit.

Nga e gjithë kjo që u tha, del në pah ky përfundim se, Profeti ynë (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) dhe çdo gjë që është pretekst

për t'u kujtuar Ai, sa do që të nderohen është pak. Ngaqë ai është “*Muteal*-i lartësuar”, është profeti të cilit All-llahu i Lartë i drejtohet me epitetin “*Habibi*-i dashuri im”.

Është e pamundur që e vërteta e Tij e lartë, së pari, të mund të rroket në një mënyrë të përsosur me anë të njohjes njerëzore e pastaj të parashtrohet me fjalë.

Në të vërtetë, nuk ka mundësi tjetër veç asaj që pohimit mbi natyrën e Tij sublime t'i vihet pikë në pafundësinë e heshtjes! Ndërsa në përshkrimin e jetës së Tij të zgjedhur, gjuhët mbeten absolutisht të paafta, edhe shprehjet e zemrave tona, të reflektuara në fjalë, janë vetëm sa një pikë uji në oqean! Sepse gjuhët dhe zemrat janë të paafta për ta përshkruar Atë!

Ç'lumturi ka për ata besimtarë që ushqejnë dashuri vetëm e vetëm për të Dërguarin e All-llahut dhe nuk mashtrohen me lule artificiale të kopshteve të egra.

E lus Zotin tonë, duke u mbështetur në dashurinë ndaj Tij!..

Salavate, urata për Muhammed Mustafanë, Zotëriun e Dy botëve!...

Salavate, urata për Muhammed Mustafanë, profetin e njerëzve dhe xhindëve!...

Salavate, urata për Muhammed Mustafanë, imamin e dy qyteteve të shenjta!...

Salavate, urata për Muhammed Mustafanë, gjyshin e Hasanit dhe Huseinit!...

اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِهِ وَصَحْبِهِ وَبَارِكْ وَسَلِّمْ

Zoti ynë i Madhëruar na dhuroftë nga ambienti ideore i Muhammedit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) i cili është i vetmi udhëzues në rrugën e drejtë, një pjesë të lartë për zemrat tona

dhe nga pasuria e Tij e gjerë shpirtërore, pika vese frymëzimi për ndjenjat tona! Zemrat na u bëfshin vend i dashurisë për All-llahun dhe të Dërguarin e Tij! All-llahu i Madhëruar me favorin e Tij na bëftë të gjithëve të merituarit e shefaatit, ndërmjetësimit të Tij të madh!

*Amin !*